

**E DREJTA – LAW**

**Përmbajtja – content**

**Artikuj – Articles**

Prof. Dr. Enver Hasani

*Origjina e gjyqësisë kushtetuese: aspekte filozofike – teorike*

Philosophical and Theoretical Aspects of the Origins of Judicial Review

PhD. dr. Asllan Bilalli

*Zhvillimi historik i të drejtave private (civile) të të huajve dhe kriteret për kategorizim lidhur me gëzimin nga të huajt*

Historical development of the (private) civil rights of foreigners and criteria for categorization related to enjoyment of such rights by foreigners

Nur Çeku, PhD. C.

*Aspekte të mbikëqyrjes parlamentare të sektorit të sigurisë në Kosovë*

Aspects of parliamentary oversight of the security sector in Kosovo

Ma.sc. Ardit Gashi

*Roli i Parimeve të UNIDROIT si një ndihmese në interpretimin e CISG*

The Role of UNIDROIT Principles in the Interpretation of the CISG

**Kontribute – Contributions**

Ma. Sc. Albanë Gashi

*Procesi i ekzekutimit të buxhetit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Kosovë*

Budget execution process in the Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development in Kosovo

**EDREJTA  
LAW**

**Nr.1-4/2017**



**Revistë për Çështje Juridike dhe Shoqërore  
Journal for Juridical and Social Issues**

Prishtinë, 2017



# **E DREJTA – LAW**

**Revistë për çështje Juridike dhe Shoqërore  
Journal for Juridical and Social Issues  
Viti XLII - Nr. 1-4 - 2017**

**Botues – Publisher  
Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës  
University of Prishtina School of law**



# **E Drejta – Law**

Revistë për Çështje Juridike dhe Shoqërore

Journal for Juridical and Social Issues

Viti XLII - Nr. 1-4 - 2017

Botohet çdo tre muaj – published every three months

---

## **Redaksia – Editorial Staff**

Anëtarë

Dr. sc. Abdulla Aliu, prof. i rreg., Dr. sc. Haki Demolli, prof. i rreg., Dr. sc. Bedri Peci, prof. asoc., Dr. sc. Visar Morina, prof. asoc., Dr. sc. Qerim Qerimi, prof. ass., MA. sc., Dren Doli, MA. sc. Vigan Qorrolli, MA. sc. Qerkin Berisha

Kryeredaktor – Editor-in-chief

Dr. sc. Qerim Qerimi

Redaktor përgjegjës – Editor

MA. sc. Qerkin Berisha

Prishtinë, 2017

# P ë r m b a j t j a – C o n t e n t

Artikuj – Articles

(Summaries in English)

## P ë r m b a j t j a – c o n t e n t

### Artikuj – Articles

#### **Prof. Dr. Enver Hasani**

*Origjina e gjyqësisë kushtetuese: aspekte filozofike – teorike .....7*  
Philosophical and Theoretical Aspects of the Origins of Judicial Review

#### **PhD. dr. Asllan Bilalli**

*Zhvillimi historik i të drejtave private (civile) të të huajve dhe kriteret për kategorizim lidhur me gëzimin nga të huajt .....43*  
Historical development of the (private) civil rights of foreigners and criteria for categorization related to enjoyment of such rights by foreigners

#### **Nur Çeku, PhD. C.**

*Aspekte të mbikëqyrjes parlamentare të sektorit të sigurisë në Kosovë .....65*  
Aspects of parliamentary oversight of the security sector in Kosovo

#### **Ma.sc. Ardit Gashi**

*Roli i Parimeve të UNIDROIT si një ndihmese në interpretimin e CISG.....83*  
The Role of UNIDROIT Principles in the Interpretation of the CISG

### Kontribute – Contributions

#### **Ma. Sc. Albanë Gashi**

*Procesi i ekzekutimit të buxhetit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Kosovë ..... 103*  
Budget execution process in the Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development in Kosovo





**Artikuj**  
Articles

**Prof. dr. Enver Hasani**

## **ORIGJINA E GJYQËSISË KUSHTETUESE: ASPEKTEFILOZOFIKE – TEORIKE**

### **HYRJJE**

Ky punim përbën kapitullin e dytë të librit **GJYQËSIA KUSHTETUESE: ASPEKTE KRAHASUESE DHE RASTI I KOSOVËS**, të cilin jemi duke e shkruar me kolegun e nderuar **Muhamet Brahimi**, kandidat për doktoratë në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, drejtimi ndërkombëtar. Mbase ky do të jetë vetëm fillimi i botimit të njëpasnjëshëm të kapitujve të këtij libri, i cili gjithsejtë do të ketë tetëmbëdhjetë (18) kapituj, përfshirë hyrjen dhe literaturën e përdorur. Duket qartë se prodhimi përfundimtar do na merr mjaft kohë, sepse mendojmë të prodhojmë një libër serioz për gjeneratat që vijnë, kemi vendosur që të nisim me botimin e kapitujve të tij të përzgjedhur. Kjo bëhet me shpresë se do t'u ndihmojë lexuesve dhe krejt atyre që duan të dinë më shumë për gjyqësinë kushtetuese, për origjinën e saj filozofike – teorike.

Përveç përshtatjes që i kemi bërë punimit për ta harmonizuar me standardet e revistës **E DREJTA** për botim, struktura e shkrimit ngelet e njëjtë me atë që do të dal si kapitulli i dytë me radhë i librit si më sipër, pra menjëherë pas kapitullit hyrës. Në vijim të kësaj, ky shkrim ka katër seksione të cilat përbëjnë një tërësi unike. Në seksionin e parë flasim për botëkuptimet mbi një rend superior, më të lartë, si premisa kryesore që ka çuar në lindjen e konstitucionalizmit modern dhe mekanizmit të tij implementues - gjyqësisë kushtetuese. Idetë mbi një rend superior, më të lartë, si parakusht thelbësor për lindjen e gjyqësisë kushtetuese gjinden që nga kohët antike dhe mund të përcillen përgjatë shekujve deri në kohët tona. Këtë e dëshmojmë në këtë punim duke dhënë dallimet greke në mes të **nomos**-it dhe rendit tjetër inferior të bazuar në të. Ky dallim përcillet edhe në kulturat e sistemet tjera juridike të njohura deri më sot. Kështu e kanë parë edhe autorët mesjetar dhe antik, të cilët përfolën këtu.

Seksioni i dytë në vijim flet për revolucionin francez dhe kontrollin kushtetues, për refuzimin kategorik të revolucionarëve francez në filllet e para të lindjes së tij për të pranuar çfarëdo kontrolli kushtetues të vullnetit të

sovrانيت të shprehur përmes ligjeve. Kjo qe pasojë e kuptimit klasik të frymës së ligjeve dhe për gjyqtarët si njerëz të pabesë që nuk mund të bëjnë asnjë interpretim të vullnetit të shumicës, ashtu siç e kishte thënë **Zhan Zhak Ruso** shumë vite para Revolucionit. Këtu, veç kësaj, jepen edhe kthesat dhe “pishmanet” e revolucionarëve që më në fund u detyruan ta pranojnë se mund të ketë një kontroll, së pakut politik, të vullnetit të sovranit tëshprehur në ligje.

Nëseksionin e tretë flasim për pavarësinë e SHBA-ve dhe kontrollin gjyqësor. Këtu tregojmë se kontrolli gjyqësor nuk ka lindur në SHBA rastësisht por ka qenë pjesë e një historie koloniale gjatë kohës sa ishin në sundimin britanik. Kjo situatëshpjegohet derinë detaje ashtu që lexuesi e kupton fare mirë pse SHBA krijoj një institucionsiçështë kontrolli gjyqësor, i cili në vendin e sundimitarit, britanikëve, nuk zuri rrënjë asnjëherë ani se atje kishte nisur mëherët si një praktikëgjyqësor një shekull mëherët.

Seksioni i fundit, para se të nxjerrim përfundimet tona, diskuton përhapjen e kontrollit gjyqësor në Evropë. Nisi me Britaninë , ku, siç u tha, asnjëherë nuk zuri rrënjë për arsye krejt specifike historike. Flasim për vështirësitë e kësaj përhapje në Evropë dhe për karakteristikat e saj, si dhe për rrethanat historike të lindjes së saj nëEvropë, diskursinteorik e filozofik, si dhe për bërjen e saj njëmekanizëm që simbolizon demokracitë kushtetuese moderne, ani se kjo nuk është kështu. Këtu në këtë seksion tregojmë se , përkundër faktit që gjyqësia kushtetuese përdoret si sinonim i konstitucionalizmit modern tëproveniencës liberale perëndimore, kjo nuk është kështu në realitet sepse gjyqësia kushtetuese ekziston edhe në vendet tjera që nuk kanë as traditë e as praktikëaktuale të tipit të demokracive kushtetuese, e cila përmblihet në postulatet, siç janë sundimi i ligjit , ndarja e pushteteve , respektimi i të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve.

Në libër, në vend të përfundimit që jepet këtu, ekziston seksioni i veçantë që cilësohet si “komente dhe pyetje për provim”, si dhe “literatura për lexim shtesë”. Ne këtu japim përfundimet tona, krejtësisht provizore sepse ato që janë të fundit lexuesi do t'i gjejë vetëm në versionin përfundimtar të prodhimit tonë, të librit me titull si më sipër.

Fare në fund, theksojmë këtu se ne përdorim fjalën “kontroll kushtetues” sipas versionit të gjuhëve latine, pra jo versionin e fjalëve të gjuhëve angleze, ku fjala “judicial review” vështirë se mund të përkthehet si “kontroll gjyqësor”, siçbëhet me gjuhën italiane, spanjolle, franceze, etj. Edhe në gjuhën shqipe më shumë i shkon për shtati fjala “kontroll kushtetues” sepse



reflekton në mënyrë më përmbledhëse fenomenin që studiohet: aktivitetin gjyqësor të gjykatave, kushtetuese apo të atyre të rregulla, i cili ka për qëllim primar sigurimin e epërsisë së një rendi më të lartë juridik krahasuar me rendet tjera inferiore.

## 1. BOTËKUPTIMET MBI NJË REND SUPERIOR , MË TË LARTË

Përgjatë historisë së shoqërive të organizuara në shtet kanë dominuar botëkuptimet sipas të cilave çdoherë ka ekzistuar një rend më superior , më i lartë , krahasuar me tjerët<sup>1</sup>. Vënia në jetë dhe mbrojtja e këtij rendi më superior, më i lartë, ka krijuar konceptin e hierarkisë së burimeve të së drejtës dhe, për pasojë, ka lindur nevoja e pasjes së një mekanizmi institucional, hierarkik poashtu, me qëllim të realizimit vetëm të një qëllimi : sigurimin e superioritetit (epërsisë) së rendit më superior , më të lartë, krahasuar me të tjerët.

Krijimi i mekanizmave institucional të cilët kanë pasur për qëllim sigurimin e superioritetit (epërsisë) së rendit më superior, më të lartë, krahasuar me tjerët ka qenë vija e përgjithshme dhe konstante në kuadër të së cilës duhet të kërkohet lindja e gjyqësisë moderne kushtetuese. Çdoherë në të kaluarën, në secilin rend, kanë ekzistuar mekanizma institucional që kanë qenë pjesë e hierarkisë së organeve publike, mirëpo qëllimi i tyre nuk ka qenë siguri i epërsisë (superioritetit) të një rendi më superior, më të lartë, krahasuar me të tjerët. Për pasojë, organet e tilla, sado që kanë qenë mekanizma institucional, nuk mund të konsiderohen si organe (mekanizma institucional) të gjyqësisë kushtetuese. Me fjalë tjera, në kohën deri në lindjen në Britani të Madhe të vendimit të parë që cilësohet si kontroll gjyqësor , i cili diskutohet në vijim, nuk ka ekzistuar një rend objektiv juridik brenda rendit shoqëror ku marrëdhëniet publike normohen përmes rregullave objektive. Në këtë kohë, kanë qenë rregullat etike, morale, tradita si dhe zhvillimet tjera shpirtërore që kanë shërbyer si rregullator dhe kontrollues i marrëdhënieve publike. Nëveçanti Kisha , e cilës do proveniencë (katolike, protestante, ortodokse, etj.) , ka pasur një ndikim të madh si kontrolluese morale e rendit shoqëror në përgjithësi.

Gjyqësia kushtetuese ka nisur shumë më vonë, në Britaninë e Madhe , me rastin e njohur **Dr. Bonham** (1610), për të marrë “vulën e thatë” në SHBA me rastin e njohur historik **Marbury vs Madison** (1803). Fakti se para kësaj

---

<sup>1</sup> Lucio Pergoraro , *Giustizia costituzionale comparata. Dai modelli ai sistemi* (G. Giappichelli Editore – Torino ,2015) fq. 15-20.

kohe nuk ka ekzistuar një organ, përkatësisht një mekanizëm institucional që ka pasur për qëllim ruajtjen e supremacisë (epërsisë) së një rendi më superior , më të lartë, krahasuar me tjerët shpjegohet me rrethanën se asnjëherë para fillimit të shekullit 17-të nuk ka pasur një rend unik më superior, më i lartë, se tjerët . Sikur të kishte ekzistuar një rrethanë e tillë, domosdo do të shtrohej nevoja e krijimit të një mekanizmi institucional për mbrojtjen e këtij rendi. Kjo, megjithatë, nuk donë të thotë se në ta kaluarën, që nga Antika deri në fund të Mesjetës, nuk ka ekzistuar një hierarki e organeve të pushtetit publik. Këtë do ta shohim më vonë. Esenca e këtij dallimi qëndron në faktin se në të kaluarën e sipërcekur nuk ka pasur një botëkuptim për një rend unik të prekshëm dhe më superior ,më i lartë, krahasuar me të tjerët.

Mekanizmat institucional që kanë ekzistuar në të kaluarën antike greko-romake e deri në mesjetën evropiane duhen kuptuar në kontekst të kohës dhe assesi si praktika moderne të kontrollit të legjitimitetit të ligjeve dhe të akteve tjera të autoriteteve publike. Ata nuk kanë qenë veçse prototipa të cilat i ngjasojnë kontrollit kushtetues modern ashtu siç e njohim sot<sup>2</sup>. Përmes paraqitjes së zhvillimit të tyre, megjithatë, mund të kuptohet më mirë trashëgimia aktuale greko-romake, si dhe vet esenca e kontrollit kushtetues. Ekzistimi i këtyre mekanizmave proto-tipe të cilat vetëm sipërfaqësisht i ngjanin kontrollit modern kushtetues aspak nuk lidhet me formën e qeverisjes apo të sundimit në kohën greko-romake deri në Mesjetë. Bëhet fjalë, në esencë, për proto-tipe që kanë pasur qëllim tjetër: ndëshkimin penal për moszbatim të segmenteve të caktuara të së drejtës së kohës , pra jo sigurimin apo ruajtjen e ndonjë superioriteti (epërsie) të një rendi superior, më të lartë se tjerët. Koncepti i fundit, siç u tha, as që ka ekzistuar në atë kohë, ani se kanë ekzistuar aty-këtu kushtetuta të shkruara (si p.sh në disa prej qytet-shtetet greke). Vënia në jetë dhe ruajtja e supremacisë (epërsisë) së një rendi më superior (më të lartë) krahasuar me tjerët, siç dihet, nënkupton ekzistimin e një sistemi garancionesh kushtetuese, në kuptimin juridiko-

---

<sup>2</sup> Antonello lo Calzo, i cilëson me të drejtë këto institute dhe këto praktika antike si proto-sisteme të gjyqësisë kushtetuese , përkatësisht të kontrollit kushtetues. Veçori e përbashkët e të gjithave është se ato nuk fokusohen në kontrollin kushtetues të normës , por në kontrollin e zbatimit të ligjeve në Greqinë dhe Romën antike.

Vetëm më lindjen e kushtetutave të para të shkruara moderne në fund të shekullit 18-të fillon lindja dhe zhvillimi i kontrollit kushtetues dhe i gjyqësisë kushtetuese si veprimtari shtetërore e veçantë me qëllim të sigurimit të epërsisë së tekstit kushtetues krahasuar me çdo akt tjetër juridik. Cf. Antonello Lo Calzo , “PROTOSISTEMI DI GIUSTIZIA COSTITUZIONALE: IL CORPO DEGLI EFORI NELLA COSTITUZIONE DELLA REPUBBLICA NAPOLETANA DEL 1799” / “EARLY SYSTEMS OF CONSTITUTIONAL ADJUDICATION: THE COUNCIL OF THE EPHORS IN 1799 NEAPOLITAN REPUBLIC CONSTITUTION”*HISTORIA CONSTITUCIONAL* num. 14 (Septiembre , 2013) fq. 251-305 në fq. 255-256 (fusnotat 14 dhe 15).

teknik, gjë që këtu nuk ka qenë rasti. Fjala është, thënë shkurt, për një sistem të respektimit të normave që vlenin dhe që duheshin zbatuar në shoqëritë e organizuara në shtet në këtëperiudhë të zhvillimit në Antikë, në Greqi dhe në Romë, e deri nëMesjetë. Këto norma parashihnin instrumentet të cilat synonin kontrollin e aktivitetit të organeve shtetërore , si p.sh. të mbretit, asamblesë apo të këshillave të ndryshëm , njëjtësiç kontrollohej çdo qytetar tjetër, me qëllim të caktimit të një përgjegjësie penale , pra jo me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së një rendi superior, më të lartë, krahasuar me tjerët.<sup>3</sup>

Diskutimi i mekanizmave prototip si më sipër është i domosdoshëm sepse duhet të kuptohet se cila ka qenë natyra dhe fizionomia e tyre në të kaluarën . Jo vetëm kaq, nga të kuptuarit e tyre sot e kuptojmë më lehtë vetë origjinën dhe trajektoren e zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese moderne, nëveçanti zhvillimet përgjatë shekujve formative të gjyqësisë kushtetuese - shekujt 18, 19 dhe deri në mesin e shekullit 20-të. Ky diskutim kaq i domosdoshëm fillon, krejt natyrshëm, me shtjellimet e filozofëve modern të cilët kanë qenë të parët që sqaruan esencën e formës (fizionomisë) dhe natyrës së pushtetit publik në antikitet.

Përvoja praktike mesjetare ka qenë më shumë se kaq nëlëmin e origjinës së gjyqësisë kushtetuese. Bazuar në shtjellimet doktrinare të mendimtarëve perëndimor janë vënë themelet e sigurtat të individualizmit të kuptimeve dhe mekanizmave institucional për mbrojtjen e kushtetutës , të cilët kanë qenë tëngjashëm (prototip) me kuptimet dhe mekanizmat modern të kontrollit tëkushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve tjera juridike. Në rend të parë, këtu e kemi fjalën për institucion venecian të **Avogadori del Commun**, të krijuar më 864. Ky organ kolegjal kishte për detyrë primare mbrojtjen e interesave tëaristokracisë veneciane nga organet e ndryshme të shtetit të Venedikut . Si i tillë, kishte të drejtë të suspendonte aktin juridik të qeverisë veneciane apo të ndonjë organi tjetër, përfshirë këtu Doga-n, udhëheqësin suprem civil dhe ushtarak të Venedikut, nëse **Avogado** konsideronte se ai akt binte ndesh me interesat e aristokracisë vendase. **Avogadori**, njëjtë si tribunët romak, të cilët mbronin plebenjtë nga veprimet e patricëve, mbronin aristokracinë venedikase nga strukturat e pushtetit vendor. Këta tëdytët, për dallim nga të parët, mund të suspendonin aktet juridike : i tërë fokusi i punës së tyre koncentrohej në vlerësimin nëse akti juridik i një pushteti të caktuar në Venedik cenonte të drejtat e aristokracisë vendase. Në këtë kuptim , mund të thuhet se **Avogadori** më së shumti i ngjasojnë kuptimit modern të

---

<sup>3</sup> L. Mezzetti , M. Belletti, E. D'Orlando & E.Feroli, *LA GIUSTIZIA COSTITUZIONALE* (CEDAM : Padova, 2007) fq. 20.

mekanizmit institucional për kontrollin kushtetues të legjitimitetit të ligjeve dhe akteve tjera juridike. Megjithatë, **Avogadori** nuk ka pasur për synim sigurimin e supremacisë (epërsisë) së rendit objektiv të përcaktuar me kushtetutë, por mbrojtjen e interesave të aristokracisë venedikase.

**Baroni Monteskije** (Charles de Secondat baron de Montesquieu: 1689-1755), ka qenë mendimtari i parë i cili ka trajtuar gjerësisht prototipat që i ngjasojnë mekanizmave moderne të kontrollit kushtetues, sepse është marrëkryesisht me formën (fizionominë) e tyre në të kaluarën. **Monteskije** ka vërejtur se pushteti legjislativ në qytet-shtete greke nuk kishte të drejtën e ndalimit të pushtetit ekzekutiv, por vetëm të drejtën dhe autorizimin e kontrollit të mënyrës së ekzekutimit të ligjeve që vetë i kishte nxjerrë. Tre mekanizma institucional i kanë shërbyer këtij qëllimi: **Cosnes** në Kretë, **Eforati** në Spartë dhe **Nomophylax** në Athinë<sup>4</sup>.

I pari, **Cosnes**, nuk mund të konsiderohet si organ i kontrollit kushtetues por më tepër si rregullator i autorizuar i jetës në qytet-shtetin e Kretës, si titullar i pushtetit suprem të popullit. Veprimi i **Cosnes**-it në emër të popullit ndihmohej nga **Këshilli i të Vjetërve**. **Asambleja e Kretës** kishte të drejtën ekskluzive për të miratuar ose refuzuar propozimet e bëra nga ky këshill. Çdo dështim për të bërë një propozim të mirë tërhiqte me vete një sanksion penal për propozuesin. Ngakjo qartë shihet se forma (fizionomia) e këtij organi nuk e ngërthente në vete qëllimin e mbrojtjes së ndonjë rendi superior, më të lartë së tjerët. Ky botëkuptim mbi rendin superior, më të lartë se tjerët, nuk ekzistonte fare në këtë kohë.

I dyti, instituti i **Eforatit**, i lindur në Spartën e vjetër, ka qenë një organ mbikëqyrës. Në fakt, vet fjala **efor** në gjuhën greke e ka kuptimin e mbikëqyrjes. **Efori** ka qenë një këshill i përbërë prej pesë vetëve që kishin për qëllim, në rend të parë, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe ku gjenin se ato nuk po zbatoheshin mund të nisnin procedurat penale kundër qytetarëve. Ky organ kishte të drejtë të mbikëqyrte edhe punën e dy mbretërve spartan, të cilët mund të dërgoheshin nëpërgjegjësi pranë **Gerousia**, një lloj gjykate supreme e Spartës. Edhe në rastin e **eforat**-it nuk mund të flitet për kontrollin kushtetues të superioritetit të (epërsisë) së ndonjë rendi të bazuar në një normë superiore juridike, por për një kontroll të aktiviteteve individuale të zyrtarëve shtetëror spartan<sup>5</sup>.

<sup>4</sup> Montesquieu, *L'ESPRIT DES LOIS. SUIVI DE LA DEFENCE DE L'ESPRIT DES LOIS. LIVRE XI* (Belin – Leprieur, Libraire – Editeur: Paris, 1845), fq. 111.

<sup>5</sup> Në kohën e modernitetit, **efori** si institut që parapare për herë të fundit në Kushtetutën e Napolit të vitit 1799. Në kapitullin XIII të saj, të titulluar “Ruajtja e Kushtetutës” (nenet

Së fundi, në **Athinën** e vjetër kanë ekzistuar organe shumë të veçanta, të njohur me emra të ndryshëm, të cilët i shërbenin në mënyrë unike rendit **Nomos**.<sup>6</sup> Juristi dhe filozofi i mirënjohur i drejtësisë, gjermani **Karl Shmit (Carl Schmitt)**, me plot të drejtë e ka cilësuar **Nomos-in** si rend dhe si orientim, pra shumë më shumë se kuptimi “ligj”, i cili nganjëherë i atribuohet fjalës **Nomos**.<sup>7</sup> Me këtë term janë kuptuar disa gjëra në të njëjtën kohë: rendi më i lartë në Athinë, baza e strukturës së tij, si dhe vetë parimet e përgjithshme të rendit shoqëror atinas. Për të siguruar moscenimin e tyre nga qytetarët, përkatësisht vënien e këtyre kuptimeve në jetë nga të gjithë, athinasit kishin themeluar një rrjet organesh, mekanizmash institucional kontrollues, të cilët konstatojnë nëse po cenohej **Nomos-i**. Kjo nëveçanti vinte në shprehje lidhur me aktivitetin e Këshillit, i quajtur **Boule**, i cili zgjidhej nga Kuvendi i Popullit, i quajtur **Ecclesia**. Në ndërkohë që **Nomos-i** përbëhej nga të gjitha normat, parimet dhe strukturat fundamentale të shoqërisë së Athinës, **Psefisma-t** përbënin aktivitetin ligjvënës të **Boule-s** në Athinë. Këto akte nganjëherë kishin natyrë të përgjithshme. Si të tilla u ngjasonin akteve ligjore, të cilat, megjithatë, ishin në esencë dekrete dhe çdoherë duhej të ishin në pajtim me **Nomos-in**. Ndryshimi i këtij të fundit konsiderohej si mjaft i vështirë, gjë që nuk ishte rasti me të parat.

Ata që donin të nxirrnin **Psefism-a**, përmes të cilave rregullohej jeta e përditshme e grekeve dhe që kishin kuptimin e dekretive të kohës moderne, duhej ta kishin të qartë se ato nuk guxonin të ishin kundër **Nomos-it** grek. Thënë shkurt, **Nomos-i** konsiderohej si një rend natyror, i pandryshueshëm, kurse **Psefisma** konsiderohej si një e drejtë që mund të ndryshonte sepse me të rregullohej jeta e përditshme e athinasve. Nëse **Psefism-abinte** ndesh me këtë postulat, pra nëse realizimi në praktikë i **Psefisma-s** nuk vlerësohej si pozitiv, atëherë propozuesi i saj mund të kishte përgjegjësi penale. Përveç

---

350 – 380), Kushtetuta fliste për detyrat e ngjashme të *eforatit* napoleonian. Shih më shumë për këtë në Vincenzo Cuoco, *Historical Essay on the Neapolitan Revolution of 1799* (University of Toronto Press: Toronto, 2014) fq. 178 – 181 (Kapitulli XLI: “Constitution – Other Laws”).

<sup>6</sup> Cf. Kurt A. Raaf laun, “Early Greece”, kapitulli i 6-të; David J. Philips, “Athenes”, kapitulli i 7-të; botuar në Benjamin Isakhan and Stephen Stockell (eds.), *The Edinburgh Companion to the History of Democracy. From Pre-History to Future Possibilities* (Edinburgh University Press: Edinburgh, 2015); Cf. lidhur me historikun e qytetet shteteve greke që nga momenti i themelimit deri me shkatërrimin e tyre, S. E. Finer, *The History of Government. Vol. I. : Ancient Monarchies and Empires* (Oxford University Press: Oxford, 1999) fq. 316-384.

<sup>7</sup> Carl Schmitt, *The Nomos of the Earth in the International Law of the Jus Publicum Eurpeum* (Telos Press Publishin: USA, 2006), kapitulli 4: “On the Meaning of the Word *Nomos*” (fq. 67-79)

kësaj, **Psefisma**-t që binin ndesh me **Nomos**-in konsideroheshin të pavlefshme ashtu që edhe gjyqtarët grekë duhej të kishin kujdes **ex officio** që mos t'i zbatonin në praktikë. Krahas gjyqtarëve, në Athinë ka qenë edhe një organ tjetër i quajtur **Nomophylax** (shumës: **Nomophylakes**), i cili ka pasur pushtetin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve pozitive të Athinës<sup>8</sup>. Tërë ky rrjet organesh ka pasur vetëm një qëllim, sigurimin e **Nomos**-it nga moscenimi që mund t'i vinte nga aktiviteti legjislativ i organeve tjera si dhe nga veprimet tjera të cilat mund të ishin në kundërshtim me të. Përgjegjësia çdoherë ishte penale dhe nuk konsistonte në restaurimin e rendit të cenuar superior, më të lartë, i cili quhej **Nomos**. Vetëm nga ky aspekt mund të thuhet se prototipi i **Nomos**-it i ngjason botëkuptimeve moderne mbi një rend superior, më të lartë, krahasuar me tjerët, kurse mekanizmat institucional në Athinën antike kanë pasur për qëllim pengimin dhe ndëshkimin penal të çdo cenimi të rendit **Nomos**. As që mund të flitet në këtë kohë për ndonjë garanci kushtetuese në kuptimin e sotëm të fjalës: “e drejta kushtetuese greke” zbatohet në mënyrë tënjëjtë si çdo ligj tjetër, gjithnjë nën kërcënim të sanksionit penal dhe jo të restaurimit të saj si rend objektiv, sepse ky rend objektiv nuk ekzistonte në kuptimin e sotëm të fjalës.

Edhe në Romë ka ekzistuar një institucion kontrollues i të tjerëve, i njohur si **tribunët**. Këta ishin qytetarë të zgjedhur të cilët kishin për detyrë të mbronin plebenjtë nga shpërdorimi i ligjit dhe nga tirania e patricëve. Ky kontroll që kishte për qëllim mbrojtjen kishte natyrë klasore sepse i referohej vetëm mbrojtjes sështrës sëplebenjve.

Mbi bazën e studimit të formës (fizionomisë) së mekanizmave të sipërcekur institucional antik greko – romak, më vonë është ndërtuar botëkuptimi mesjetar evropian lidhur me atë se çka konsiderohet rend superior, më i lartë, e çka rend inferior, më i ulët. Në fakt, tërë përpjekja e botës perëndimore, e cila ndjek traditën greko-romake, është fokusuar në krijimin e një rendi mësuperior, më të lartë se tjerët, në mënyrë që ai mos të ndryshohet papritur dhe nëçdo kohë dhe, me këtë, të ndërtohet siguria dhe qëndrueshmëria shoqërore.

Dallimi në mes të një rendi qëështë i përkohshëm (efemer), i bërë nga njeriu, dhe një rendi tjetër, i bërë nga hyjnitë (natyra), qëështë i përhershëm, ka ekzistuar te të gjithë mendimtarët greko – romak, me fillim nga **Platoni** e

---

<sup>8</sup>Susan Lape, *Reproducing Athens. Menander's Comedy, Democratic Culture, and the Hellenistic City* (Princeton University Press: Princeton, 2004) fq. 48-50.

deri te **Ciceroni**<sup>9</sup>. Ky botëkuptim ka qenë i njohur edhe në Mesjetë. Kjo bëhet e ditur nga shkrimet e mendimtarëve mesjetar, pikëpamjet e të cilëve, siç mund të imagjinohet, kanë pasur një përmbajtje të theksuar teologjike (fetare) të proveniencës kristiane.

Nga autorët mesjetar që më së shumti ka shtjelluar dallimin në mes të dy rrethve si më sipër ka qenë **Shën Thoma Akuini** (*Sain Thomas Aquinas : 1225-1274*). Këtë autor e kemi diskutuar në vijim për arsye se pikëpamjet e tij më së miri shpërfaqin mesataren e mendimeve mesjetare lidhur me natyrën e rendit shoqëror të kohës.

Për **Shën Thoma Akuinin** e drejta natyre paraqiste një **lex superior** me rrënjë hyjnore, të cilës duhej t'i nënshtroheshin të gjitha normat dhe të gjitha subjektet. Kjo nënkuptonte që sovrani, Papa apo Perandori, duhej poashtu t'i nënshtrohej të drejtës natyrore mbi të cilën bazohej një rend më superior, më i lartë, se rendi shoqëror i kohës. Nga kjo del se në Mesjetë ekzistonin dy rrethve : një ishte rendi **jus naturale**, i cili ishte më superior, më i lartë dhe më i pacenueshëm, kurse rendi tjetër ish ai i **jus positivum**, i cili ishte inferior ndaj të parit dhe duhej t'i nënshtrohej atij. Ky dallim është ruajtur edhe te autorët e mëvonshëm të shekujve 17 dhe 18. Pas Mesjetës, megjithatë, ka pasur një ndryshim në botëkuptimin lidhur me atë se çfarë konsiderohej rend superior, më i lartë, e çka rend inferior, më i ulët.

Gjatë shekujve 17 dhe 18 ndryshoj baza (rrënja) e të drejtës natyrore dhe e rendit të bazuar në të: pas Mesjetës e drejta dhe rendi natyror bazoheshin në racionalizëm dhe laicitet. Sipas këtij botëkuptimi, njerëzit kishin të drejta natyrore, të lindura, të cilat ishin të paprekshme dhe të pacenueshme. Si të tilla, këto të drejta natyrore dhe rendi i bazuar në të shërbenin si kufizime për ligjvënësin post-mesjetar të shekujve 17 dhe 18. Ky botëkuptim, dhe rendi i bazuar në të, u shtjelluan deri në detaje nga **John Loku** (*John Locke : 1632-1704*), i cili shkroi veprën e tij monumentale, **Dy Traktate mbi Qeverinë** (1680-1690), në mbrojtje të **Revolucionit të Lavdishëm** (1688), revolucion që sanksionoi supremacinë (epërsinë) e parlamentit anglez. Sipas tij dhe botëkuptimeve dominuese të asaj kohe, çdo normë që ishte kundër **jus naturale** konsiderohej si e pavlefshme dhe e paqenë.

Në praktikë, megjithatë, gjendja ishte më ndryshe: gjyqtarët shpesh duhej të zbatonin normat e qarta të **jus positivum**, duke ua lënë filozofëve që të merreshin me formulimet e përgjithshme dhe të paqarta të **jus naturale**. Kjo

<sup>9</sup> Mauro Cappelletti, *The Judicial Process in Comparative Perspective* (Clarendon Press: Oxford, 1989) fq. 122.

shtroi nevojën e integritit të këtyre dy të drejtave dhe të rendeve që bazoheshin në to. Kjo ndodhi më vonë, në kohët moderne, kur u krijuan mekanizma institucional përmes të cilëve u bë integrimi i **jus naturale** në **jus positivum**. Me këtë hap, e drejta natyrore e Mesjetës në modernitetet u fut në të drejtën pozitive e cila nuk kishte burim hyjnor por ishte produkt i arsyes së ligjvënësit (mbretit dhe parlamentit) dhe i përpjekjeve laike të shoqërisë si tërësi. Në literaturë kjo është quajtur në mënyrë lakonike “pozitivizim” i të drejtës natyrore<sup>10</sup>.

Ky ndryshim lidhur me burimin e të drejtës dhe rendin si tërësi domosdo qëështë reflektuar edhe në mënyrën e vënies në jetë të këtij ndryshimi: hierarkia e re e burimit të së drejtës, i cili nuk ishte hyjnor, si dhe e rendit të krijuar nga ky burim , domosdo që krijuan detyrime për gjyqtarët që me rastin e vënies në jetë të këtij ndryshimi të bazoheshin në mekanizma të ri institucional, në mesin e të cilëve ishte edhe interpretimi gjyqësor se cili rend ishte suprem , më i lartë, se tjerët. Kjo qasje e ndryshuar, qartë vërehet nëse analizohet origjina e gjyqësisë kushtetuese që filloi në Angli (rasti **Dr. Bonham, 1610**). Në këtë rast, **Sër Edvard Koke** (*Sir. Edward Coke: 1552-1634*), mbrojti supremacinë (epërsinë) e rendit të bazuar në “common law” (“e drejta e përgjithshme”), si diçka që kishte cilësitë e jus naturale, kundrejt jus positivum që mishërohej nëligjvënien e parlamentit anglez të kohës, me të cilin ishte dënuar dr. Bonham. Duke e njohur epërsinë e **jus naturale** që mishërohej në “common law” (“e drejta e përgjithshme”), **Sër Edvard Koke** ia mohoj mbretit anglez supremacinë (epërsinë) nëligjvënie . Me këtë, në mënyrë efektive, **Sër Edvard Koke**, si kryegjyqtar anglez , tregoi se mbreti ishte sovran vetëm së bashku me parlamentin, por rendi i ndërtuar përmes “common law” (“e drejtë e përgjithshme”) nuk mund të shfuqizohej përmes **jus positive**. Ky hap pati për qëllim kufizimin e pushtetit të mbretit dhe në këtë kontest duhet të shikohet, asnjëherë jashtë tij, kufizim që më vonë kulmoi me **Revolucionin e Lavdishëm** (1688) në rrënjosjen përfundimtare të supremacisë (epërsisë) së parlamentit. Thënë shkurt, si “e drejtë kushtetuese” në rastin **Dr. Bonham** (1610) u konsiderua ajo e drejtë që buronte nga natyra e shoqërisë angleze, e njohur si “common law” (“e drejta e përgjithshme”).

Sidoqoftë, ka qenë nxjerrja e kushtetutave të shkruara dhe assesi interpretimi gjyqësor, ai që ka nxitur dhe përsheptuar nevojën për krijimin e mekanizmit tëveçantë institucional për vënien në jetë të garancioneve kushtetuese të

---

<sup>10</sup> Mauro Cappelletti and William Cohen, *Comparative Constitutional Law . Cases and Materials* (The Bobbs-Merrill Company, Inc.: USA, 1979) fq. 7; Mauro Cappelletti, *The Judicial Process in Comparative Perspective*. fq. 123.



përmbledhura në një tekst. Për këtë u deshën gati dy shekuj nga rasti **Dr. Bonham** (1610), kur u bë nxjerrja e teksteve të para kushtetuese, të kushtetutave të shkruara, të cilat qartë sanksiononin një rend superior krahasuar me tjerët. Në luftën në mes të pushteteve qendrore për të ruajtur supremacinë (epërsinë) e një rendi të bazuar në kushtetutë kundrejt një tjetri rend që bazohej në ligje dhe burime tjera ka lindur koncepti modern i gjyqësisë kushtetuese. Kjo ndodhi në SHBA, siç do sqarohet më vonë, me rastin e njohur si **Marbury vs. Madison** (1803).

Para këtij viti historik në gjyqësinë kushtetuese, megjithatë, patën qenë krijuar të gjitha parakushtet për lindjen e saj si një mekanizëm modern për kontrollin e legjitimitetit kushtetues të ligjeve. Krijimi i këtyre kushteve lidhet me sundimin kolonial i cili, në mënyrë paradoksale, në Britani bazohej në supremacinë e “common law” (“e drejta e përgjithshme”), kurse nëpër koloni mbronte supremacinë (epërsinë) e rendit pozitiv, i cili bazohej në të a.q. **Charterstë** cilat kishin statusin e aktit më të larët juridik në një koloni (“kushtetutat” e kolonive). Kjo mbrojtje bëhej me një kusht: rendi pozitiv kolonial i bazuar në **charters** (“kushtetutat” e kolonive) nuk guxonte të binte ndesh me të drejtën e përgjithshme (“common law”) që vlente në Britani. Kjo nënkuptonte se, si e drejtë pozitive dhe rend pozitiv në kolonitë amerikane konsideroheshin “**charters**” (“kushtetutat”) e kolonive, të cilat duhej të ishin në pajtim me të drejtën e përgjithshme (“common law”) dhe rendin britanik kolonial. Kjo gjendje krijoi, siç do të sqarohet në vijim, një situatë paradoksale e cila, megjithatë, i bëri mirë teorisë dhe praktikës së kontrollit të legjitimitetit kushtetues të ligjeve, e cila u themelua fuqishëm në rastin e sipërcekur të Gjykatës Supreme **Marbury vs. Madison** (1803). Ky rast përfundimisht sanksionoi epërsinë e tekstit nacional kushtetues, tekstin e Kushtetutës së SHBA-ve të vitit 1789, kundrejt çdo rendi tjetër që ekzistonte nëpër shtetet anëtare 9ish kolonitë britanike). Më shumë për këtë do të flitet sërish më vonë në vijim. E njëjta gjë, siç e pamë, nuk mundi të ndodhë në Britani me rastin **Dr. Bonham** (1610). Kjo për arsye se në Britani nuk pat një tekst kushtetues koherent, i qartë dhe i sakët që do të mund të interpretohej lehtë nga një mekanizëm gjyqësor britanik. Rendi i bazuar në “common law” (e drejtë e përgjithshme) ishte rend i turbullt, i paqartë dhe jo shumë i sakët, i cili ishte krijuar përgjatë shekujve mesjetar të zhvillimit të gjyqësisë britanike. Për pasojë, **Edvard Koke** nuk pati për qëllim sigurimin e ndonjë supremacie (epërsie) të “common law” (“të drejtë së përgjithshme”). Ai pati për qëllim, në rend të parë, mohimin e sundimit të mbretërve të dinastisë Tudor në Britani, të cilët cilësoheshin si ligjvënës përmes parlamentit britanik. Duke thënë se “common law” (“e drejta e përgjithshme”) kishte epërsi ndaj ligjeve të parlamentit, **Edvard Koke**

mohoi aktivitetin ligjvënës të parlamentit për atë që ai identifikojë dhe ishte një me pushtetin e monarkut të dinastisë së Tudorëve. Kjo, megjithatë, në të njëjtën kohë nuk nënkuptonte mohimin e supremacisë së parlamentit britanik në kuadër të sistemit kushtetues britanik, por mohimin vetëm të pushtetit ligjvënës monarkik që ushtrohej përmes institucionit të parlamentit. Pra, fjala ka qenë këtu për kufizimin e pushtetit mbretëror, e asesi për themelimin e një mekanizmi që do të bënte kontrollin e legjitimitetit kushtetues të ligjeve britanike, përmes përdorimit të **common law** (“e drejta e përgjithshme”) si diçka që kufizonte të drejtën e pushtetit absolut të mbretërve britanik të dinastisë Tudor.

## 2. REVOLUCIONI FRANCEZ DHE KONTROLLI KUSHTETUES

Refuzimi fillestar i Revolucionit Francez për t’i njohur gjyqësorit ndonjë rol në vënie në jetë përmes interpretimit gjyqësor të rendit të ri revolucionar nuk zgjati shumë. Mekanizmi institucional për ruajtjen e epërsisë së rendit revolucionar në fillim ishte politik, mirëpo me kalimin e kohës u transformua në një mekanizëm gjyqësor pak a shumë të ngjashëm me vendet tjera evropiane<sup>11</sup>.

Ky refuzim i futjes në sistemin nacional të institucionit të kontrollit gjyqësor të legjitimitetit kushtetues të ligjeve vinte si pasojë e historisë së hidhur franceze me rolin e gjykatave të larta gjatë **ancien regime** (regjimi i vjetër). Gjykatat e larta franceze, të njohura me një emër të çuditshëm, **Parlements**, në kohën para Revolucionit të viti 1789 konsideroheshin si profesione që ushtronin një lloj kontrolli ndaj aktivitetit ligjvënës të mbretit. Gjykatat në fjalë e kanë abuzuar këtë pushtet deri në atë masë sa që kanë komprometuar rolin e tyre si kontrollues të pushtetit mbretëror, duke u kthyer në vetë

---

<sup>11</sup> Përvoja praktike mesjetare ka qenë më shumë se kaq në lëmin e origjinës së gjyqësisë kushtetuese. Bazuar në shtjellimet doktrinare të mendimtarëve perëndimor si më sipër, ka vënë themelet e sigurta të individualizmit të kuptimeve dhe instrumenteve për mbrojtjen e kushtetutës dhe të kontrollit të kushtetutshmërisë së normës. Në rend të parë, këtu e kemi fjalën për institutin venecian të **Avogadori del Commun**, të krijuar më 864. Ky organ kolegjal kishte për detyrë primare mbrojtjen e interesave të aristokracisë veneciane nga organet e ndryshme të shtetit të Venedikut. Si i tillë, kishte të drejtë të suspendonte aktin juridik të qeverisë veneciane apo të ndonjë organi tjetër, përfshirë këtu Dogan-n, udhëheqësin suprem civil dhe ushtarak të Venedikut, nëse **Avogado** konsideronte se ai akt binte ndesh me interesat e aristokracisë vendase. **Avogadori**, për dallim nga tribunët romak, të cilët mbronin plebenjtë nga veprimet e patricëve, mbronin aristokracinë venedikase nga strukturat e pushtetit vendor. Këta të dytët, për dallim nga të parët, mund të suspendonin aktet juridike dhe tërë fokusi i punës së tyre koncentrohej në vlerësimin nëse akti juridik i një pushteti të caktuar në Venedik cenonte të drejtat e aristokracisë vendase.

abuzuesit e pushtetit. Kjo , në mënyrë të natyrshme, përshtatej me rrethanën e njohur në atë kohë sipas së cilës gjyqtarët ishin nga radha e aristokracisë ku mandati i gjyqtarit mund shitej dhe blihej sikur çdo send apo e drejtë tjetër e individit.

Një situatë e tillë ka shkaktuar kundërshtime të fuqishme nga dijetarët e kohës, **Zhan Zhak Rusos-s (Jean-Jacques Rousseau: )** dhe **Baronit Monteskje (Baron de Montesquieu: )** . Idetë mbi ndarjen e pushteteve dhe mbi rolin zero të gjyqësorit në këtë mes qenë baza e Revolucionit Francez të vitit 1789. Këta autorë, gjyqtarin e konsideronin si një zbatues mekanik të ligjit, pa asnjë kreativitet apo liri për interpretim të tyre, duke shërbyer thjeshtë si një **bouche de la loi** , gojë e verbër e ligjit, asgjë më shumë. U mor vesh, mospasja e të drejtës për interpretim të ligjit nga ana e gjyqësorit nënkuptonte, në të njëjtën kohë , se kontrolli i legjitimitetit të tyre kushtetues as që mund të vinte në shprehje. Gjyqtarët dhe gjyqësori në Francën e pas vitit 1789 nuk u konsideruan si pushtet , por si shërbyes civil, si burokratë të thjeshtë, kurse vendimet e tyre u konsideruan si me vlerë dhe me efekt vetëm sa i përket rastit apo mosmarrëveshjes konkrete , pa asnjë vlerë praktike për të ardhmen. Me këtë, precedenti u zhduk në tërësi nga rendi francez. Kjo filozofi dhe kjo praktikë u përhap më pastaj në Evropë përmes pushtimeve të Napoleonit<sup>12</sup> .

Megjithatë, kjo gjendje u bë e paqëndrueshme sepse çdoherë e më shumë filloj të ndihej nevoja për një kontroll kushtetues të legjitimitetit kushtetues të ligjeve të parlamentit të ri francez. E komprometuar gjatë kohës së regjimit të vjetër mbretëror, **ancien regime**, gjyqësia nuk përbënte një opsion serioz për kryerjen e kësaj detyre të rëndësishme. Kjo domosdo shtronte nevojën e gjetjes së mekanizmave tjerë institucional të cilët do ta kryenin kontrollin e legjitimitetit kushtetues të ligjeve të reja franceze. Këtë herë, rruga e zgjedhur dhe mekanizmi institucional që do të kryente këtë detyrë nuk kërkohet brenda gjyqësorit francez por brenda politikës, krejt kjo si pasojë e komprometimit të gjyqësorit në të kaluarën. Mekanizmi i ri institucional u quajt **Tribunal de Cassation**, Tribunali i Kasacionit, dhe u themelua më 1790.

Synim i këtij organi të ri ishte që të shërbejë si një lloj filtruesi i kushtetutshmërisë së ligjeve të reja, duke mos lejuar gjyqësorin që luaj asnjë rol në interpretimin e tyre. Nëse shtrohej nevoja e një interpretimi, atëherë gjyqtarët duhej që ligjet e reja t'ia dërgonin parlamentit francez për

---

<sup>12</sup> Herman Schëartz, *The Struggle for Constitutional Justice in Post-Communist Europe* (The University of Chicago Press: Chicago , 2000) fq. 14.

interpretim përmes institucionit të sapoformuar, **Tribunal de Cassation**. Si pjesë e kësaj lufte për pengim të rikthimit në skenë të rolit të fuqishëm të gjyqtarëve ka qenë edhe instituti i njohur si “kodifikim”. Atëherë besohej se, meqë gjyqtarët duhet të jenë vetëm zbatues mekanik të ligjit, atëherë parlamenti si përfaqësues i sovranit duhet ta kodifikojë çdo lëmi të drejtësisë në mënyrë që mos të lihet asnjë hapësirë për interpretim gjyqësor. Ky institut u emërtua sipas ideatorit të tij, sundimtarit perandor **Napoleon Bonaparte** (Napoleon Bonaparte: 1769-1821) . Me **kodifikimet e Napoleonit** u besua se më nuk do të ketë asnjë rrezik nga sundimi i gjyqtarëve sepse, siç besohej atëherë , kodifikimi i kryer përjashtonte çdo mundësi për abuzim sepse çdo situatë jetësore ishte e futur në kodet e reja , pra ishte kodifikuar.

Me kalimin e kohës, megjithatë, u pa se kodifikimet në fjalë poashtu kishin nevojë për interpretim. Kështu , u lejua që gjyqtarët të bënin interpretimin e kodeve të Napoleonit, rrethanë e cila në fund të shekullit 19 pati për pasojë transformimin e kuptimit të kasacionit në Francë: nga një organ politik, i themeluar me qëllim të kontrollit politik të legjitimitetit kushtetues të ligjeve, ai u shndërrua në një organ gjyqësor, i cili sot e kësaj dite është i tillë, **Cofur de Cassation**, Gjykata e Kasacionit. Kjo gjykatë tani kishte në ngarkesë të saj vetëm kontrollin e interpretimit përfundimtar të ligjit të kryer nga ana e gjykatave të ulëta. Ky organ u përhap shumë shpejt në vendet tjera, si në Itali, Belgjikë, Greqi dhe në disa vende tjera në Evropë dhe përtej. Megjithatë, **Cofur de Cassation** as sot e kësaj dite nuk ka në mandat të vetin kontrollin e kushtetutshmërisë së veprimit legjislativ të shtetit, por të mënyrës së zbatimit të ligjeve nga ana e gjykatave të ulëta në Francë. Kjo gjendje , shikuar historikisht, ka lindur si për dy arsye: e para, si pasojë e praktikës franceze të supremacisë (epërsisë) së parlamentit e proklamuar pas Revolucionit; dhe, e dyta, si pasojë e komprometimit të rolit të gjyqtarëve në të kaluarën gjatë regjimit të vjetër, **ancien regime**. Për të adresuar këtë problematikë, me kalimin e kohës në Francë u zhvillua një praktikë tjetër e mbikëqyrjes së veprimit ekzekutiv dhe legjislativ të shtetit francez.

Praktika e kontrollit kushtetues të veprimeve administrative dhe legjislative të shtetit ka nisur me themelimin e dy organeve të reja: **Këshilli i Shtetit** (*Conseil d'Etat*) dhe **Këshilli Kushtetues** (*Conseil Constitutionnel*). Qëllimet e themelimit të këtyre organeve kanë qenë të ndryshme: i pari kishte për qëllim mbrojtjen e lirive kushtetuese të individëve të prekura nga veprimi administrativ i shtetit, kurse i dyti ka pasur për qëllim mbrojtjen e ekzekutivit francez nga fuqia ligjvënëse e parlamentit. Organi i parë ngeli organ i pastër gjyqësor në sferën e çështjeve administrative, i dyti ngeli një institucion politik.

Me kalimin e kohës, megjithatë, kontrolli i kushtetutshmërisë së veprimit të shtetit bëri që këto dy organet të ndeshen në një pikë të përbashkët: mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të garantuara kushtetuese. Ky evoluim kështu nëveçanti u bë i qartë nga prilli i vitit 2010 kur **Conceil Constitutionnel** mori të drejtën e kontrollit represiv të ligjeve gjatë vendosjes lidhur mbi ndonjëçështje konkrete para gjykatave franceze, pra fitoi të drejtën e vlerësimit nëse ligjet që duhen zbatuar në një rast apo mosmarrëveshje konkrete cenojnë liritë dhe të drejtat kushtetuese. Deri atëherë, **Conceil Constitutionnel** kishte gëzuar vetëm të drejtën e kontrollit preventiv të ligjeve, pra pas votimit të tyre në parlament dhe para se të hynin në fuqi. Ky institut i ri, i njohur si “kontrolli represiv i kushtetutshmërisë së ligjeve” , ka qenë dëgjues dhe panjohur për sistemin francez të kontrollit të kushtetutshmërisë. Kjo në gjuhën franceze emërtohet si **question prioritaire de constitutionnalité**, apo *kërkesa për kontroll prioritar të kushtetutshmërisë së ligjit. Si shkurtesë për këtë në gjuhën frënge përdoret “QPC”*<sup>13</sup>. T’i kthehemi çështjes së evoluimit të kompetencave të dy institucioneve të sipërcekura

I formuar më 1799, fillimisht si organ këshillues i shefit të shtetit, **Këshilli i Shtetit** (*Conseil de Etat*) që nga 1780 mori kompetenca gjyqësore të kontrollit të veprimit administrativ të shtetit në rastet kur duhet mbrojtur liria dhe e drejta e individit. Në rastin e njohur si **Blanco**(1873), Këshilli konfirmoj se shteti ishte përgjegjës për dëmet e shkaktuara ndaj individëve nga ana e organeve shtetërore apo personave të punësuar në shtet. Kjo gjendje zgjati deri në fund të shekullit të 19-të. Shekulli në vijim pati ndryshime rrënjësore në fizionominë e këtij organi: e drejta për kontroll kushtetues të vendimeve administrative, ndalimi i dekreteve **ex post facto**, liria e ndërgjegjes, si dhe barazia para ligjit kanë qenë disa nga parimet të cilat Këshilli i shqyrtoi dhe vendosi si standarde të reja. Këtë e bëri duke u bazuar , jo në tekstin kushtetues francez , por në “traditat republikane”, duke pasur për efekt imediat kontrollin e kushtetutshmërisë së veprimit administrativ të shtetit. Me “traditë republikane” u nënkuptua, atëherë dhe sot, fryma dhe germa e Deklaratës mbi të Drejtat e Liritë e Njeriut dhe të Qytetarit (1789) dhe Preambula e Kushtetutës së Francës e vitit 1946. Duhet theksuar se ky kontroll i legjitimitetit kushtetues të veprimit administrativ të

---

<sup>13</sup> Marie – Luce Paris, “Europeanization and Constitutionalization: The Challenging Impact of a Double Transformative Process on French Law.” *YEARBOOK OF EUROPEAN LAW* No. 29/2010 (Clarendon Press: Oxford, 2010) fq. 21-64; Kemal GÖZLER, LA QUESTION DE LA HIÉRARCHIE ENTRE LES NORMES CONSTITUTIONNELLES. *Annales de la Faculté de droit d’Istanbul*, Vol. XXXII, No.48, 1998, fq. 65-92.

shtetit kufizohej vetëm në vendimin konkret individual, pra jo edhe në legjislacionin bazë që ka shërbyer si bazë juridike për marrjen e vendimit konkret administrativ në një rast individual. Legjislacioni bazik ngelej në fuqi: shfuqizohej vetëm vendimi konkret administrativ i dhënë në një rast individual kurse qytetarit i takonte e drejta e zhdëmtimit si pasojë e dëmit eventual të shkaktuar nga një vendim i tillë administrativ antikushtetues.

Mundësia që **Këshilli i Shtetit** (*Conseil d'Etat*) të bëjë kontrollin kushtetues edhe të akteve juridike lindi vetëm pas nxjerrjes së Kushtetutës së vitit 1958. Kjo Kushtetutë në nenet e saj 37 dhe 38 lejonte nxjerrjen e akteve juridike me karakter legjislativ nga ana e ekzekutivit francez. Kjo nënkuptonte se, tani e tutje, mund të bëhej edhe vlerësimi i kushtetutshmërisë së këtij aktiviteti legjislativ të ekzekutivit francez. Një mundësi e tillë u bë e ditur në rastin e njohur si **Syndicat General** (1959). Në këtë rast, i cili kishte të bënte me një rregullore qeveritare që u jepte arkitektëve të drejtën ekskluzive për kryerjen e punëve të caktuara profesionale në kolonitë franceze, Këshilli theksoi se ishte e domosdoshme që të përcaktonte kufijtë e pushtetit rregullativ të ekzekutivit francez dhe caqet e kontrollit gjyqësor të këtij pushteti. Si bazë kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së këtyre akteve rregullative shërbenin parimet e përgjithshme të së drejtës të inkorporuar në Deklaratën mbi të Drejtat dhe Liritë e Njeriut dhe të Qytetarit (1789) dhe parimet e përmbajtura në Preambulën e Kushtetutës së Francës e vitit 1958.

Organi tjetër, **Këshilli Kushtetues** (*Conseil Constitutionnel*), poashtu pati evoluim të madh të kompetencave të veta. Kur u themelua, me Kushtetutën e vitit 1958, për qëllim kryesor e pat ndihmën ndaj ekzekutivit të kryesuar nga gjenerali **De Gol** (*Charles de Gaulle, 1890-1970*) në ushtrimin e kompetencave të veta ligjvënëse të fituara me Kushtetutën e Republikës së Pestë të vitit 1958. Si një organ politik, si juridiksion primar e ka pasur sigurimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollin kushtetues të aktivitetit ligjvënës të parlamentit francez me qëllim të mbrojtjes së ekzekutivit. Në traditën e saj specifike të supremacisë (epërsisë) parlamentare, Franca deri në vitin 1958 ka pasur organe politike brenda ligjvënësit, të cilat si të tilla kanë pasur për detyrë vlerësimin e kushtetutshmërisë së draft - ligjeve. Ky kontroll preventiv, pra kontroll i ligjeve para se të hyjnë në fuqi dhe derisa akoma janë në draft, nuk prodhonte asnjë detyrim për ligjvënësin francez. Kjo donë të thotë se ligjvënësi francez mund ta merrte parasysh vetëm nëse i shkante për shtati.

Gjendja ndryshoi me Kushtetutën e vitit 1958. Tani e tutje Këshilli kishte të drejtën e kontrollit preventiv (paraprak) të kushtetutshmërisë së ligjeve. Me kontroll të tillë nënkuptohej e drejta e Këshillit për të shpallur si jokushtetues një draft-ligj të votuar në parlament, por që akoma nuk ka hyrë në fuqi. Ky kontroll i kushtetutshmërisë bëhej vetëm ndaj ligjeve të njëlëmi të caktuar, përkatësisht vetëm ndaj ligjeve që rregullonin ndarjen e pushtetit ligjvënës nga ai ekzekutiv, siç ishte përcaktuar me nenet 34, 37 dhe 38 të Kushtetutës së vitit 1958. Me këto nene të Kushtetutës, ekzekutivi kishte fituar të drejta të mëdha ligjvënëse kundrejt parlamentit francez. Këshilli kishte për detyrë që tëmbikëqyrtelegjislativin dhe ta garantonte ekzekutivin se nuk do të lejonte që parlamenti francez të ndërhynte në ushtrimin e autorizimeve të reja kushtetuese.

Kompetencat e Këshillit u zgjeruan më 1971, nërastin e njohur si **liria e asociimit**. Në këtë rast, Këshilli gjeti se kishte të drejtën e kontrollit kushtetues të ligjeve franceze jo vetëm kur flitej për ndarjen e pushteteve, por edhe kur ligjet cenonin të drejtat dhe liritë e francezëve . Ky vendim u mor sërish duke u bazuar në norma që nuk gjendeshin në tekstin e Kushtetutës së vitit 1958. Kjo u arrit përmes ri-interpretimit tjetërfare të teksteve të mëhershme kushtetuese, të cilat në doktrinë u cilësuan si “**blloku i kushtetutshmërisë**” (*bloc de constitutionalite*). Në këtë grup hyjnë **Deklarata Franceze mbi të Drejtat e Njeriut dhe të Qytetarit**(1798), preambulat e kushtetutave të vitit 1946 dhe 1958, parimet e njohura nga ligjet e Republikës dhe, së fundi, parimet e domosdoshme të kohës së sotme. Në këto parime bëjnë pjesë, **inter alia**, barazia para ligjit, liria e asociimit, barazia e gjinive dhe kështu me radhë<sup>14</sup>.

Vendimi i vitit 1971 dhe parimet e mishëruara aty u kristalizuan aq shumë me kalimin e kohës, aq sa askush asnjëherë nuk e vuri në pyetje. Siç u tha më sipër, parimet në fjalë të mishëruara në vendimin e vitit 1971 fare nuk figurojnë nëtekstin e asnjërës prej kushtetutave franceze , përfshirë këtu edhe Kushtetutën e vitit 1958. I një natyre të tillë ka qenë edhe parimi i lirisë së asociimit, i cili shërbeu si bazë për marrjen e vendimit të vitit 1971, një vendim mjaft i favorshëm për shoqatat (e paregjistruara ) jofitimprurëse :

---

<sup>14</sup> Marie - Claire Ponthoreau and Fabrice Hourquebie, “France: The French *Conseil Constitutionnel*: An Evolving Form of Constitutional Justice”. Në Andrew Harding and Peter Leyland (eds.), *Constitutional Courts . A Comparative Study* (Wildy, Simmonds & Hill Publishing : London, 2009) fq. 81-101; Marie - Claire Ponthoreau and Jacques Ziller , “The Experience of the French *Conseil Constitutionnel* : Political and Social Context and Current Legal-Theoretical Debates”. Në Wojciech Sadurski (ed.), *Constitutional Justice , East and West. Democratic Legitimacy and Constitutional Courts in Post – Communist Europe in a Comparative Perspective* (Kluwer Law International : The Hague, 2010) fq. 119-142.

vendimi shpalli jokushtetues ligjin francez të vitit 1971 që kërkonte regjistrimin si kusht për veprim të shoqatave jofitimprurëse. Tani e tutje, në emër të lirisë së asociimit, shoqatat jofitimprurëse mund të operonin në Francë pa pasur asnjë nevojë që të regjistroheshin.

Në vijim si më sipër, zgjerimi i juridiksionit të **Këshillit Kushtetues** (*Conceil Constitutionel*) më 2010 qe aq i madh sa e bëri gati një organ gjysmë – gjyqësor. Këtë herë si bazë shërbeu një akt juridik jofrancez dhe të drejtat e liritë njerëzore të njohura nga ky akt jofrancez. E kemi fjalën për **Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut**. Njëjtësiç kishte ndodhë me Britaninë e Madhe më 1998, kur u miratua **Ligji për të Drejtat e Njeriut** (*Human Rights Act*), edhe Franca u detyrua që ta ndryshojë legjislacionin e brendshëm me të cilin përcaktohet vendi dhe rëndësia e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rendin nacional kushtetues. Tani, me këtë ndryshim, Këshilli u mandatua për të kryer kontrollin e kushtetutshmërisë së legjislacionit francez në fuqi me qëllim të vlerësimit nëse ky legjislacion është në pajtim me liritë dhe të drejtat e njeriut të garantuara me **bllokun e kushtetutshmërisë** (*bloc de constitutionalite*). Në këtë bllok përfshihet, në mënyrë efektive, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kjo donë të thotë se gjykatat franceze me rastin e vendosjes për rastet dhe mosmarrëveshjet konkrete të shtruara për zgjidhje pranë tyre, tani e tutje, kanë për detyrë që të shikojnë nëse ligji francez, apo ndonjë akt tjetër nënligjor, cenon ndonjëherë nga të drejtat dhe liritë individuale të garantuara me **bllokun e kushtetutshmërisë** (*bloc de constitutionalite*), ku përfshihet edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Nga kjo si më sipër qartë shihen dy ndryshime të mëdha të cilat kanë ndodhur, të cilat mëherët nuk kanë ekzistuar në rendin nacional kushtetues francez. E para, **Këshilli Kushtetues** (*Conceil Constitutionel*) tani e tutje e kryen edhe kontrollin kushtetues të ligjeve në fuqi, pra të atyre ligjeve që kanë hyrë në fuqi dhe aktualisht zbatohen. Ky njihet si kontroll represiv i legjitimitetit kushtetues të ligjeve. E dyta, ky kontroll nuk kufizohet vetëm në analizimin nëse ligji francez cenon të drejtat e ekzekutivit, por edhe nëse ai i cenon liritë dhe të drejtat themelore të individit, ashtu siç janë interpretuar këto liri dhe të drejta nga ana e Këshillit në vendimet e veta të mëparshme. Si bazë për vendimmarrje Këshilli ka **bllokun e kushtetutshmërisë** (*bloc de constitutionalite*), në të cilin bënë pjesë edhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Me këtë Këshilli ka marrë funksionin gjyqësor të gardianit të lirive dhe të drejtave themelore të individit kundër cenimeve eventuale të tyre nga ligjet e parlamentit francez dhe nga akterët tjerë të rendit nacional kushtetues. Duhet theksuar se, megjithatë, për



dallim nga sistemi amerikan, gjykatat e ulëta franceze, të cilat kanë mandat për ta referuar çështjen në Këshill për **kontroll prioritar të kushtetutshmërisë**, nuk kanë të drejtë të kryejnë vlerësimin e legjitimitetit kushtetues të ligjit apo ta mënjanojnë zbatimin e tënjëjtit. Franca ngelet në grupin e modelit kelsenian/evropian të kontrollit të centralizuar të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve tjera juridike. Në këtë sistem , gjyqësori i rregullt nuk ka të drejtë që i lejohet që ta mënjanoj zbatimin përgjithmonë të normës juridike që duhet ta zbatojë në një rast apo mosmarrëveshje konkrete. Kur dyshon në kushtetutshmërinë e normës, gjyqtari i rregullt vetëm ka të drejtë që ta referoj çështjen në **Këshillin Kushtetues** përmes gjykatave më të larta të vendit, pra nuk mund tabëjë vet vlerësimin përfundimtar të kushtetutshmërisë së normës në rastet kur dyshon në kushtetutshmërinë e saj.

Në një rast të tillë, jo vetëm në Francë, por edhe në sistemet tjera të kontrollit të centralizuar të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve tjera, gjykata referuese ia referon normën juridike për kontroll kushtetues gjykatës kushtetuese nacionale, duke e pritur deri sa kjo gjykatë ta thotë fjalën e fundit në mënyrë autoritative dhe përfundimtare lidhur me kushtetutshmërinë e normës juridike e cila duhet të zbatohet në një rast apo mosmarrëveshje konkrete pranë një gjykate tërregullt. Referimi mund të jetë direkt, kur çdo gjykatë e rregullt ka të drejtë të referoj çështje në gjykatën nacionale kushtetuese, apo i tërthortë, kur ky referim mund të bëhet vetëm përmes gjykatave më të larta në sistemin e gjyqësisë së rregullt (gjykatat supreme të cilitdo juridiksion). Franca dhe Këshilli Kushtetues bien në kategorinë e dytë të sistemeve të kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve dhe akteve tjera juridike.

### 3. PAVARËSIA E SHBA-VE DHE KONTROLLI GJYQËSOR

I ashtuquajtur **Revolucioni Madhështor i Anglisë** (1688) ndërpreu atë pak praktikë gjyqësore të filluar me rastin **Dr. Bonham**. Në fillim, sikur u duk që Anglia do të jetë djepi i kontrollit gjyqësor të legjitimitetit kushtetues të ligjeve dhe akteve tjera juridike. Kjo , megjithatë, nuk ndodhi kështu: në vitin 1688 në Angli u shpall epërsia absolute e parlamentit anglez . Kjo nënkuptonte se, për pasojë, **jus positivum** (*e drejta pozitive*) që prodhohej nga parlamenti ishte e barasvlershme me vullnetin e sovranit , tanimë i kuptuar si popull jo si mbret.

Në praktikë, kjo nënkuptonte se gjyqtarët nuk mund të bënin asnjë kontroll të kushtetutshmërisë së legjislacionit anglez . Tënjëjtin duhej ta zbatonin ashtu siç e shihnin, në mënyrë tekstuale. Ajo që shihet si superiore, më e lartë se rendi pozitiv britanik, “common law” (“e drejta e përgjithshme”) vlente vetëm si një instrument për kufizimin e pushtetit të mbretit dhe për atë që mbreti i kundërvihet vullnetit të sovranit (popullit). Ligjet britanike , për këtë arsye, duhej të merreshin ashtu siç janë, si vullnet suprem i sovranit, kurse “common law” (“e drejta e përgjithshme”) si një instrument që kufizonte pushtetin absolut të mbretit.

Në kolonitë britanike në Amerikë kjo logjikë pati një kuptim tjetër, siç u konstatua mëherët, përkatësisht autorizonte gjyqtarët kolonial që të shpërfillnin çdo legjislacion që binte ndesh me të drejtën pozitive angleze. Në këtë mënyrë, në kolonitë angleze parimi i epërsisë së pakontrolluar të legjislacionit ndihmoi, nuk pengoi, formimin e një sistemi tërësisht të kundërt me atë në metropol: ky sistem u jepte të drejtë gjyqtarëve që të kontrollonin vlefshmërinë e legjislacionit kolonial. Ky kontroll i vlefshmërisë së legjislacionit kolonial bëhej duke pasur për pikë referimi ligjet e kurorës të nxjerra nga parlamenti anglez, **të drejtën pozitive** (*jus positivum*), pra jo “të drejtën e përgjithshme” (“common law”). Kjo përvojë ka qenë e njëjtë edhe në kolonitë tjera, si në Australi, Kanada, Indi, etj., të cilat poashtu pranuan kontrollin gjyqësor të vlefshmërisë së ligjeve pas pavarësimit të tyre. Donë të thotë se SHBA-ja nuk është e vetmja që ka ndjekur këtë rrugë.

Më pavarësimin e SHBA-ve , si grup i ish kolonive britanike, më 4 korrik 1776, janë nxjerr kushtetutat si akte themelore përmes së cilave bëhej zëvendësimi i të ashtuquajturave **karta** (*charters*) . Në kohën koloniale , **kartat** (*charters*) kishin shërbyer si kushtetuta të ish kolonive amerikane. Forma dhe përmbajtja e kushtetutave të shteteve anëtare të SHBA-ve ishte krejtësisht tjetër nga forma dhe përmbajtja e **kartave** (*charters*) të kohës koloniale. Vënia e tyre në jetë , megjithatë, la prapa vetes një trashëgimi të pasur në lëmin e gjyqësisë kushtetuese , praktikë që vazhdon deri në ditët e sotme: njëjtë si në të kaluarën, kur ligjet e kolonive duhej të ishin në tënjëjtin kohë në pajtim me **kartat** (*Charter*) dhe me të drejtën angleze, ligjet e reja të ish kolonive tani të pavarësuarqë nga data 4 korrik 1776 duhej të ishin në pajtim me kushtetutat e reja të shteteve të reja sovraane dhe të pavarura. Në rast mospajtimi të legjislacionit të ri me kushtetutat e reja të shteteve anëtare të SHBA-ve, atëherë ai legjislacion konsiderohej si i pavlefshëm dhe nuk prodhonte asnjë pasojë juridike. Më vonë, pas vendimit në rastin **Marbury vs Madison** (1803) legjislacioni i ri duhej të ishte në

pajtim me Kushtetutën Federale, si bazë e rendit të ri më superior, më të lartë, se rendi i krijuar me kushtetutat e shteteve anëtare të Federatës.

Në literaturë janë shënuar rastet e shumta të precedentëve gjyqësore amerikane që kanë mbrojtur këtë qëndrim, pra se kontrolli gjyqësor i legjitimitetit kushtetues legjislacionit shtetëror duke pasur për bazë kushtetutat e reja të shteteve amerikane ka nisur shumë kohë para rastit **Marbury vs. Madison** (1803). Ky rast vetëm e ka ndërruar, e ka zhvendosur pikën e referimit nga kushtetutat e shteteve anëtare në Kushtetutën Federale, si bazë e rendit të ri superior, më të lartëse rendi i krijuar përmes kushtetutave të njëjësive federale. Ekziston një shekull praktikë gjyqësore amerikane që flet qartë për kryerjen e kontrollit gjyqësor të kushtetutshmërisë së ligjeve, i cili bëhej gjatë kohës koloniale me qëllim të shikimit nëse ligjet e reja ishin në pajtim me **kushtetutat** (*charters*) të kolonive amerikane. Paragrafi 2 i nenit VI të Kushtetutës së SHBA-ve (1789) nuk ka bërë asgjë tjetër vetëm se ka sanksionuar këtë praktikë të gjykatave amerikane nëpër shtetet e reja të pavarura, që ka ekzistuar para dhe pas fitimit të pavarësisë së tyre<sup>15</sup>. Këto gjykata siguronin, përmes interpretimit gjyqësor, supremacinë (epërsinë) e kushtetutave të reja kur ato u nxorën kundrejt çdo ligji apo akti tjetër juridik, ngjashëm siç kishin bërë mëherët duke siguruar epërsinë e legjislacionit britanik kundrejt çdo legjislacioni tjetër të vlefshëm nëpër koloni<sup>16</sup>.

Paragrafi 2 i nenit VI, nëveçantiashtu siç është interpretuar nga **Xhon Marshall** (*John Marshall*), paraqet një risi radikale dhe ka qenë , për dy arsye, i një rëndësie të madhe për sistemin kushtetues amerikan. Në rend të parë, ai paragraf i Kushtetutës ka shërbyer si burim i supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës ndaj ligjeve dhe akteve tjera juridike. Së dyti, paragrafi në fjalë ka mandatuar me pushtet të detyrueshëm gjyqësorin amerikan për të shpërfillur ligjet dhe aktet tjera juridike të cilat eventualisht mund të binin

---

<sup>15</sup>Neni VI (Paragrafi 2) i Kushtetutës së SHBA-ve të vitit 1789: “Kjo Kushtetutë do të jetë ligji suprem në vend dhe ligjet e Shteteve të Bashkuara duhet të nxirren në bazë të saj, si dhe çdo traktat i bërë ose që mund të bëhen nën autoritetin e Shteteve të Bashkuara; gjyqtarët në secilin shtet do të jenë të detyruar ta zbatojnë pa marrë parasysh dispozitat e kundërta të cilat mund të ekzistojnë në kushtetutat apo ligjet e shteteve anëtare.”

<sup>16</sup> Edward Samuel Corwin, *The Doctrine of Judicial Review . Its Legal and Historical Basis , and Other Essays [1914]* (Princeton University Press: Princeton , 1914) fq. 1-78; Kermit L. Hall (ed.), *Major Problems in American Constitutional History. Documents and Essays . Vol. I : The Colonial Era Through Reconstruction* ( D.C. Heath and Company: Lexington, Massachusetts and Toronto, 1992) fq. 278-289.; William E. Nelson, *Marbury v. Madison. The Origins and Legacy of Judicial Review* (University Press of Kansas: Kansas, 2000) fq. 28-71.

ndesh me Kushtetutën. Siç u tha mëherët, supremacia (epërsia) e Kushtetutës prezumohej duke u bazuar në përvojën koloniale sipas së cilës ligjet dhe çdo akt tjetër juridik në koloni nuk guxonte të binte ndesh me vullnetin e sovranit (popullit), të shprehur përmes legjislacionit britanik si pasojë e epërsisë absolute të parlamentit kundrejt degëve tjera të pushtetit. Në momentin e fitimit të pavarësisë më 1776, kolonitë dhe gjyqtarët e shteteve të reja amerikane vazhduan këtë praktikë të njëjtë, mirëpo tani nuk bëhej sigurimi i supremacisë (epërsisë) përmes interpretimit të legjislacionit britanik si superior apo më i lartë se legjislacioni kolonial, por përmes sigurimit të supremacisë (epërsisë) përmes interpretimit gjyqësor të kushtetutave të reja të nxjerra nga 13 shtetet amerikane, tanimë të pavarura. Kur u nxor Kushtetuta e vitit 1789, krejt në mënyrë të natyrshme u fut nëni VI, paragrafi i dytë i të cilit garantonte supremacinë (epërsinë) e Kushtetutës Federale kundrejt kushtetutave dhe legjislacionit të shteteve anëtare. Kushtetuta Federale u pa si një ligj fundamental, superior dhe i pandryshueshëm me ligje dhe akte tjera të zakonshme (qofshin federale apo të shteteve anëtare). Po të mos ndiqej kjo rrugë, Kushtetuta Federale do të ishte vënë në një nivel të njëjtë me ligjet dhe aktet tjera juridike të zakonshme (qofshin federale apo të shteteve anëtare) me mundësi ndryshimi nga organi legjislativ në procedurë të zakonshme. Pranimi i kësaj alternative pat për pasojë faktin se çdo ligj ose akt juridik tjetër që binte ndesh me Kushtetutën nuk konsiderohej i vlefshëm dhe, për pasojë, duhej të shpërfilllej nga ana e gjyqësorit gjatë procedurës së zbatimit në një procedurë konkrete. Sikur të pranohej alternativa tjetër, gjë që nuk u bë, atëherë Kushtetuta Federale do të cilësohej si një nga ligjet e zakonshme dhe si një përpjekje e pavlerë për të kufizuar pushtetin, i cili, natyrshëm, nuk ka kufij. Në një rast të tillë, interpretimi gjyqësor me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës Federale nuk do të kishte asnjë kuptim.

Vendimi në rastin **Marbury v Madison** (1803) me të cilin shpallej supremacia (epërsia) e Kushtetutës së vitit 1789 kundrejt kushtetutave shtetërore, ligjeve dhe akteve tjera juridike të shteteve anëtare, si dhe e drejta e pushtetit gjyqësor për të shpërfillur (moszbatuar) ligjet dhe aktet tjera jokushtetuese ka paraqitur një risi të madhe. Kjo, në parim, lidhet me natyrën e pandryshueshme të shumicës së kushtetutave nacionale të vendeve të botës. Mund të thuhet se, aktualisht, gati të gjitha kushtetutat kanë tendencën për të qenë të ngurta dhe jo lehtë të ndryshueshme. Lëvizja që filloi me **Marbury v Madison** (1803) kishte për qëllim pikërisht këtë: që kushtetutat nacionale të interpretoheshin nga një organ gjyqësor apo ndonjë organ tjetër i mandatuar për interpretim të tekstit kushtetues me qëllim që të sigurohej supremacia (epërsia) e tij kundrejt çdo ligji apo akti tjetër juridik.

Me një fjalë, **Marbury v Madison** (1803) nisi epokën kolosale në konstitucionalizmin modern sipas të cilit gjykatat ose organet tjera të mandatuara për të ruajtur supremacinë (epërsinë) e kushtetutës nacionale nuk duhej të lejonin që ligjet dhe aktet tjera të zakonshme të bien ndesh me kushtetutën e vendit.

Shumica e vendeve të Evropës së sotme, në një fazë të caktuar të zhvillimit të tyre kanë shprehur dëshirën dhe përpjekjet për të siguruar supremacinë (epërsinë) e kushtetutës së tyre kundrejt ligjeve dhe akteve tjera juridike. Përvojat evropiane, megjithatë, kanë qenë të ndryshme . Shtetet evropiane kanë përqaftuar rrugë të ndryshme të arritjes së këtij qëllimi , pra të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës nacionale ndaj ligjeve dhe akteve tjera juridike. Në disa raste janë përzgjedhur legjislaturat si organe të përshtatshme për të siguruar supremacinë (epërsinë) e kushtetutës (kontrolli politik i kushtetutshmërisë). Në rastet tjera kanë qenë organet gjyqësore të kompetencës së përgjithshme (gjyqësori i rregullt) si të mandatuara me këtë detyrë. Në fund, në shumicën e vendeve evropiane, kanë qenë organet krejtësisht tjera , të ngjashme me gjyqësorin mirëpo me një kompetencë tëveçantë për interpretim të kushtetutës me qëllim të vetëm sigurimin e supremacisë (epërsisë) së saj ndaj burimeve tjera të së drejtës . E kemi fjalën për gjykatat kushtetuese si mekanizmat institucional më të përhapur për arritjen e këtij qëllimi.

Aty ku legjislativi ka kompetencë dhe mandat për të siguruar supremacinë (epërsinë) e kushtetutës ndaj ligjeve të zakonshme dhe akteve tjera juridike, brenda tij formohen trupa që bëjnë kontrollin kushtetues të ligjeve para se të votohen në parlament. I tillë është rasti me Finlandën dhe disa vende tjera evropiane, ku trupat e tilla në kuadër të legjislativit paraqiten si mjaft efektiv në arritjen e qëllimit primar: sigurimin e supremacisë (epërsisë) së kushtetutës kundrejt ligjeve dhe akteve tjera juridike. Këtu në vijim flasim vetëm për organet gjyqësore dhe organet tjera të ndara nga gjyqësori me kompetencë tëposaçme për interpretim të kushtetutës vendore, përvojë që ka lindur me rastin **Marbury v Madison** (1803) dhe më vonë është përhapur në tërë botën. Ne fillojmë me Evropën sepse këtu u çua deri në perfeksion praktika e sigurimit të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës përmes kontrollit kushtetues, praktikë që kishte nisur në SHBA qysh në kohët koloniale.

#### 4. PËRHAPJA E KONTROLLIT GJYQËSOR NË EVROPË

Ideja amerikane , sipas së cilës gjyqtarët kanë mandat për të moszbatuar ligjet dhe aktet tjera juridike që i konsiderojnë si jokushtetuese , fillimisht u përhap në **Meksikë**. Në këtë vend u krijua instituti **amparo contra leyes** që kishte për qëllim t'i jepte të drejtën gjyqësorit meksikan, njëjtë si në SHBA, për kryerjen e kontrollit të kushtetutshmërisë së ligjeve me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së Kushtetutës së Meksikos të vitit 1847. Më pastaj , ideja amerikane u përhap në vendet tjera të Amerikës Latine, ashtu që sot **amparomund** të ushtrohet jo vetëm kundër ligjeve , por kundër çdo vendimi administrativ dhe gjyqësor, si dhe për të siguruar të drejtat e garantuara kushtetuese. Këtë institut me këtë natyrë tani e njohin edhe vendet tjera, si Argjentina, Çile, Kolumbia, Haiti etj.

Në Evropë, **Zvicra** ka qenë vendi i parë që ka krijuar institutin e a.q. **recurs de droit public** , i cili kishte për qëllim sigurimin e kushtetutshmërisë së ligjeve kantonale. Në fund të shekullit 19, **Norvegjia**, kurse në fillim të shekullit në vijim, **Danimarka** , krahas **Rumanisë**, **Greqisë** dhe **Portugalisë** mandatuan gjyqësorin e rregullt me të drejtën për kontroll kushtetues të ligjeve me qëllim që të sigurohej supremacia (epërsia) e kushtetutave nacionale . Të gjitha këto përpjekje u mbyllën pa ndonjë sukses të përhershëm. Vetëm pas Luftës së Parë Botërore mund të thuhet se në Evropë ka nisur njëpërpjekje konkrete më serioze, si në teori ashtu dhe në praktikë, me qëllim të sigurimit në mënyrë institucionale të epërsisë së kushtetutës nacionale kundrejt ligjeve dhe akteve tjera juridike . **Austria** (1919-1938) dhe **Gjermania e Vajmarit** (1918-1933) kanë qenë djepi i kësaj praktike dhe i arsytimit të saj teorik.

Në **Austrinë** e mundur në projektin e saj perandorak, **Hans Kelzen (Hans Kelsen)** dhe një grup dijetarësh të kohës kanë shtjelluar deri në detaje kushtetutën austriake dhe gjermane, të cilat synonin të ndërtonin një shoqëri të re duke u bazuar , jo më në vullnetin e shumicës por në parametrat e demokracisë kushtetuesesiq e njohim sot. **Kushtetuta e Austrisë** (1920) parashikonte themelimin e një gjykate kushtetuese, e cila kishte për detyrë kontrollin kushtetues të ligjeve dhe akteve tjera me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës. Kontrolli kushtetues i ligjeve, në fillim ishte kontroll kushtetues paraprak (preventiv), pra para se të hynin në fuqi. Kushtetuta i jepte Gjykatës Kushtetuese një rol qendror nësaktësimin dhe vënien në jetë të demokracisë së re kushtetuese austriake. Në të njëjtën kohë me këtë, në fakt disa muaj mëherët, në **Çekosllovakia** u krijua, pa ndonjë

sukses, gjykata kushtetuese e këtij vendi, e cila nuk bëri më shumë se kontrollin kushtetues të vetëm dy ligjeve.

Ardhja e **Hitlerit** në pushtet dhe nazifikimi i shumicës së vendeve të Evropës Qendrore pati për pasojë eliminimin e këtyre dy institucioneve të rëndësishme për zhvillimin e demokracisë kushtetuese nëtrualin e Evropës. Gjykatat kushtetuese në këto dy vende paraqisnin antipodin e kundërt me diktaturat fashiste të instaluar në Evropë në atë kohë. E njëjtavlen edhe për **Kushtetutën e Republikës së Spanjës** të vitit 1931, e cila parashikonte ndërtimin e një gjykate kushtetuese, projekt që ngeli në letër si pasojë e përmbysjes së kësaj republike të tipit komunist nga ana e diktaturës së djathtë të instaluar më 1939 nga gjenerali **Francisko Franko** (*Francisko Franko: 1892-1975*)

Në **Gjermaninë e Vajmarit** nuk qe parashikuar themelimi i një gjykate tëveçantë kushtetuese. Me një vendim të datës 4 nëntor 1925 të Gjykatës së Lartë të Rajhut të Gjermanisë u ndoq praktika e kontrollit kushtetues të ligjit sipas modelit **Marbury vs Madison** (1803). Vendimi, megjithatë, nuk u bazua në dispozitat e **Kushtetutës së Vajmarit** (1919), sepse ato nuk parashikonin një të drejtë të tillë të gjyqësorit gjerman, por në parimin e ruajtjes së epërsisë së kushtetutës sipas së cilës asnjë ligj apo akt tjetër juridik nuk guxon të jetë në kundërshtim me të. Ky vendim afirmonte fuqishëm precedentin e nisur në rastin **Marbury v Madison** (1803) dhe, së bashku me **Kushtetutën e Vajmarit**, ka shërbyer edhe si shembull në debatin në mes të **Hans Kelzen** dhe **Karl Shmit** (*Carl Schmitt*) në mesin e viteve njëzet të shekullit 20-të. Këtu mjafton të thuhet përciptazi se autori i parë, **Hans Kelzen**, me ngulm ka mbrojtur teorinë mbi gjykatën kushtetuese si gardian të epërsisë së kushtetutës, i dyti, **Karl Shmit**, ka insistuar në institucionet e shefit të shtetit si gardian të epërsisë së kushtetutës.

Në përgjithësi, diskursi teorik, si dhe praktika në lëmin e gjyqësisë kushtetuese në mes të dy luftërave botërore kanë qenë mjaft të varfër dhe krejt në fillet e tyre. Vetëm pas mbarimit të Luftës së Dytë botërore nis një fazë e re dhe më serioze në zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese siç e njohim sot. Periudha pas Luftës së Dytë Botërore e zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese aktualisht ndahet në tri faza<sup>17</sup>. Këto faza në kapitullin tjetër

---

<sup>17</sup> Në fakt, si fazë e parë në zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese në kuptimin global mund të konsiderohet periudha në mes të dy luftërave botërore. Kjo paraqet fazën e krijimit të gjykatave të para kushtetuese, si gjykata të kompetencës së veçantë dhe të ndara nga gjyqësori i rregullt. Në këtë periudhë ka nisur eksperimenti jo shumë i suksesshëm me gjyqësinë kushtetuese të tipit të centralizuar, Vendi i parë që bëri gjykatë të veçantë

diskutohen mëgjërisht, kurse këtu vetëm shkarazi sa për informim bazik lidhur me momentet kyçe në zhvillimin e gjyqësisëkushtetuese.

E para fillon më themelimin dhe rithemelimin e gjykatave kushtetuese në **Austri, Itali dhe Gjermani** si dhe me pranimin e kontrollit kushtetues si një mekanizëm kyç në sigurimin e epërsisë së kushtetutës në Japoni, Indi, Kanada dhe disa vende tjera që modelohen sipas sistemit amerikan të kontrollit kushtetues.

Kushtetuta e Republikës së Italisë e vitit 1948 , si çdo kushtetutë e nxjerrë pas përmbytjeve të thella shoqërore mëtonte të ishte programatike dhe progresive në tënjëjtën kohë. Sanksiononte vlera të reja dhe një sistem kushtetues tërësisht të ri që për qëllim parësor kishte ndryshimin rrënjësor të shoqërisë italiane duke synuar që ta linte në harresë të kaluarën e hidhur që kishte ndodhur para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore nën regjimin e diktatorit **Benito Musloni**. Në këtë ambient të ri, gjyqtarët e vjetër, nëveçanti ata në Gjykatën Supreme të Kasacionit dhe në gjykatat italiane të apelit kishin shumë rezerva ndaj implementimit të kësaj kushtetute të re italiane, e cila bënë një ndërprerje radikale me të kaluarën dhe synonte transformimin e shoqërisëitaliane në një shoqëri demokratike ku sundojnë kushtetuta e ligjit, të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të minoriteteve.

Themelimi i Gjykatës Kushtetuese në vitin 1956 shënon momentin kyç në zhvillimin e demokracisëkushtetuese italiane sepse, tani e tutje , Kushtetuta e vitit 1948 kishte një garantues tëpacenueshmërisë së saj, të vënies së saj në jetë. Kushtetuta italiane deri atëherë qe cilësuar si një “kushtetutë e porealizueshme”. Në Gjykatën Kushtetuese, Italia gjeti instrumentin parësor dhe jashtëzakonisht efektiv për të penguar rikthimin e regjimit autoritar të së kaluarës dhe, në tënjëjtën kohë, për të siguruar paprekshmërinë e vlerave shoqërore dhe individuale të proklamuar në Kushtetutën e vitit 1948. Përmes kontrollit kushtetues të ligjeve u hap mundësia që Gjykata Kushtetuese të bëjë pastrimin e rendit italian nga mbeturinat legjislativive të kohës së**Musolinit**dhe, në tënjëjtën kohë, të vinte në pah zbrazëtitrat juridike që duheshin mbushur përmes aktivitetit të legjislativit të ri demokratik italian.

---

kushtetuese qe Çekosllovakia në shkurt të vitit 1920, pastaj Austria në tetor të atij viti, Lihtenshtajni (1925) , Greqia (1927) Spanja (1931) , Kuba (1940) dhe, së fundi, Egjipti (1941). Shih më shumë për këtë në L. Mezzetti, M. Belletti, E. D’Orlando, E. Ferioli , op. cit. fq. 104-105.



Kombi gjerman kishte vuajtur nga mbidemokracia , përkatësisht nga sundimi i pakontrolluar i parimit të shumicës. Që nga unifikimi gjerman nën kancelarin gjeneral **Oto fon Bismark** (*Otto von Bismarck: 1815-1898*) më 1871, Gjermania kishte probleme me kontrollin e vullnetit të shumicës, diçka që në mënyrë esenciale ka ndihmuar ardhjen në pushtet të **Hitlerit** më 1933. Pas tragjedisë së Luftës së Dytë Botërore, njëjtë si **Italia, Gjermania** pa në kontrollin kushtetues mekanizmin kryesor që mund të garantonte demokracinë e re kushtetuese nga rrëshqitja në diktaturë të re të shumicës. Situatë e njëjtë mbretëronte në **Japoni**, ani se atje nuk u themelua një gjykatë kushtetuese e ndarë nga sistemi i korruptuar gjyqësor perandorak. Kjo rrethanë, pra mosthemelimi i gjykatës së re kushtetuese sipas modelit evropian, nuk çonte shumë peshë sepse Gjykata Supreme e Japonisë luajti një rol të madh në kontrollin kushtetues të ligjeve dhe akteve tjera juridike japoneze, në mënyrë që ato të mos binin ndesh me Kushtetutën e re të Japonisë të vitit 1947. Kjo kushtetutë u miratua nën përkujdesjen dhe kontrollin e plotë të regjimit ushtarak të gjeneralit amerikan **Daglas Mek Arthur** (*Douglas MacArthur: 1880-1964*). Si e tillë, Kushtetuta riorientonte Japoninë kah vlerat liberale të shoqërive demokratike kushtetuese perëndimore, një përvojë tërësisht e re krahasuar me sundimin absolut të perandorit **Hirohito** (*Michinomiya Hirohito: 1901-1989*) , bazuar në **Kushtetutës Meiji** të vitit 1889.

Fenomeni i gjyqësisë kushtetuese , përkatësisht i kontrollit kushtetues të vullnetit të sovranit të shprehur përmes ligjeve nuk kufizohej vetëm në Itali, Japoni dhe Gjermani. Kushtetuta e Austrisë e vitit 1920, e rikthyer më 1946, së bashku me Gjykatën Kushtetuese dhe tërë sistemin kushtetues liberal të cilin e kishte shkatërruar më 1933 regjimi diktatorial i kancelarit nationalist austriak **Engelbert Dollfuss** pas të a.q. “shpërndarjes” (“*Selbstauflösung*”) së Parlamentit. Kjo kishte ndodhur si reagim kundër Partisë Social-Demokratike të Austrisë e cila kishte dërguar rastin e saj në Gjykatën Kushtetuese<sup>18</sup>.

---

<sup>18</sup> Cf. më shumë për këtë në veprën monumentale të Charles A. Gulick, *Austria from Habsburg to Hitler. Vol. II. Fascism's Subversion of Democracy* (University of California Press, Berkeley and Los Angeles, 1948) 1410-1423 (ku autori diskuton ngjarjet para dhe pas mbyllje së Gjykatës si dhe diktaturën e regjimit Dollfuss që vepronte përmes dekreteve qeveritare që vlenin për gjendjen e jashtëzakonshme që nga 4 marsi i vitit 1933; ky autor poashtu i jep edhe pikëpamjet e Hans Kelzen , i cili kishte kritikuar ashpër veprimet jokushtetuese të regjimit në fjalë, në veçanti marrjen jokushtetuese të mandateve të social-demokratëve).

Dy vendet tjera, të cilat ishin nën ndikimin e demokracive kushtetuese perëndimore, **Republika e Qipros** dhe **Republika e Turqisë**, poashtu në fillim të viteve '60 të shekullit 20-të me kushtetutat e reja krijuan gjykatat e veçanta kushtetuese. Këto gjykata u mandatuan për të kryer kontrollin kushtetues të ligjeve dhe akteve tjera juridike me qëllim tëgarantimit të supremacisë (epërsisë) së kushtetutave nacionale. Të dala nga jostabiliteti i gjatë, në kontrollin kushtetues Qipro dhe Turqia gjetën njëinstrument të fuqishëm për sigurim të stabilitetit në vend dhe për zhvillimin paqësor të demokracive të reja kushtetuese.

Si zhvillim më i çuditshëm dhe i rëndësishëm i fazës të zhvillimit të gjyqësisëkushtetuese ka qenë ish **Jugosllavia**. Në këtë vend më 1963 u themelua gjykata federale kushtetuese, si dhe gjykatat kushtetuese të gjashtë ish republikave jugosllave. Kosova dhe Vojvodina themeluan gjykatat e tyre kushtetuese vetëm në fillim të viteve '70 të shekullit të kaluar, pas nxjerrjes sëamendamenteve kushtetuese të vitit 1971. Kontrolli i kushtetutshmërisë ishte kontroll i tipit të demokracive komuniste ku pushteti ishte një dhe i pandarë, ushtrohej përmes kuvendit si organi më i lartë i diktaturës së proletariatit në të cilën partia komuniste shërbente si avangardë. Kjo në vetvete përbën një paradoks nëse matet me kriteret e konstitucionalizmit modern perëndimor ku sigurimi i ndarjes së pushtetit, i sundimit të ligjit dhe respektit për të liritë dhe tëdrejtat themelore përbëjnë vlerat kyçe të cilat i siguron dhe mbron gjykata kushtetuese. Në rastin e ish Jugosllavisë , esenca e gjyqësisë kushtetuese qëndronte në atë se kontrolli kushtetues i ligjeve kishte për qëllim që të garantonte epërsinë e kushtetutës federale dhe republikane/krahinore, kushtetuta që garantonin epërsinë e kuvendit si organi më i lartë i pushtetit dhe sundimin e diktaturës sëproletariatit, jo të kushtetutës e ligjit dhe respektimin e të drejtave e lirive themelore të individit. Në këtë sistem , pushteti ishte një dhe i pandarë, me kuvendin (federal dhe republikan/krahinor) si organin më të lartë të pushtetit, i cili pushtet supozohej se ushtrohej, në emër të proletariatit, nga ana e partisë komuniste si avangardë e tij, jo në emër të kushtetutës (federale dhe republikane/krahinore) dhe ligjit.

Në vendet tjera ish komuniste, **Rumani**, **Poloni** dhe **Çekosllovakia**, ka pasur përpjekje, por pa sukses, për futjen e sistemit jugosllav të kontrollit kushtetues. Këto përpjekje , si dhe praktika në ish Jugosllavi, treguan se kontrolli kushtetues si instrument jo domosdo ka për synim promovimin dhe zhvillimin e demokracisë kushtetuese të tipit perëndimor. Më tepër mund të thuhet se kontrolli kushtetues i ligjeve dhe i akteve tjerajuridike paraqet një instrument të dobishëm për krijimin dhe promovimin e stabilitetit kushtetues

si dhe për vënien në jetë të kushtetutës si marrëveshje dhe vullnet sublim i një gjenerate, pa marrëparasysh përmbajtjen e vullnetit të kësaj marrëveshjeje. Në një moment, ky vullnet mund të ketë pasur si qëllim përligjësimin e sundimit monarkik kushtetues, herën tjetër përligjësimin e sundimit monarkik absolut, qeverisjen kushtetuese demokratike të proveniencës liberale apo, së fundi, sundimin jodemokratik të vetëm një personi apo kaste teokratike (vendet myslimane).

Deri në fillimin e fazës së dytë të zhvillimit të gjyqësisë kushtetuese, e cila nisë me themelimin e gjykatave kushtetuese në **Spanjë** (1979) dhe **Portugali** (1983) dhe me rikthimin e demokracisë në **Greqi**. Në këtë vend, Gjykata Supreme sipas modelit amerikan mori rolin e kontrolluesit të vullnetit të shumicës dhe sigurimin supremacisë (epërsisë) së kushtetutës së re greke të vitit 1975. Në Evropë dhe mëgjjerë, gjyqësia kushtetuese, e kuptuar si kontrolluesi i kushtetutshmërisë së ligjeve, morri hov të marrëgjithandej. Në këtë përhapje të shpejt të kontrollit kushtetues të ligjeve dhe akteve tjera juridike duhet të përmenden edhe ish kolonitë britanike, si Kanada e Australia, India dhe Pakistani. Në vendet e Amerikës Latine, si Uruguai, Brazili dhe Meksiko, poashtu kontrolli kushtetues i ligjeve nga ana e gjyqësorit të rregullt u bë pjesë e sistemit kushtetues tëkëtyre vendeve. Përveç gjyqësorit të rregullt, disa vende në Amerikën Latine në këtë kohë formuan gjykatat kushtetuese sipas modelit evropian, diçka që diskutohet gjerësisht në kapitullin në vijim.

Faza e fundit në zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese nis me rënien e komunizmit më 1989. Me mbarimin e **Luftës së Ftohët**, shumica e vendeve ish komuniste në Evropë dhe në Azinë Qendrore themelojnë gjykatat kushtetuese si institucione të ndara nga gjyqësori i rregullt dhe me një rol jashtëzakonisht të madh në kontrollin e pushteteve të reja nëmënyrë që të mos degjenerojnë në diktatura post-komuniste. Në shumicën e këtyre vendeve, gjykatat kushtetuese e kanë luajtur këtë rol më shumë sukses. Në disa prej tyre, gjykatat kushtetuese nuk kanë pasur aq shumë sukses, siç ka qenë rasti me **Bjellorusinë** dhe **Federatën Ruse**. Presidenti rus **Boris Jelcin** (*Boris Yeltsin :1931-2007*) e pat mbyllur Gjykatën Kushtetuese për një kohë (1993-1995) sepse nuk i pëlqenin vendimet e saj me të cilat bëhej kontrolli i pushtetit të tij absolut.

Në ato vende ku u fut ankesa kushtetuese si instrument për mbrojtjen dhe promovimin e lirive dhe të drejtave kushtetuese, gjykatat kushtetuese luajtën një rol mjaft të madh në kontrollin e pushtetit të gjykatave të rregullta, duke mos e lejuar arbitraritetin e këtij pushteti, siç kishte ndodhur në tëkaluarën

komuniste. Në disa vende, siç ishte rasti më Hungarinë, ishte futur **actio popularis**, përmes së cilës mundësohej ushtrimi i kontrollit të pushtetit legjislativ edhe nga ana e vet qytetarëve të zakonshëm<sup>19</sup>. Me këtë mjet, nëçdo kohë mund tëiniciohej kontrolli kushtetues i çdo ligji për të cilin vlerësohej se mund tëcenonte tëdrejtat dhe liritë kushtetuese. Në këtë fazë, të rralla kanë qenë vendet ish komuniste që nuk kanë themeluar gjykatë tëveçantë kushtetuese me juridiksion tëposaçëm, siçështë rasti me Estoninë, e cila rolin e kontrollit kushtetues të ligjeve dhe akteve tjera juridike ia besoj Gjykatës Supreme të këtij vendi<sup>20</sup>. Edhe për këtë do të flitet më shumë në kapitullinnë vijim.

## 5. PËRFUNDIM

Në Greqi, Romë dhe përgjatëMesjetës, siç u pa në këtë shkrim, kanë ekzistuar dy rende, një superior dhe tjetri inferior. Rendi juridik superior çdoherë ka gëzuar një mbrojtje më të mirë se ky i dyti. Mirëpo, deri nëMesjetë, me **Avogadori** të Venedikut, nuk ka pasur një mekanizëm qëngjason me këtë që sot cilësohet si gjyqësi kushtetuese.

Dijetarët si **Zhan ZhakRuso**, por edhe ata mesjetarë si **Toma Akiunas**, kanë folur gjerësisht për këtë rend superior dhe janë orvatur që të gjejnë arsyetime dhe mekanizma për sigurimin e supremacisë së këtij rendi juridik superior.

Në**Francë** janë krijuar pas Revolucionit të vitit 1789 dy organe kushtetuese me autorizime tëveçanta dhe të ndryshme: **Këshilli i Shtetit** (*Conseil de Etat*) dhe **KëshilliKushtetues** (*Conseil Constitutionel*). I pari dhe i dyti kishin funksione të ndara dhe të ndryshme. Në fillim, revolucionarët rezistuan idenë e kontrollit të legjitimitetit kushtetues të ligjeve, të cilat i konsideronin si shprehje sublime e vullnetit absolut të sovranit, të popullit francez. Formimi i këtyre dy organeve qe shenja e parë serioze e lëshimit gradual të kësaj logjike revolucionare, e cila ishte trasuar nga filozofë të drejtësisë si **Zhan Zhak Ruso** dhe tjerët. Sikundër u pa, krahas ndryshimit të

---

<sup>19</sup> Më shumë për rastin e **Hungarisë**, që nga themelimi i Gjykatës Kushtetuese, shih në Laszlo Solyom and Georg Brunner, *Constitutional Judiciary in a New Democracy*. *The Hungarian Constitutional Court* (The University of Michigan Press: Michigan, 200); Radoslav Prochazka, *Mission Accomplished*. On Founding Constitutional Adjudication in Central Europe (CEU Press: Budapest / New York, 2002) fq. 49-59; 113-139; 222-234.

<sup>20</sup> Vello Pettai, "Estonia's constitutional review mechanisms: a guarantor of democratic consolidation". Në Vello Pettai and Jan Zielonka (eds.) *The Road to the European Union*. Vol. 2 : *Estonia, Latvia and Lithuania* (Manchester University Press: Manchester/New York, 2003) fq. 75-103.

natyrës së pushtetit dhe origjinës së tij, ndryshoi edhe origjina e gjyqësisë kushtetuese: në ndërkohë që në antikë dhe përgjatë Mesjetës, pushteti shihej si hyjnor, edhembrojtja e supremacisë së rendit hyjnor sigurohej me metoda hyjnore dhe metoda tjera të natyrës metafizike.

Në Evropë, **Franca** ka qenë sistemi që ka rezistuar më së shumti, deri në vitet e fundit, kontrollin kushtetues të vullnetit të sovranit. Kjo ka ndryshuar vonë me krijimin e konceptit të a.q. **blloku i kushtetutshmërisë** (*bloc de constitutionalite*). Me këtë koncept iu është hapur dera mundësisë që **Këshilli Kushtetues** (*Conceil Constitutionel*) të ketë të drejtën e ushtrimit të kontrollit represiv të ligjeve dhe akteve tjera juridike më të ultë se ligji. Kjo përgjatë shekujve ka qenë e paimagjinueshme në sistemin francez.

Kontrolli kushtetues në SHBA ka një histori të çuditshme por që ka shpjegim: në kohët koloniale në kolonitë amerikane gjyqtarët kujdeseshin që të siguronin epërsinë e legjislacionit të kurorës kundrejt **çdokarte** (*Charter*) apo norme tjetër që zbatoheshin nëpër kolonitë britanike në Amerikë. Kjo nënkuptonte se aktet më të larta në secilën koloni, të njohura si **karta** (*charters*) duhej të ishin në pajtim me legjislacionin britanik, i cili miratohej nga parlamenti. Në këtë kontekst, kartat konsiderohej si kushtetuta të kolonive kurse parlamenti britanik konsiderohej si organ suprem dhe si goja e vetë sovranit (popullit). Kur u pavarësuan kolonitë amerikane më 4 korrik 1776 praktika e sigurimit të epërsisë së parlamentit britanik përmes interpretimit gjyqësor nëpër kolonitë amerikane prodhoi një rezultat krejtësisht tjetër: në ndërkohë që në Britani nuk lejohej sfidimi i supremacisë (epërsisë) së “common law” (“e drejta e përgjithshme”), në kolonitë amerikane **çdokartë** (*charter*) duhej të ishte në pajtim me legjislacionin britanik dhe këtë supremaci (epërsi) të legjislacionit e siguronin gjyqtarët kolonial. Ky rezultat u reflektua në Kushtetutën e SHBA-ve të vitit 1878 dhe në rastin e njohur si **Marbury vs Madison**, të cilin e trajtuam gjerësisht në këtë shkrim.

Megjithatë, pas lindjes së saj në SHBA, përhapja e gjyqësisë kushtetuese ka qenë e ngadaltë në kohën pas triumfit të praktikës amerikane të kontrollit kushtetues të ligjit me qëllim të sigurimit të supremacisë (epërsisë) së kushtetutës nacionale që nisi më 1803 më rastin **Marbury vs Madison**. **Meksika** qe vendi tjetër, i parë në fakt pas SHBA-ve, e cila instaloj institutin **amparo contra leyes**. Edhe në Meksikë, kjo nuk ndodhi pa një debat të thellë teorik e filozofik, i ndikuar kryesisht nga diskursi filozofik dhe teorik amerikan. Në fakt, para lindjes së çdo praktike që ka ngjasuar në gjyqësinë kushtetuese, si në **Greqi** e **Romë**, ashtu dhe në **Mesjetë** dhe më

pastaj para revolucioneve në Amerikë dhe Francë, kanë qenë filozofët dhe dijetarët e fushave të ndryshme që i kanë parapri shtjellimeve mbi arsyeshmërinë e sigurimit të superioritetit (epërsisë) së një rendi juridik krahasuar me rendet dhe praktikat tjera. Më vonë, në mes dy luftërave botërore, për këtë qëllim kanisur edhe themelimi i gjykatave të veçanta kushtetuese. Edhe këtë herë, ky themelim ka ndodhur në një klimë të një debati të gjallë teorik në mes të **Hans Kelsen** dhe **Karl Shmit** lidhur me arsyeshmërinë e pasjes së gjyqësisë kushtetuese të ndarë nga gjyqësori i rregullt. Ky debat ka nisur në mesin e viteve njëzet të shekullit të kaluar, në aspektin formal, por shtjellimet teorike të dy këtyre autorëve kanë ekzistuar shumë më herët, të ndara nga njëri tjetri, qysh nga fillimi i shekullit të 20-të.

Ka disa faza në zhvillimin e gjyqësisë kushtetuese, duke nënkuptuar me këtë zgjidhjet nacionale për themelim të gjykatave të reja kushtetuese me kompetenca të veçanta dhe të ndara nga gjykatat e rregullta me kompetencë të përgjithshme. Në fakt, vetëm pas lindjes së gjykatave të para kushtetuese në Evropë ndërmjet dy luftërave botërore, ka nisur periodizimi i zhvillimit të gjyqësisë kushtetuesesiç e njohim sot. Në këtë drejtim ekzistojnë tri faza të zhvillimit të kësaj gjyqësie.

Në fazën e parë , tri janë vendet të cilat i kanë dhënë vulën zhvillimit të gjykatës kushtetuese, duke pasur gjykata kushtetuese tëndara nga gjyqësori i rregullt. Ato vende janë: Italia, Gjermania dhe Austria. Kjo e fundit dallon nga këto dy të parat sepse pas vitit 1945 në këtë vend ka ardhur deri te restaurimi i Gjykatës Kushtetuese të Austrisë më 1946, e cila ishte mbyllur nga regjimi **Dollfuss** para Luftës së Dytë Botërore.

Nga ky shkrim u pa shkurt se gjyqësia kushtetuese nuk është monopol vetëm i vendeve demokratike perëndimore. ka shumë arsye që shpjegojnë lindjen e gjykatave kushtetuese dhe gjyqësisë kushtetuese si autoritet shtetëror i veçantë dhe i dallueshëm nga aktivitetet tjera shtetërore. Vendet, ta zëmë, si Jugosllavia dhe Polonia komuniste , kanë kultivuar gjyqësinë kushtetuese që nga viti 1963 edhe më pastaj. Vendet islamike, poashtu nuk bëjnë pjesë në vendet me traditë apo përvojë demokratike në kuptimin e demokracisë kushtetuese liberale të proveniencës perëndimore. Parametri i kontrollit kushtetues dhe objekti i kontrollit kushtetues në këto vende janë të ndryshme nga vendet tjera me demokraci kushtetuese: parametër nuk është norma kushtetuese por dispozitat e **Sheriatit**, kurse objektkontrolli nuk janë normat, parimet dhe vlerat kushtetuese, por normat, parimet dhe vlerat e Sheriatit. **Sheriati**, si një koncept dhe praktikë metafizike duhet të jetë sipëror (më i lartë), tekstit kushtetues kurse gjyqësia kushtetuese nuk ka pos detyrën e

---

sigurimit të kësaj epërsie të **Sheriatit** kundrejt normave, parimeve dhe vlerave kushtetuese.

**Prof. dr. Enver Hasani**

## **PHILOSOPHICAL AND THEORETICAL ASPECTS OF THE ORIGINS OF JUDICIAL REVIEW**

### **SUMMARY**

The paper discusses in a chronological order the birth of idea and practice of judicial review and constitutional justice in general. It starts with **Greece** and **Rome** through the **Medieval Ages** to **Modernity**. What is common in all situations and times is the fact that there has always existed two orders: one superior and one inferior. The later had to be subordinate to the former. It is in this battle between two orders that one can trace the origins of the idea and practice of judicial review and constitutional justice in general.

This battle between two orders, nevertheless, did not happen in an intellectual vacuum. Quite the opposite: always, without exception, since ancient times in Greece and Rome through Medieval Ages to Modernity it were philosophers who coined the terms of debate which later would be transformed into practice. **Plato** and **Aristotle**, **Thomas Aquinas** and **Jean Jack Rousseau**, to mention just few, belong to this stream of thought paving the way to the practice of judicial review and constitutional justice meant to secure through certain mechanisms superiority of an order compared to the other, less superior order.

Justice review and its offshoot constitutional justice as we know it today starts with modernity, like all other phenomena associated with power and the birth of modern state. The modern state, whose creation began with the **Peace of Westphalia** (1648), ended with the advent to power of **Napoleon** and its final downfall in 1815. With the advent of **French Revolution**, it seemed as if the case for judicial review was dead: French Revolutionaries denied any right to the judiciary to interpret the will of the sovereign people as expressed through laws. Judiciary was seen as a corrupt structure at the hands of the former **ancien regime** worth nothing but being suppressed. Laws had to be applied, not interpreted, by the judiciary. For this reason, Napoleon invented the institution of codification to limit to the utmost the creative role of judges while applying the laws. France changed, however, with the passing of time: **Conceil Constitutionel** and **Council d' Etat** took



over a new role of interpreting the sovereign will of the people acting through its administrative and executive organs infringing upon the original will and intent of the French people as sovereign expressing its will via legislative action of the French legislative body.

On the other side of the Atlantic, the battle against British supremacy gave birth to a new system of government with new institutions designed to balance each other in a very subtle manner. Among these new institutions was the US judiciary personified through its **Supreme Court**. It was this court that in 1803 decided the famous case, known as **Marbury vs Madison**, paving the way for the establishment of the modern institutions of judicial review and the birth of institutional mechanisms known as constitutional courts, a century and a half later in the old continent.

The intellectual discourse on the reasonableness and the *raison d'état* of the judicial review did not stop on both sides of Atlantic. In Europe, it is personified with two scholars: **Hans Kelsen** and **Carl Schmitt**. Constitutional justice, however, was not canonized until the end of the tragic war of 1939-1945. It was with the end of this war that the Western democracies did consider the institution of judicial review and the mechanism of constitutional justice as a sine qua non of its own development: new courts were formed in **Italy** and **Germany** while **Austria** established its own Constitutional Court that had been shut down by the Dollfuss regime in 1933.

Elsewhere, in Latin America first and foremost, judicial review started to get emulated right after it took hold in the USA. This was under the influence of theoretical framework developed by local authors reading the **Democracy in America** by **Alexis de Tocqueville**.

After the end of each dictatorship in Europe, new wave of constitutional justice developed: **Spain**, **Portugal** and **Greece** in the mid eighties of the last century developed their own systems of constitutional review which paved the way for their transition into constitutional democracies in a very eloquent manner. Last wave of such a development occurred with the collapse of Communism and the end of the Cold War: by this time, the existence of constitutional courts and a separate constitutional justice exercised by them, not by ordinary judiciary, became a coterminous with constitutional democracy of a Western provenience.

In the countries having an **Islamic** fabric as a layer of its own political development and culture, the issue of constitutionalism in its modern sense, or at least in terms of Western liberal constitutionalism, is a very problematic one. Why? This is so because the basic premise of Western constitutionalism is to guarantee of the supremacy of the constitution through certain institutional mechanisms and activities. In **Islamic** countries, in principle, the guarantee of the supremacy of the constitution does not exist: in these countries there exists the supremacy of **Sharia Law**, meaning that constitutional court or other equivalent institutions have a duty to secure the supremacy of **Sharia Law**, not the constitution. Under the framework of **Sharia Law** falls every constitution and has to conform to it. There are some hopes in recent time with the enactment of the new **Tunisian Constitution** in 2014. This matter, however, was not part of the discussion of this paper.

**Prof. Dr. Asllan Bilalli**

## **ZHVILLIMI HISTORIK I TË DREJTAVE PRIVATE (CIVILE) TË HUAJVE DHE KRITERET PËR KATEGORIZIM LIDHUR ME GËZIMIN NGA TË HUAJT**

### **HYRJE**

Si subjekt në qarkullimin ndërkombëtar të mallrave dhe të marrëdhënieve familjare dhe trashëgimore që krijohen nga ai qarkullim paraqiten dhe marrin pjesë si shtetasit e vendit ashtu edhe të huajt, po ashtu edhe personat juridik që kanë nacionalitet (përkatësi) të shtetit të vendit ose të huaj. Mundësinë që si subjekt i marrëdhënieve juridiko-private (civile) me element të huaj, përkatësisht bartës i të drejtave dhe detyrimeve të paraqitet i huaji (personi fizik ose juridik) çdo shtet e parasheh dhe e rregullon në bazë të parimeve dhe rregullave (normave) konkrete juridike të veta (nacionale). Shtetet këtë autorizim e ushtrojnë sipas të drejtës sovrane që e kanë mbi territorin konkret si ndaj personave, ashtu edhe ndaj sendeve që gjenden (ndodhen) në atë territor, përkatësisht sipas rregullave të parapara që nga koha e të Drejtës Romake në maksimat *Quid quid est in territorio, est etiam de territorio*, dhe *Qui in territorio meo est, etiam meus subditur est*. Për këtë arsye, për nxjerrjen dhe miratimin e normave që do t'a rregullonin këtë çështje si pikënisje (bazë) nuk shërben lidhja juridike e personit me shtetin e vendit por lidhja e tij fizike me territorin e shtetit konkret. Pasi kjo lidhje (lidhja faktike me territorin e shtetit konkret), kryesisht konsiderohet si lidhje më e dobët midis personit konkret dhe shtetit se sa shtetësia e cila është lidhje formale juridike, andaj ajo është edhe arsyeja që i huaji si bartës (titullar) eventual i të drejtave private (civile) nuk ka pozitë (status) të njëjtë që u garanton shtetasve të vendit<sup>1</sup>. Rregullimi i të drejtave private (civile) të huajve është çështje interne e çdo shteti, andaj shteti nuk mund të detyrohet që të drejta konkrete private t'ua mundësoj që ti ushtrojnë (gëzojnë) të huajt. Megjithatë, në kushtet bashkëkohore kurë janë miratuar një numër i konsiderueshëm i dokumenteve ndërkombëtare, nuk mund të mohohet ndikimi i tyre në rregullimin e të drejtave private (civile) të huajve në një numër të

---

<sup>1</sup>Mihajlo Jezdić, *Međunarodno privatno pravo II*, Beograd, 1985. f.16.

konsiderueshëm të shteteve. Me rëndësi të veçantë janë: Deklarata e përgjithshme për të drejtat e njeriut, e vitit 1948., Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike, i vitit 1996; Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut, e vitit 1950., etj.

Te të drejtat private (civile) të huajve që në territorin e shtetit të vendit të gëzojnë (ushtrojnë) të drejta konkrete elementi i huaj shfaqet në subjekt të marrëdhënies juridiko-private, ngase ushtrues i të drejtave private paraqitet personi fizik i cili e ka shtetësinë e huaj (ose është pa shtetësi, ose ka dy e më tepër shtetësi por nuk e ka shtetësinë e shtetit të vendit), ose personi juridik i cili nuk e ka përkatësinë (nacionalitetin) e shtetit të vendit.

Shikuar historikisht jemi të mendimit se kategorizimi i zhvillimit të drejtave civile të huajve më së miri është të bëhet nëpër formacionet ekonomiko – shoqërore, për arsye se në përgjithësi periodizimi dhe zhvillimi i shoqërisë (njerëzimit) shtrohet në këtë mënyrë.

Karakteristikë e përbashkët e të gjitha shteteve antike është se të gjitha ato kanë qenë shtete skllavopronare, që nga aspekti i të drejtës ndërkombëtare karakterizohen me izolim nacional dhe se mundësia e ushtrimit (gëzimit) e të drejtave civile nga të huajt respektivisht paraqitjes së elementit të huaj në subjekt ka qenë i pamundësuar.

Këtë periudhë e ka karakterizuar sundimi dhe ngadhënjimi i forcës. Shtetet ushtarakisht të forta me anë të luftës ngadhënjëjnë mbi shtetet dhe popujt tjerë, që konsiderohen armiq, dhe për këtë arsye duhet që ushtarakisht të mposhten dhe të robërohen. Botëkuptimet e këtilla kanë qenë të përfaqsuara si në shtetet antike të lindjes ashtu edhe në Romë dhe Greqinë skllavopronare. Karakteristikë e përbashkët e shteteve të asaj kohe ka qenë izolimi total ngase ajo shkallë e zhvillimit ekonomik ka mundësuar plotësimin e të gjitha nevojave kështu është konsideruar se s'ka pasur nevojë për bashkëpunim dhe zhvillim të marrëdhënieve ndërkombëtare me popujt e tjerë.

## **1. POZITA JURIDIKO – PRIVATE (CIVILE) E TË HUAJVE NË SHTETET ANTIKE TË LINDJES**

Të gjitha karakteristikat dhe veçoritë e organizimit shoqëroro – ekonomik të shteteve në lindjen antike më të përfaqësuara kanë qenë në Indi. Në të drejtën e lashtë hinduse sipas ligjit Manu në Indinë antike njerëzit ndaheshin në kasta. Kasta më e privilegjuar ka qenë ajo bramane. Bramanët kanë qenë

njerëz hyjnorë dhe luftëtarë, të paracaktuar nga zoti që të jenë pronar (titullar) i të gjithë të tjerëve. Që nga lindja janë të paracaktuar që të jenë pronar i çdo gjëje që ekziston. Kudra ishin skllavët, edhe pse kanë qenë qenie të gjalla (fizikisht kanë jetuar), sipas ligjit Manu ishin vetëm kufoma që nuk kanë pasur asnjë të drejtë. Nuk kanë pasur të drejtë ti mbledhin as troshat nga ushqimi i bramanëve, e as t'a bartin bramanin e vdekur për te varrezat, ngase në atë mënyrë do të fyheshin zotërat. Pas kudro është radhitur paria. Kanë qenë fiset e mundura dhe të nënshtruara në luftë, të cilët nuk kanë mund edhe si skllav të përfshihen në kastat hinduse. Kanë qenë të detyruar të jetojnë jashtë shoqërisë qytetare të pa mbrojtur fare dhe për vrasje të tyre nuk është paraparë kurrfarë sanksioni penal. I huaji jo që është radhitur pas parisë, por është radhitur edhe pas shtazëve si për shembull: elefantit, kalit, etj.<sup>2</sup>

Sipas të drejtës hebreje, hebrenjtë janë konsideruar si popull i zgjedhur dhe sipas Ligjit të Moisiut duhen patjetër të jenë të izoluar nga të gjithë të huajt. Pas vendosjes së tyre në Palestinë, hebrenjtë që ti ruajnë pastërtinë e tyre, të gjithë popujt tjerë i kanë vrarë dhe i kanë djegur. Nga frika që fëmijët mos ta braktisin besimin fetar të Jahovës, ndalohej martesat me të huaj. Megjithatë, kontaktet me të huajt janë zhvilluar nëpërmes marrëdhënieve tregtare. Sipas të drejtës të asaj kohe, vetëm i huaji ka mund të shndërrohet në skllav, dhe s'ka pasur aftësi për të dëshmuar, etj. Gjithashtu i huaji nuk ka mund ta trashëgojë të huajin. Megjithatë, i huaji ka pasur disa të drejta, ka gëzuar të drejtën në mbrojtje nga mundimi fizik (ndërlidhet me robërinë e hebrenjve në Misirë). Mirëpo barriera midis të huajve dhe hebrenjve ekzistonte për shkak të dallimeve në besimet fetare. Me pranimin e konfesionit hebre nga i huaji dallimet janë eliminuar dhe në atë mënyrë është fituar edhe shtetësia hebreje.

Në këtë mënyrë janë fituar të drejtat civile, me kufizime që i huaji dhe pasardhësit e tij nuk kanë mund të ushtrojnë funksione ushtarake, e as të bëhen gjyqtarë. Gjithashtu edhe në të drejtën trashëgimore ka pasur dallime. Të huajt që e kanë fituar shtetësinë hebreje me natyralizim, nuk kanë mund ta trashëgojnë fëmijët e tij të lindur para natyralizimit. I huaji i cili e ka fituar shtetësinë me natyralizim nuk ka pasur të drejtë të hartojë testament, etj.<sup>3</sup>

Sipas të drejtës së vjetër sakrale të Egjiptit mbisundonte idea se Egjipti duhet të sundoj me botën, dhe ndaj gjithë të huajve duhet të zbatohen urdhëratë e rrepta të gjyqësisë hyjnore, kështu që edhe në piramidat gjigante të Egjiptit shkruan se :”Asnjë i huaj këtu nuk ka punuar”. Aniëve të huaja rreptësishtë

---

<sup>2</sup>M.Bartoš, B. Nikolajevič, Pravni položaj stranica, 1951, fq. 19.

<sup>3</sup>M.Bartoš, B. Nikolajevič, po aty, fq. 21.

u ndalohej të hynin në limanet e Egjiptit. Çdo i huaj që hynte në Egjipt dënohej me vdekje (koha e mbretit Buzirle). Mirëpo, me zhvillimin ekonomik të Egjiptit, u zhvilluan edhe marrëdhëniet tregtare me shtetet tjera, kështu që të huajve u lejohet të spirancohen në limanin Naurkatis. Me kalimin e kohës u lejohej të huajve të qarkullonin edhe në qytetet tjera. Mbreti Psametihus e ka favorizuar hyrjen dhe vendosjen e të huajve në Egjipt. Kështu për shembull grekëve u ka mundësuar që të fitojnë paluajtshmëri. Mbreti Amazis, edhe vetë ka qenë i martuar me shtetasë të huaj. Ka themeluar edhe gjykata për të huajt. Grekëve u ka mundësuar që të bëjnë tregti në Egjipt, gjithashtu u ka lejuar që të hapin dyqane tregtare. Me kalimin e kohës të huajve u lejohej që të ushtrojnë edhe funksione publike.<sup>4</sup>

### 1.1 Pozita juridiko – private (civile) e të huajve në Romën skllavopronare

Në shtetin skllavopronar Romak të huajve parimisht nuk u njiheshin kurrfarë të drejtash. Fillimisht e Drejta romake ka qenë ngushtë e lidhur me fenë, dhe ndaj të huajve është shikuar si ndaj armiqve. Pasurinë e tij në çdo kohë ka mund ta përvetësoj çdo qytetar romak, kurse të huajin ta shndërroj në skllav. Zotësi të plotë juridike dhe zotësi veprimi tek të gjitha llojet e marrëdhënieve (politike, familjare, dhe pasurore) kanë pasur vetëm qytetarët romak – *cives romani quirities*. Të huajt janë quajtur *hostis*, që njëkohësisht ky term do të thotë edhe armik, dhe në ligjin e dymbëdhjetë tabelave (tabela 3) është paraparë se pushteti mbi të huajt le të jetë i përhershëm (*adversus hostem aeterna auctoritas*). Të huajve në Romë nuk u lejohej krijimi i marrëdhënieve familjare (*ius connubii*) dhe martesë e të huajt në Romë kanosej me dënim me vdekje. Gjithashtu të huajve (*hostis*) në Romë nuk u lejohej krijimi i marrëdhënieve pronësore (*ius commercii*). Më vonë kur e drejta romake e humbi karakterin sakral, ndryshohen edhe rregullat zakonore për të huajt. Kjo ndodhi për shkak të zhvillimit të tregtisë me shtetet fqinje dhe të paraparit të institutit *hospitium privatum* dhe të patronatit, si dhe për shkak të lidhjes të traktateve të shumta ndërkombëtare me të huajt.

Për shkak të mbrojtjes së interesit dhe të drejtave pronësore të huajve janë lidhur marrëveshje të veçanta (kontrata tipe) *hospitium privatum*. I huaji i cili ndodhej në territorin romak, përkohësisht vihej nën mbrojtje të qytetarit romak i cili detyrohej të kujdeset dhe ta mjekoj në rast të sëmundjes, sidomos t'ia mbroj interesat pranë gjykatës romake. Kjo marrëveshje ishte kontratë konsensuale e cila përpilohej me shkrim *tessera*. Mirëpo,

<sup>4</sup>M.Bartoš, B. Nikolajević, po aty, fq. 20.

marrëveshja kishte karakter religjioz dhe nuk ishte e mbrojtur nga e drejta, por mosrespektimi i marrëveshjes shkaktonte *infami*. Marrëdhëniet reciproke midis të huajit dhe shtetasit të vendit trajtoheshin të shenjta, dhe vrasja e tyre barazohej me vrasjen e *pater familias*. Kontrata për *hospicium* me automatizëm ka kaluar edhe në trashëgimtarët nëse ata nuk e shkëputnin me marrëveshje. Mbetej në fuqi edhe nëse Roma i shpallte luftë shtetit nga i cili ishte i huaji. Së shpejti *hospicium* si institucion u përfshi edhe në të drejtën shtetërore. Shteti romak edhe vetë i pranoi nën mbrojtje (*hospicium*) të huajt që kishin merita për Romën, ose me anë të traktateve ndërkombëtare u garantonte *hospicium publicum* qytetarëve të shtetit konkret. I huaji i vënë nën *hospicium (hospes)* ka pasur pozitë juridike të kufizuar tek marrëdhëniet *ius commercii*, që do të thotë se ka pasur mundësi të krijojë disa marrëdhënie pronësore vetë, pa pjesëmarrjen e mbrojtësit, kurse për mbrojtje juridike mund t'u drejtohej gjykatave romake vetëm nëpërmjet të mbrojtësit (përkujdesësit) të vet.

Gjithashtu në Romë u krijua një kategori e posaçme e të huajve – *foedus*. Roma lidhte një numër të konsiderueshëm të traktateve tregtare, traktateve për aleancë ose bashkëpunim tregtar me popujt fqinjë ose popujt më të largët. Gati të gjitha marrëveshjet e përmendura të nënshkruara nga Roma u garantonin banorëve të shteteve nënshkruese respektimin e personalitetit, pronësisë dhe zhvillimin e tregtisë së lirë gjatë kohës së qëndrimit të tyre në territorin romak. Kjo kategori e të huajit në Romë emërohej si *foedus*, dhe kishte të drejtë të lidh martesë në territorin romak, të jetë subjekt i marrëdhënieve pronësore, si dhe në mënyrë të pavarur të ushtrij procedurë para gjykatave romake. Mirëpo, kontestet ndërmjet të huajve, si dhe kontestet midis të huajve dhe romakëve zgjidheshin pranë gjykatave për të huajt – *iudicium recuperatorium*.<sup>5</sup>

Me kalimin e kohës të gjitha institucionet e theksuara më lartë nuk mjaftonin për rregullimin e pozitës juridike të huajve në Romë. Zgjerimi i perandorisë romake dhe hyrja në raporte me një numër të konsiderueshëm të shteteve gati të pavarura kanë ndikuar dhe kanë qenë arsye për rregullimin e serishëm të pozitës juridike të huajve në Romë. Pretori i peregrinëve për të huajt krijoi rregulla të veçanta (posaçme) juridike – *ius gentium (ius quod apud omnes gentes paraque custoditur)*. Kjo tërësi e rregullave juridike e krijuar nga pretori i peregrinëve e sajonte të drejtën private që aplikoheshin nga të gjithë njerëzit e lirë, dhe ishte e çliruar nga çdo ndikim sakral. Romakët shumë herët e kishin të qartë se për zhvillimin e drejtë të perandorisë së madhe të tyre, duhet për interesat e veta (fatin e vetë) t'i ndërlydhin interesat e të gjithë

---

<sup>5</sup>M.Bartoš, B. Nikolajević, po aty, fq. 25.

popujve të nënshtruar duke u siguruar “të drejta të mëdha” si kompensim për lirinë e humbur. Popujt më të afërt me romakët së shpejti u bënë edhe qytetar romak, dhe quheshin *ex iure latini*, mund të ushtronin (gëzonin) vetëm disa të drejta civile (private). Popujt në provinca (larg Romës), që nuk ishin në Itali kishin pozitë shumë më të keqe juridike se sa banorët e favorizuar të Italisë. Mirëpo, ligji të gjithë ata të huaj që nuk mund të gëzonin (ushtronin) *status civitatis* të plotë i emëronte me termin e përbashkët për të gjithë të huajt, *peregrin*, pa marrë parasysh se a kanë qenë ata Latinët ( të huajt që kanë mund të ushtrojnë të drejta konkrete civile) ose peregrinët e rëndomtë (banor të provincave, armiqtë e dikurshëm të mundur në luftë) dhe qytetarët e dikurshëm romak të privuar nga të drejtat civile, pra personat të cilët pak a shumë kanë qenë të lidhur me shtetin romak, ose kanë qenë të huaj në plotë kuptimin e fjalës – barbar, pozita juridike e të cilëve praktikisht dukshëm dallohej.<sup>6</sup>

Sipas *ius civile* të huajt – peregrinët (banorët e territoreve të pushtuara dhe nënshtruara nga romakët të cilët asnjëherë nuk e kanë pasur qytetarinë romake) nuk kanë gëzuar (ushtruar) kurrfarë të drejtash civile, e as nuk kanë pasur mbrojtje juridike. Kurse sipas të drejtës së pretorit – *ius gentium*, peregrinët në Romë kanë gëzuar mbrojtje juridike. Mirëpo, *ius gentium* nuk ka qenë e drejtë ndërkombëtare, pra nuk ka qenë tërësi e normave juridike të sistemeve të pavarura juridike të shteteve të ndryshme. Përkundrazi, kjo e drejtë ka qenë pjesë e të drejtës private romake, e cila aplikohet edhe ndaj atyre personave të cilët nuk kanë qenë qytetar romak. Konsiderohej se *ius gentium* është bazament i përbashkët për të gjitha sistemet juridike, i rregullon të drejtat e njeriut të lirë, dhe qëndron kundruall të drejtës *ius civile*, e cila i rregullonte marrëdhëniet vetëm ndërmjet qytetarëve romak. Për dallim nga *ius civile*, *ius gentium* nuk mundësonte ushtrimin e të drejtave politike (p.sh. nuk mundësonte ushtrimin e *ius honorum*, e as të *ius suffragii*), e as mundësinë e lidhjes së martesës së plotfuqishme romake (me ligj) – *ius connubii*.<sup>7</sup>

Për sa i përket pozitës juridike të peregrinëve – Latin, edhe pse në aspektin juridik trajtoheshin si të huaj, kanë pasur mundësi që pjesërisht të ushtrojnë (gëzojnë) të drejta civile konkrete në Romë, varësisht se për cilin lloj të peregrinëve – Latin bëhet fjalë, ngase ndaheshin në *Latini veteres*, *Latini coloniarii* dhe *Latini iuniani*.

---

<sup>6</sup>M.Bartoš, po aty, f. 26.

<sup>7</sup>B. Eisner, Međunarodno privatno pravo I, Zagreb, 1950, f. 113



*Latini veteres*, ose Latinët e vjetër, ishin banor të *Latiumit*, me të cilët Roma kishte nënshkruar marrëveshje për aleancë e cila ishte në fuqi deri në vitin e 80 para epokës së re (pushoj të zbatohet pas luftës me Romën dhe nënshtrimin e tyre). Lidhur me ushtrimin e të drejtave civile nga *Latini veteres* dallohen dy periudha. Në periodën e parë, nga koha e aleancës deri tek lufta latine, këto Latini kanë mund të shfrytëzojnë të drejta politike konkrete, kanë pasur *ius connubii* (të drejtat familjare sipas të drejtës romake), *ius commercii*, kanë mundur të fitojnë pronësi sipas *ius civile*, pastaj kanë mundur të hartojnë (përpilojnë) testament, por për dallim nga qytetarët romak kontestet nuk mund ti zgjidhnin para gjykatave të rregullta romake, por para gjykatave speciale, *recuperatores*. Në periodën e dytë (pas luftës), ata nuk kanë qenë më aleat me romakët por të huaj të nënshtruar. Nga ai moment u mohoheshin të gjitha të drejtat politike dhe të drejtat tjera sipas të drejtës familjare romake. Gjithashtu menjëherë pas lufte u mohoj edhe *ius commercii*, mirëpo kjo e drejtë së shpejti u kthye prapë. Konsiderohej se cilësia (vetia) e të huajit me komercium sipas *ius civile* ishte karakteristikë e rëndësishme e Latinëve, që i dallonte nga peregrinët e rëndomtë (zakonshëm) që nuk e kishin këtë të drejtë (*ius commercii*).

*Latini coloniarii* krijoheshin nga tre kategori të ndryshme të banorëve të Romës. Kategorinë e parë e sajonin emigrantët të cilët vullnetarisht hiqnin dorë qytetaria romake dhe e kolonizonin Laciumin. Kategorinë e dytë e sajonin banorët e shpërngulur nga Roma vullnetarisht, dhe në atë mënyrë i shmangeshin pagesës së dënimit në Romë, kështu që u pushonte qytetaria romake. Kategoria e tretë krijohej nga qytetarët romak *filii familias*, të cilëve atë pozitë ua caktonte *pater familias*.

Të gjitha këto tre kategori sipas fuqisë ligjore, *ex lege* e humbnin qytetarinë romake, dhe në aspektin juridik trajtoheshin si të huaj. Pozita juridike e këtyre kategorive të qytetarëve romak ishte e ngjashme me pozitën juridike të *Latini veteres*, megjithatë prapë se prapë dalloheshin nga peregrinët tjerë të zakonshëm (rëndomtë), ngase kishin *ius commercii* sipas *ius civile*, e jo sipas *ius gentium*.

*Latini iuniani* ishin skllavët e lëshuar në liri. Konsideroheshin si të huaj edhe pse jetonin nën pushtetin romak. *Latini iuniani* sipas *ius civile* mund të shfrytëzonin vetëm *ius commercii*, por atyre asnjëherë nuk iu njoh e drejta ta shfrytëzojnë testamentin romak, pra nuk u njihej zotësia testamentare. Andaj, *Latini iuniani* as nuk janë lindur (skllav) e as nuk kanë vdekur si qytetar Romak (nuk kanë mund të hartojnë testament), edhe pse kishin status të ngjashëm me Romakët ngase mund ta shfrytëzonin (të shërbeheshin) *ius commercium* të *ius civile*. Nga ajo që u tha më lartë, mund të konstatohet se

pozita e Latinëve ndaj peregrinëve tjerë të rëndomtë (zakonshëm) padyshim se ka qenë më e avancuar, andaj lirisht mund të thuhet se për shkak të pozitës së atillë ato kanë qenë të privilegjuar.

Në kuptimin e plotë të fjalës si të huaj konsideroheshin barbarët (pjesëtarët e popujve german dhe fiseve aziatike). Ishin ata të huaj të cilët jetonin, ishin të domiciluar jashtë shtetit Romak, dhe nuk u nënshtroheshin ligjeve romake, kështu që nuk kishin kurrfarë të drejtash, e as nuk kishin të drejtë ti shfrytëzojnë rregullat e *ius gentium*. Prona e tyre në Romë konsiderohej si *res nullius*, dhe me anë të okupimit çdokush mund ta fitonte. Ata çdo kush mund ti vriste ose ti skllavëronte. Për dallim nga varri i skllavit i cili ishte *res religiosa*, varri i barbarit nuk trajtohej si i tillë. Martesa midis barbarit dhe qytetares romake sipas ligjit dënohej me vdekje. Mirëpo, me kalimin e kohës, në praktikë u bënë lëshime edhe për të huajt në këtë lëmi.

Nga ajo që u tha më lartë për pozitën juridike të huajve në Romë mund të konstatohet se sistemi juridik romak i ka përfshirë të huajt në dy grupe themelore, edhe atë grupin e parë e sajonin banorët e vendit, ku përfshiheshin peregrinët dhe Latinët, dhe grupin e dytë e sajonin barbarët. Sipas të drejtës romake, të huajt shtetas të vendit, kanë gëzuar (ushtruar) disa të drejta, kurse barbarët nuk gëzonin asnjë të drejtë, plotësisht ishin të pabarabartë.

Për rregullimin e marrëdhënieve juridike në Romë ekzistonte paralelizmi i sistemeve të brendshme juridike, njëri sistem – *ius civile*, i cili vlente (zbatohet) vetëm për qytetarët romak, dhe i dyti – *ius gentium*, aplikohet për të gjithë banorët tjerë të shtetit romak, me të cilin mund të shërbeheshin (mund ta zbatonin) edhe vetë qytetarët romak. Ky paralelizëm (dualizëm) i aplikimit të dy sistemeve juridike u konvenonte një rrethi të konsiderueshëm të personave, edhe përkundrejt kërkesës së masave të gjera për abrogim. Mirëpo, qarkullimi juridik ndikoj që si e drejtë e përgjithshme e cila mund të aplikohet në ato rrethana ishte vetëm *ius gentium*, e cila ishte e çliruar nga formalizmi rigoroz, karakteri sokral dhe vrazhdësia e *ius civile* të vjetër. Masat e gjera popullore kërkonin që të ndërpritet kjo gjendje dhe të gjithë banorët e perandorisë romake në aspektin e trajtimit juridik të barazohen, e sidomos në aspektin e ushtrimit (gëzimit) e të drejtave politike dhe funksioneve publike. Për shkak të numrit të madh të banorëve të cilët nuk ishin qytetar romak, e sidomos për shkak të rrethanave konkrete *ius gentium* pothuajse në tërësi e përjashtoi nga aplikimi *ius civile*. Gjendja e atillë faktike, ndikoi që në aspektin formal juridik të barazohen të gjithë banorët e perandorisë romake lidhur me trajtimin juridiko – privat. Me ediktin e perandorit *Caracalle* të vitit 212 të epokës sonë, të gjithë banorëve të perandorisë romake u njihej qytetaria romake, dhe në atë mënyrë u shpall

barazia formale juridike e të gjithë banorëve të perandorisë, që praktikisht e nënkuptonte që *ius gentium* u shndërrua edhe formalisht në të drejtë të përgjithshme e të gjithë banorëve të perandorisë romake.

## 1.2 Pozita juridiko – private (civile) e të huajve në poliset antike greke (qytetet – shtete)

Në poliset antike greke pozita juridike e të huajve dukshëm dallohej nga pozita juridike e shtetasve të vendit. Në shtetet antike greke dalloheshin katër kategori të huajsh: *izotelët*, *metekët*, të huajt pa vendbanim të përhershëm në Athinë dhe barbarët.

Izotelët ishin të huajt të cilët sipas marrëveshjes ndërkombëtare, ose sipas ndonjë ligji special (privilegje personale) kishin të drejtë të gëzojnë (ushtrojnë) të drejta konkrete pronësore. Për shembull kishin të drejtë të paraqiten në gjykatë, edhe pse nuk kishin të drejtë të posedojnë paluajtshmëri, sipas privilegjeve për të huaj mund të liroheshin nga pagimi i tatimit për të huaj, etj. Me marrëveshje ndërkombëtare u garantohej të huajve ushtrimi (gëzimi) i të drejtave pronësore njëlloj sikurse shtetasve të vendit, ngase Athina zhvillonte tregti detare me shtetet tjera greke. Për tu mundësuar zhvillimi i tregtisë duhej të ngritët në nivel më të lartë pozita juridike e të huajve dhe kushtëzohej me reciprocitet.

Metekët ishin të huajt nga qytetet greke, por ka të dhëna se në mesin e tyre kishte edhe mjaft ilir.<sup>8</sup> Këta të huaj kishin autorizime të vendosen në Athinë sipas lejes të lëshuar nga areopagu. Metekët nuk kishin të drejtë të posedojnë paluajtshmëri, nuk kishin të drejtë të trashëgojnë e as të përpilojnë testament, gjithashtu nuk kishin të drejtë të lidhin martesë me athinase. Për ta ekzistonin gjykata speciale (*poemark*), para të cilave mund të paraqiteshin nën asistencën e qytetarit të Athinës (*prostat*), i cili ndaj tyre kishte përkujdesje të përhershme me autorizim nga shteti. Pozita juridike e metekëve ka qenë më e keqe se e qytetarëve tjerë. Kështu p.sh. dënimi me përjashtim nga polisi për qytetarët tek metekët është zëvendësuar me dënim me vdekje. Metekët kanë qenë shtetas të rendit të dytë, të mbrojtur me ligje antike, kanë pasur mundësi të bëjnë tregti dhe të ushtrojnë gati të gjitha profesionet sipas dëshirës përveç profesionit famullitar (prift). Por çdo herë gjatë realizimit të drejtave të veta meteku patjetër duhej të dëshmonte se i ka plotësuar të gjitha detyrimet se e ka paguajtur tatimin dhe se është i mbrojtur nga prostati, se

---

<sup>8</sup>H. Ismajli; F. Sejdiu, Historia e institucioneve juridike dhe shtetërore, Prishtinë, 2009, f. 82.

përndryshe do të përgjigjej për uzurpimin e të drejtave qytetare, që konsiderohej si krim i cili dënohej me shitje në robëri.

Të huajt pa vendbanim të përhershëm në Athinë, ishin të huajt nga shtetet me të cilat Athina kishte marrëdhënie të rregullta, por që nuk ishin vendosur përgjithmonë në Athinë, e as nuk mundej të marrin leje për një gjë të tillë. Këta të huaj nuk ishin banor të Athinës në plotë kuptimin e fjalës, andaj edhe nuk mund t'i ushtronin të gjithë ato të drejta që i gëzonin metekët. Ata nuk kishin të drejtë të marrin pjesë në njësitet ushtarake. Ata vazhdimisht ishin nën mbikëqyrje dhe i mbronin qytetarët e Athinës – proksenët. Këta të huaj pa lejen e proksenit nuk mund të shkonin në gjykatë.

Barbarët, ishin të huajt e lindur jashtë kufirit të civilizimit grek. Ata parimisht nuk ushtronin shumë të drejta dhe nuk kishin mbrojtje. Gjuha i dallonte nga grekët, gjithashtu edhe dallimet tjera me grekët ndikuan që barbarët të konsideroheshin si të krijuar për tu shërbyer të tjerëve. Me kalimin e kohës, kur filluan të zhvillohen marrëdhëniet tregtare ndërmjet Athinës dhe barbarëve, filloj të ndryshoj edhe sjellja ndaj barbarëve në favor të tyre.

### 1.3 Pozita juridike e të huajve në shekullin e mesëm – feudalizëm

Pozita juridike e të huajve në shekullin e mesëm më së miri mund të vërehen te Germanët dhe Frankët.

Te germanët njerëzit e lirë organizoheshin (grupoheshin) sipas bashkësive ushtarake, e jo sipas shteteve. Anëtarët e çdo bashkësie të veçantë ushtarake midis veti konsideroheshin si detyrues solidar ndaj elementit të huaj, p.sh. ishte detyrim i të gjithë anëtarëve të fisit të përgjigjen në mënyrë solidarë për veprimet e palejuara që do ti bënte një anëtar i fisit, dhe e kundërta i tërë fisi kishte të drejtë në hakmarrje nëse ndonjë anëtarë i fisit ishte viktimë. Si i huaj konsiderohej çdo mashkull i cili pas moshës madhore nuk përfshihej në organizatën ushtarake ku jetonte, dhe nuk kishte (gëzonte) as të drejta politike, e as të drejta private. Megjithatë, ai person mund të gëzonte mbrojtje ligjore nëse ishte nën përkujdesje (mbrojtje) të qytetarit (shtetasit) të vendit, i cili e përfaqësonte në gjyq dhe përgjigjej për veprimet e t'ia kundërligjore. Konsiderohej se kjo mënyrë e mbrojtjes krijohet *ipso facto* nëse ai person tre net i kalonte (si mysafirë) nën kulmin e ndonjë Germani.<sup>9</sup>

---

<sup>9</sup>M.Bartoš, B. Nikolajević, Pravni položaj stranca, Beograd, 1951, f. 29-30.

Frankët, pas pushtimit të Galisë u transferuan nga nomadët në popull të përhershëm (u ndryshua kualifikimi german për të huajt). Tash më nuk konsiderohej si i huaj personi që nuk i takonte fisit udhëheqës, por konsiderohej çdo person i cili linte jashtë territorit që e sundonte fisi i vendit. Megjithatë, ende mbetën në fuqi rregullat se i huaji është person pa të drejta, person i cili është jashtë ligjit. I huaji nuk kishte të drejtë të mbajë armë, nuk mundej të jetë dëshmitarë, nuk mundej të jetë pronar i paluajtshmërive, e as të drejtë të martohet dhe të krijoj familje, nuk kishte të drejtë të trashëgoj, e as të trashëgohet. Nga kjo që u tha mund të vërehet se pozita juridike e të huajve, nuk ishte e rregulluar me ligj dhe varej nga mëshira e më të fortit se ai. Nëse i huaji dëshironte të siguroj mbrojtje duhej të vihet nën mbrojtje të ndonjë Franku. Në shumicën e rasteve të huajt gëzonin mbrojtje (viheshin nën mbrojtjen) nga mbreti, për çka edhe paguanin tatim të veçantë, edhe fitonin disa të drejta, si p.sh. të kenë skllav, të bëjnë tregti.<sup>10</sup>

Në Gali kishte edhe banor që nuk ishin të huaj, ishin autokton, kryesisht ishin shtetas romak. Frankët në njëfarë mënyre edhe ata i konsideronin si të huaj, por pozita e tyre juridike nuk rregullohej sipas ligjeve franke, por ata jetonin sipas të drejtës së tyre, e ashtuquajtur e drejta personale (personaliteti i së drejtës), e drejta romake. Gjithashtu kur Frangët ngadhënjyen në lufta me disa popuj gjerman, pozitën juridike të atyre popujve nuk e rregullonin sipas ligjeve të veta (frange), por edhe ato i konsideronin si të huaj, dhe ua njihnin dhe lejonin atë pozitë juridike që e kishin sipas ligjeve gjermane. Nga kjo që u tha mund të vërehet se në të drejtën frange ekzistonin dallime midis të huajve. Kishte edhe të huaj të privilegjuar, të cilët sipas të drejtës *frange ex lege*, nuk ishin pa kurrfarë mbrojtje juridike, por pozita (statusi) i tyre përcaktohej sipas gjendjes faktike të hasur, sipas të drejtës së tyre të personalitetit. Ky dallim ndërmjet Frankëve, si shtetas të vetëm të vendit nga njëra anë, dhe banorëve autokton, përkatësisht të mundur në luftë nga Frangët, nga ana tjetër filloj gradualisht të humbet (zbehet). Ky dallim u zhduk me miratimin e ligjeve të përgjithshme të cilët i detyronin të gjithë banorët e mbretërisë Frange pa marrë parasysh prejardhjen e tyre.

Përkundrajt zbatimit një kohë të gjatë të personalitetit të drejtës te Frankët, duke filluar nga fundi i shekullit të X u bë ndryshim i dukshëm në atë drejtim që pozita juridike (statusi juridik) nuk caktohej më sipas parimit të personalitetit por sipas parimit të territorialitetit, i cili zbatohet në mënyrë të përgjithshme për të gjithë banorët e një territori. Në atë kohë në drejtësi erdhi deri te një ndryshim i qartë, aplikimi definitiv i sistemit feudal, ideja e

---

<sup>10</sup>Po aty. f. 30.

territorialitetit absolut të rregullave juridike, atëherë zakonet. Ky ndryshim shkaktoi një kthim në relacion me sistemin që u instalua me invazionin e barbarëve, dhe që e sajonte idenë themelore të feudalizmit. Feudalizmi bazohej në konceptimin se toka është mjete themelor i prodhimtarisë më të rëndësishme se çdo gjë, dhe se njeriu për atë lidhet. Nga ajo kohë kur toka u ndahej në shfrytëzim të përjetshëm, fisnikëve, ata pretendonin që mbi atë tokë të kenë pushtet ekskluziv sovran, dhe nuk pajtoheshin që të jenë vetëm pronar të tokës, por pretendonin që të sundojnë mbi popullatën që ndodhej aty dhe të jenë ligjvënës në atë territor. Çdo fisnik i aplikonte ligjet e veta për tërë banorët që ndodheshin në atë territor. Për këto arsye u shfaqën ide të reja për të huajin. Nëse individ i lëshonte territorin e feudit për të cilin ishte i lidhur për atë më nuk do të vlenin ato ligje, por ai duhej t'u nënshtrohet ligjeve të reja të atij bujkrobi në territorin e të cilit do të gjendej. A konsiderohej i huaj sipas ligjit të bujkrobërit të ri, ngase si i huaj konsiderohej çdo individ i cili do të gjendej jashtë territorit ku ishte lindur. I huaji i cili dëshironte të vendosej në territorin e feudit konkret në afat prej një viti e një dite, duhej të betohej para personit që e zotëronte tokën. Nëse nuk e bënte atë feudal pas skadimit të ati afati, kishte të drejtë t'ia konfiskoj pasurinë.

Nga kjo që u tha më lartë vërehet se çdo feudal në mënyrë individuale e rregullonte pozitën juridike të huajve në territorin e vetë, por mund të nxirret si konstatim i përgjithshëm se pozita juridike e të huajve në atë periudë sadopak u përmirësua. Nga ana tjetër legjislacionet feudale parapanë taksa të posaçme dhe tatime për të huajt. Ato të dhëna shpeshherë ishin shumë të larta, por konsideroheshin si dhurata personale për garantimin dhe sigurimin e pozitës juridike (statusit) të huajve (paguheshin në formë të tatimeve të rregullta dhe si shtesa speciale).<sup>11</sup>

Pra, në periudën e feudalizmit, që është karakteristike për shekullin e mesëm (mesjetën), mundësia që i huaji të paraqitet si subjekt i marrëdhënieve juridiko – private (civile) kishte karakter të jashtëzakonshëm, por shprehej në mënyrë specifike që u përgjigjej konditave të përgjithshme të asaj periode. Që të mundej i huaji të jetë subjekt i të drejtave private (civile) në territorin e huaj nevojitej: a) t'i takoj shtresës së privilegjuar të huajve, dhe b) të drejta konkrete private t'i njihen me gramatë mbretërore, ose me traktate ndërkombëtare. Njohja e të drejtave konkrete private (disa të drejtave) të huajve në mënyrë të jashtëzakonshme, kryesisht bëhej për tregtarët, të cilët me krijimin e qyteteve dhe zhvillimin e zejtarisë ishin bartësit e qarkullimit ekonomik interlokal. Njohja e të drejtave konkrete private e të huajve tregtar,

---

<sup>11</sup>Po aty, f. 32.

nënkuptonte mundësinë e pjesëmarrjes në veprimtari tregtare në territorin e huaj, përkatësisht krijimin e mundësisë juridike për zhvillimin e qarkullimit ekonomik. Mirëpo, ky qarkullim si në masa lokale, ashtu edhe nëpër masa interlokale ishte i dobët dhe i pazhvilluar. Ndikim kishin më tepër faktor, si p.sh. karakteri natyral i prodhimtarisë, niveli i ulët i forcave prodhuese, mosekzistimi i mjeteve moderne të komunikacionit dhe lidhjeve, etj.

Nëse të huajve nuk u njiheshin në mënyrë të jashtëzakonshme të drejtat private (civile), atëherë ndaj tyre zbatoheshin institute dhe zakone konkrete që ishin karakteristikë për shtetet në periodën e feudalizmit. Mosnjohja e të drejtave private (civile) të huajve në këtë periodë bëhej me ndihmën e këtyre instituteve dhe zakoneve: *ius albanagii (droit d'aubune)*, *ius naufragii*, *foris moritagium (droit de formariage)*.

Të drejtat familjare të huajve në feudalizëm ose u janë mohuar ose u kufizoheshin me anë të institutit *foris moritagium (droit de formariage)*, sipas terminologjisë franceze). Sipas këtij instituti i huaji parimisht nuk kishte të drejtë të lidh martesë në feudin e vendit. Por, përjashtim nga kjo rregull bëhej nëse ai merrte leje, dhe paguante taksë konkrete, e cila p.sh. në Francë ishte edhe deri në 50% të pasurisë së tij, i lejohej ajo mundësi. Mund të konstatohet se i huaji vetëm përjashtimisht ishte subjekt i marrëdhënieve familjare.

Instituti *ius albanagii* i njohur edhe si *droit d'aubune* në të drejtën Belge dhe Franceze, i mundësonte feudalit (i jepte të drejtë) që ta përvetësonte pasurinë e të huajit në territorin e tij pas vdekjes së tij. Në shekullin e mesëm i huaji parimisht nuk mund të ishte trashëgimtar e as trashëgimlënës, ndryshe thënë, marrëdhëniet juridiko – trashëgimore me element të huaj nuk mund të krijoheshin. Ky institut gradualisht në mesjetë u abrogua me traktate ndërkombëtare.<sup>12</sup>

Me anë të institutit *ius naufragii* u mohohej e drejta pronësore të huajve në feudalizëm. Sipas këtij instituti pronar i bregdetit bëhej pronar i mallit dhe mbeturinave të anijes në rast të anijetherjes që valët i nxirrnin në breg. Që anijetherjet të jenë sa më të shpeshta, me qëllim janë ndezur zjarre (sinjale të rrejshme) në viset bregdetare shkëmbore, që të shkaktohej përmytja e

---

<sup>12</sup>A. Weiss, *Traité theorique et pratique de droit international privé*, Paris, 1894, f. 67; E.A. Korovin, *Istoriya meždunarodnogo prava*, Moskva, 1946, f. 9-14.

anijes që mallin e ngarkuar dhe mbeturinat e trupit të anijes t'i përvetësoj pronari i bregut të detit.

Instituti i represaljeve personale i mundësonte çdo banori të feudit konkret, që dëmin e shkaktuar nga i huaji konkret ta kompensoj nga pasuria dhe personaliteti i çdo të huaji që ishte bashkatdhetar me të huajin i cili e kishte shkaktuar dëmin. Kjo mënyrë e kompensimit të dëmit në fillim lejohej pa leje me shkrim të feudalit, kurse me vonë nevojitej edhe leja e tij me shkrim.

Këto institute gradualisht abrogohen me krijimin e monarkive absolute në Evropën Perëndimore. Abrogimi i instituteve *ius albanagii*, *foris manuatum*, *ius naufragii* dhe *represalije* personale u bë në mënyrë të pjesshme dhe të jashtëzakonshme.

Abrogimi ishte i pjesshëm në atë vështrim se kryesisht u shfaq te disa shtete konkrete, te të cilat u krye bashkimi nacional dhe u krijua treg i përbashkët nacional, si që ishin p.sh. Franca dhe Holanda në sh. e XVI që kishin rol ndërmjetësues në tregtinë ndërkombëtare që zhvillohej midis lindjes dhe perëndimit.

Abrogimi ishte i jashtëzakonshëm ngase bëhej ose përmes traktateve ndërkombëtare (p.sh. në vitin 1712 Anglia dhe Franca kanë lidhur traktat me të cilin e kanë abroguar në mënyrë reciproke institutin *droit d'aubune*), ose u referohej vetëm vendeve dhe qyteteve konkrete për një kohë të caktuar gjatë vitit (p.sh. rast i tillë ishte gjatë organizimit të panairëve në Lion, Marsej, etj.).<sup>13</sup>

Në shtetet e lindjes, të gjithë ata që nuk besonin në Kuranin famë lartë, shndërroheshin në një lloj skllëvërish (përfundim ish-in ata të huaj që ishin nën mbrojtjen e emanit ose vilajetit).<sup>14</sup> Përfundim nga kjo rregull bëhej në mënyrë të veçantë, qoftë me anë të traktateve ndërkombëtare, ose përmes dhënies së privilegjeve të veçanta (si në vendet perëndimore).

## 2. SHEKULLI I RI – KOHA E RE

Në shekullin e ri (koha e re) mundësia që i huaji të paraqitet si subjekt i marrëdhënieve juridiko – private (civile) e humb karakterin e jashtëzakonshëm dhe bëhet dukuri e rregullt në shumicën e shteteve. Kjo ndodhi për arsye të intensifikimit të qarkullimit ndërkombëtar të mallrave

---

<sup>13</sup>A. Weiss, po aty, f. 71.

<sup>14</sup>A. Korovin, Istorija mezhdunarodnogo prava, Moskva, 1946, f. 26.



dhe shërbimeve që gjithnjë e më tepër fitonte karakter gjithëpërfshirës. Në fazën e mëtutjeshme të zhvillimit të drejtave private të huajve në periodën nga Lufta e parë botërore u shfaqën disa ndryshime të cilët deri në atë kohë nuk shpreheshin.<sup>15</sup>

Në këtë periodë lidhur me gëzimin (ushtrimin) e të drejtave private (civile) nga të huajt të rëndësishëm ishin dy çështje: 1. u zhdukën (nuk aplikoheshin) institutet me anën e të cilëve në shekullin e mesëm (mesjetë) mohohej ushtrimi i të drejtave civile nga të huajt (*ius albanagii, ius naufragii, foris maritagium*, etj.), ngase ishin pengesë për këmbimin gjithëpërfshirës në periodën e mënyrës kapitaliste të prodhimit, dhe 2. u nxorën rregulla të përgjithshme për ushtrimin (gëzimin) e të drejtave civile nga të huajt, të njëjta për të gjithë të huajt, pa marrë parasysh shtetësinë e tyre. Megjithatë, nxjerrja e këtyre rregullave nuk nënkuptonte ushtrimin e të drejtave private (civile) nga të huajt në masë (vëllim) të njëjtë si shtetasit e vendit. Disa të drejta private (civile), sidomos e drejta e fitimit të pronësisë në paluajtshmëri, ende nuk mund ta ushtronin të huajt (trajtoheshin si të drejta të rezervuara vetëm për shtetasit e vendit), kurse të drejtat tjera private të huajt mund t'i ushtronin nëse i plotësonin kushtet e parapara nga sistemi juridik i shtetit të vendit ose nuk duhej të plotësojnë kurrfarë kushtesh. Lidhur me këtë çështje, në doktrinën juridike u krijuan nocionet për të drejtat absolutisht të rezervuara, relativisht të rezervuara dhe për të drejtat e përgjithshme.<sup>16</sup>

Njohja e të drejtave private (civile) të huajve nuk bëhej nën kushte të njëjta në shtetet e ndryshme, kjo varej nga interesat konkrete të shteteve, të kaluarës historike, nivelit të zhvillimit ekonomik, etj. Për këtë arsye në doktrinën (shkencën) juridike të asaj kohe, praktikën dhe legjislacionet e shteteve individuale lidhur me ushtrimin (gëzimin) e të drejtave private (civile) nga të huajt shfaqen sisteme të ndryshme, si p.sh. :sistemi i trajtimit nacional, sistemi i reciprocitetit diplomatik, sistemi i reciprocitetit faktik, sistemi i koncesioneve, etj. Shfaqja e sistemeve të ndryshme ishte pengesë serioze juridike për qarkullimin ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve midis shteteve. Që të evitohen ato pengesa deri diku, u bë unifikimi i atyre të drejtave private (civile të huajve) që e pengonin zhvillimin e shkencës dhe teknikës në suaza ndërkombëtare. Për atë arsye që nga fundi i shekullit të 19. midis një numri më të madh të shteteve u unifikuan një numër i konsiderueshëm i rregullave juridike lidhur me të drejtat e të huajve p.sh. për pronësinë industriale, me Konventën e Parisit për mbrojtjen e pronësisë

<sup>15</sup>M. Bartoš, B. Nikolajević, Pravni položaj stranca, Beograd, 1951, f. 42.

<sup>16</sup>M. Jezdič, Međunarodno privatno pravo II, Beograd, 1985, f. 31.

industriale e vitit 1883, për mbrojtjen e veprave letrare, shkencore dhe artistike, Konventa e Bernit e vitit 1886., etj.<sup>17</sup>

Për këtë periodë ishte me rëndësi tendenca e krijimit të rregullave juridike unike universale për shtetasit e vendit dhe të huajt, si dhe krijimi i parimeve progresive në këtë lëmi. E gjithë kjo ishte e kushtëzuar me dukuri dhe fenomene të zhvillimit shoqëror si p.sh. kriza ekonomike botërore, paraqitja e vendeve socialiste, etj. Tendenca për zgjerimin e unifikimit e të drejtave civile të huajve u vërejt në orvatjet për miratimin e konventave multilaterale që do të përmbanin edhe rregulla universale juridike për të huajt në përgjithësi ose për të drejtat private (civile) të huajve në veçanti edhe atë jo vetëm për personat fizik por edhe për personat juridik. Kjo tendencë shihet qartë në Projektin e Paktit për të drejtat e të huajve, i përgatitur nga Komiteti ekonomik i Lidhjes së Popujve në vitin 1929., që përveç dispozitave për të drejtat e të huajve përmban edhe rregulla për shoqëritë e huaja, ngase personat juridik ishin bartësit kryesor të qarkullimit ekonomik dhe të koncentrimit të kapitalit për hir të aftësisë më të madhe konkurruese në tregjet ndërkombëtare se sa personat fizik. Personat juridik gjithashtu njëkohësisht edhe ishin format kryesore juridike të infiltrimit të kapitalit të huaj. Orvatjet për një unifikim universal nuk patën sukses, ngase për projektin debatohej në momentin kur posa kishte filluar kriza ekonomike botërore, dhe kur kundërthëniet ndërmjet shteteve të ndryshme kapitaliste ishin dukshëm të shprehura. Ata filluan të parashohin kufizime të ndryshme devizore dhe me kufizimet e tregtisë ndërkombëtare ti zvogëlojnë pasojat e krizës ekonomike ndërkombëtare.<sup>18</sup>

Gjithashtu në këtë kohë (pas Luftës së dytë botërore) u bënë përpjekje që të unifikohen rregullat juridike për të drejtat e të huajve dhe të shtetasve të vendit në kuadër të disa institucioneve shkencore – Instituti për të drejtë ndërkombëtare, hartoi një Deklaratë për të drejtat ndërkombëtare të njeriut neni 4 e trajton edhe materien për të drejtat private të huajve.<sup>19</sup> Megjithatë, kjo tendencë vjen në shprehje në punën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, e cila në mbledhjen e Asamblesë së përgjithshme e aprovoi deklaratën e përgjithshme për të drejtat e njeriut.

Në këtë kohë edhe në planin e brendshëm (nacional) filluan të zbatohen parime juridike progresive lidhur me të drejtat civile të huajve, rëndësi të veçantë ka parimi i ndalimit të diskriminimit sipas racës, gjinisë, konfesionit dhe gjuhës.

---

<sup>17</sup>M. Bartoš, B. Nikolajevič, Pravni položaj stranca, Beograd, 1951, f. 40-44.

<sup>18</sup>M. Jezdič, po aty, f. 33.

<sup>19</sup>P. Grammain, Les droits internationaux de l'homme, Paris, 1950, f.2.

### 3. KRITERET PËR KATEGORIZIMIN E TË DREJTAVE CIVILE TË HUAJVE

Termi “të drejtat civile” e ka prejardhjen nga e drejta romake, në shtetin skllavopronar Romak i nënkuptonte vetëm ato të drejta private që ishin të parapara sipas *ius civile*, dhe mund ti gëzonin (ushtronin) vetëm qytetarët romak me të drejta të barabarta (*cives optimo iure*).

Mundësia e të huajve që të jenë titullar të drejtave private dhe detyrimeve nga ato të drejta nuk ishte e njëjtë në të gjitha shtetet. Ndikim kanë pasur faktor të ndryshëm, nga të cilat gjithsesi vendimtar kanë qenë ata që e kanë caktuar karakterin (natyrën) e të drejtës që duhet t’u njihet. Këto rrethana përkatësisht faktor, megjithatë për nga efekti janë më të rëndësishëm se faktorët që kanë prejardhje ekonomike, sociale dhe demografike, dhe kanë ndikim vendimtar gjatë koncipimit (miratimit) të normave të vendit për kolizionin e ligjeve në çdo shtet individual.

Ekzistojnë më tepër kritere për kategorizimin e pozitës juridike të huajve, kjo varet se çka merret si kriter për kategorizimin. Nëse si kriter merren kategoritë e së drejtës, natyra e së drejtës në mënyrë të përgjithësuar mund të flitet për, të drejtat private të huajve (martesa, kujdestaria, trashëgimia) dhe të drejtat publike të huajve (ekstradimi, e drejta e votimit, e drejta e vendosjes, shtetësia). Pasi kjo lëmi tejet e gjerë studiohet dhe trajtohet si pjesë e të drejtës ndërkombëtare private, vëmendjen tonë do ta përqendrojmë në pozitën juridiko – private të huajve, kurse të drejtat publike do t’i trajtojmë në atë masë sa kanë ndikim në ushtrimin (gëzimin) e të drejtave private (civile).

Në doktrinën juridike të drejtat civile të huajve gjithashtu kategorizohen sipas kategorive të së drejtës civile, sipas mundësisë së gëzimit (ushtrimit) nga të huajt dhe se në momentin e krijimit të këtyre të drejtave a duhet të merr pjesë *ex officio* organi shtetëror, ose mjafton akordimi i vullnetit të palëve. Pra ndarja e tretë e të drejtave civile të huajve e merr si kriter pjesëmarrjen e organit në momentin e krijimit të tyre.

Sipas kategorive të së drejtës civile të drejtat civile të huajve ndahen në: të drejta sendore, familjare, trashëgimore, të drejta detyrimore, përfshirë edhe të drejtën e pronësisë intelektuale, të drejtën e pronësisë industriale dhe të drejtën e autorit.

Kategorizimi i të drejtave civile të huajve sipas mundësisë së ushtrimit (gëzimi) nga të huajt e ka prejardhjen nga shekulli i XIX (perioda e nxjerrjes

së kodeve civile). Sipas kësaj ndarjeje të gjitha të drejtat civile të huajve kategorizohen në tre grupe: të drejta absolutisht të rezervuara, të drejta relativisht të rezervuara dhe të drejtat e përgjithshme.

Kategorizimi i të drejtave civile të huajve sipas pjesëmarrjes së organit në momentin e krijimit të tyre, bëhet në të drejta që krijohen me pjesëmarrjen e organit të shtetit konkret, ku përfshihen të drejtat familjare të huajve, të drejtat sendore të huajve në sende të paluajtshme, të drejtat trashëgimore të huajve dhe të drejtat e të huajve në pronësi industriale. Në grupin e dytë të të drejtave civile të huajve që krijohen pa pjesëmarrje të organit të shtetit përfshihen: të drejtat sendore të huajve në sende të luajtshme, të drejtat detyrimore dhe të drejtat e autorit.

Më i rëndësishëm është kategorizimi i të drejtave civile (private) të huajve sipas mundësisë së gëzimit (ushtrimit), ngase sensi i normës juridike në këtë lëmi konsiston në caktimin e pozitës juridike të huajve nga e cila drejtpërdrejtë varet mundësia e gëzimit e të drejtave konkrete. Sipas kriterit të ushtrimit (gëzimit) nga të huajt (personat fizik dhe juridik) të drejtat private (civile) të huajve klasifikohen në tre grupe: 1) të drejta të përgjithshme; 2) të drejta relativisht të rezervuara, dhe 3) të drejta absolutisht të rezervuara.

### **3.1. Të drejtat e përgjithshme**

Të drejtat e përgjithshme janë ato të drejta të cilat të huajt mund ti gëzojnë, përkatësisht ushtrojnë nën kushtet e njëjta si shtetasit e vendit. Për ushtrimin e këtyre të drejtave të huajt barazohen me shtetasit e vendit. Për gëzimin e këtyre të drejtave është irelevante se subjekti a është i vendit ose i huaj. Për këtë kategori të drejtash është me rëndësi se të huajt mund të gëzojnë nën kushte të njëjta formale si edhe shtetasit e vendit. Me fjalë tjera kjo do të thotë se nëse nga shtetasi i vendit për gëzimin e të drejtës konkrete kërkohet të plotësohet kusht konkret, kushtin e njëjtë duhet ta plotësojë edhe i huaji për gëzimin e asaj të drejte. Nëse për shembull në shtetin e vendit nuk mundet të lidhin martesë pjesëtarët e konfesioneve të ndryshme, ajo njëlloj e tangon edhe të huajin nëse dëshiron para organit të shtetit të vendit të lidh martesë. Ose, nëse në një shtet nuk ekziston mundësia e fitimit të pronësisë në tokën bujqësore mbi maksimumin e paraparë me ligj për shtetasit e vendit, edhe i huaji mund të fitojë vetëm në suazat e limitit të parapara me ligj për shtetasit e vendit, etj.

### 3.2. Të drejtat relativisht të rezervuara

Të drejtat private relativisht të rezervuara, të huajt mund t'i ushtrojnë (gëzojnë) vetëm me plotësimin e kushtit plotësues konkret i cili nuk kërkohet nga shtetasit e vendit, përkatësisht personat juridik të cilët kanë përkatësinë (nacionalitetin) e shtetit të vendit. Andaj këto të drejta shpeshherë emërohen të kushtëzuara, ose të drejta private (civile) relativisht të rezervuara.

Pra, relativisht të rezervuara (kufizuara) janë ato të drejta, të cilat të huajt mund t'i gëzojnë (ushtrojnë), por janë të kushtëzuara me ndonjë kusht plotësues, si p.sh. me vendbanim, reciprocitet ose me leje të organit të shtetit të vendit, plotësimi i të cilit nuk kërkohet nga shtetasit e vendit. Ky grup i të drejtave në kushtet bashkëkohore numerikisht është më i madh, me çka qartë vërehet se të huajt ende nuk janë trajtuar njëjtë (barabartë) me shtetasit e vendit. Përveç kësaj, nëse të huajt e kanë trajtimin e njëjtë me shtetasit e vendit, do të ulej "çmimi" që e ka shtetësia në treg.<sup>20</sup>

Llojet e kushteve që parashihen (u imponohen) për të huajt janë të ndryshëm. Në një rast kushti mund të varet nga marrëdhëniet reciproke ndërmjet shtetit të vendit dhe shtetit të shtetasit të huaj, ku si kusht parashihen llojet e ndryshme të reciprocitetit si për nga mënyra e krijimit ashtu edhe për nga përmbajtja juridike.<sup>21</sup> Në rastin tjetër, kushti që duhet plotësuar nga i huaji ndërlidhet me personalitetin e pretendonte për të drejtën private konkrete (raca, konfesionin, gjinia, përkatësia etnike, etj.). Ndonjëherë kushti i kërkuar është vendimi i organit shtetëror kompetent i shtetit të vendit, i cili vendos për kërkesën e të huajit. Në situatat konkrete ai kusht është i natyrës objektive – subjektive, ngase përmbushja e tij varet si nga qëndrimi i organit kompetent në shtetin e vendit, ashtu edhe nga vetë i huaji (p.sh. konstatimi se personi në fjalë a e ka fituar vendbanimin në shtetin e vendit).<sup>22</sup> Megjithatë, përfaqësues tipik i të drejtave relativisht të rezervuara (kushtëzuara) është e drejta e fitimit të pronësisë në paluajtshmëri.

### 3.3 Të drejtat absolutisht të rezervuara

Absolutisht të rezervuara janë ato të drejta të cilat të huajt nuk mundin ti ushtrojnë (gëzojnë) në shtetin e vendit. Ato të drejta janë të rezervuara vetëm për shtetasit e vendit. Bëhet fjalë për të drejta të cilat në mënyrë të

<sup>20</sup>Tibor Varadi, Međunarodno privatno pravo, Beograd, 2010, f. 462.

<sup>21</sup>Më tepër për llojet e reciprocitetit : A, Bilalli, H, Kuqi, E drejta ndërkombëtare private, Prishtinë 2001

<sup>22</sup>Milorad Ročkomomanovič, Međunarodno privatno parvo, Niš, 2006, f. 171

drejtpërdrejtë e tangojnë sovranitetin ose sigurinë e shtetit konkret, ose interesat vitale të tij, dhe për atë arsye e parasheh atë kufizim. Caktimi i të drejtave private që nuk mund të gëzohen (ushtrohen) nga të huajt, e bën çdo shtet në mënyrë individuale. Në bazë të gjendjes aktuale të sistemeve juridike dhe praktikës gjyqësore të shteteve të ndryshme ajo dukuri më e shprehur është në materien e ushtrimit të drejtave civile (private) të huajve në paluajtshmëri. Edhe pse numri i atyre të drejtave në kushtet bashkëkohore është në rënie, megjithatë ato janë prezentë, sidomos në lëminë publike. Ashtu për shembull e drejta e ushtrimit të funksioneve publike, siç është prokuror publik, ose gjyqtar, etj., mund të jenë vetëm shtetasit e vendit.<sup>23</sup>

#### 4. PËRFUNDIMI

Si pjesmarrës në qarkullimin ndërkombëtar të mallrave dhe të marrëdhënieve familjare dhe trashigimore që krijohen nga ai qarkullim, paraqiten dhe marrin pjesë si subjektet e vendit ashtu edhe të huajët (personat fizik dhe juridik). Mundësinë që si subjekt i marrëdhënies juridiko - private me element të huaj, përkatësisht bartës i të drejtave dhe detyrimeve të paraqitet i huaj. Çdo shtet e parashef dhe e rregullon në bazë të parimeve dhe rregullave konkrete juridike të veta. Rregullimi i të drejtave private të huajve është çështje interne e çdo shteti, dhe ai nuk mundë të detyrohet që të drejtat konkrete tua mundësoj ti gëzojnë të huajët. Megjithate, në kushtet bashkëkohore të zhvillimit të njerzimit, intensifikimi i marrëdhënieve juridike me element të huaj imponon probleme të llojllojshme juridike qëparaqiten rishtas dhe shtrohen në një formë dhe dimension të ri.

Lëvizja e njerëzve, mallrave, kapitalit, krijimtarisë intelektuale dhe individëve, sot janë dukuri e rregullt, dhe karakteristikë e rëndësishme e botës bashkëkohore, e gjithashtu edhe e ardhmërisë, që nuk ka qenë ashtu në të kaluarën. Nëpër formacionet e ndryshme ekonomiko – shoqërore këto të drejta u janë mohuar të huajve me anë të instrumenteve të ndryshme juridike. Në këtë punim janë trajtuar fazat e ndryshme të zhvillimit gjatë historisë të drejtave private të huajve, nga bashkësia skillovopronare e deri në kushtet e sotme, si dhe kriteteret për mundësinë e gëzimit nga të huajt të këtyre të drejtave në kushte bashkëkohore.

---

<sup>23</sup>Poliksena Gavrovska, Toni Deskoski, Međunarodno privatno parvo, Skopje, 2012, f. 467



**Prof. Dr. Asllan Bilalli**

## **HISTORICAL DEVELOPMENT OF THE (PRIVATE) CIVIL RIGHTS OF FOREIGNERS AND CRITERIA FOR CATEGORIZATION RELATED TO ENJOYMENT OF SUCH RIGHTS BY FOREIGNERS**

### **SUMMARY**

As participants in the international movement of goods as well as family and inheritance relationships arising from that circulation, both domestic and foreign entities (natural and legal persons) participate and are part of such relationships. The possibility that as a subject of the legal-private relationship with a foreign element, ie the holder of the rights and obligations, is regulated by each state on the basis of its specific legal principles and rules. The regulation of the private rights of aliens is an internal matter of every state, and it can not be forced to grant specific rights to foreigners. However, under the contemporary conditions of human development, the intensification of legal relations with foreign elements imposes a variety of legal problems that are newly introduced and laid in a new form and dimension.

The movement of people, goods, capital, intellectual property, today is a regular phenomenon and an important feature of the contemporary world, as well as the future, which has not been so in the past. Through different economic and social formations these rights have been denied to foreigners through various legal instruments. This paper deals with the different phases of development during the history of the private rights of foreigners, from the scholovopronary community to the present conditions, as well as the criteria for the possibility of enjoyment by foreigners of these rights under contemporary conditions.



**Nur Çeku\***

## **ASPEKTE TË MBIKËQYRJES PARLAMENTARE TË SEKTORIT TË SIGURISË NË KOSOVË**

### **HYRJE**

Sikur në gjitha sistemet parlamentare siç është edhe Kosova, Parlamenti luan rol thelbësor në fushën e sigurisë. Mbikëqyrja parlamentare ndikon drejtpërdrejt në krijimin e rendit demokratik, i cili ofron siguri për të gjithë qytetarët e vendit. Në Kosovë, mbikëqyrja parlamentare e sektorit të sigurisë mund të periodizohet në disa faza duke filluar nga paslufta e tutje.

Në qershor të vitit 1999, sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-se, Kosova u vendos nën administrimin ndërkombëtar. Në mungesë të një sektori vendor të sigurisë, prania ndërkombëtare ushtarake dhe civile kishte përgjegjësinë për sigurinë e kufijve të Kosovës dhe ruajtjen e rendit publik. Gjatë administrimit ndërkombëtar statusi i padefinuar politik i Kosovës ndikoi që sektori i sigurisë të jetë kompetencë e rezervuar për bashkësinë ndërkombëtare. Në vitin 2001, filloi ndërtimi i institucioneve të përkohshme vetëqeverise (IPVQ) me konstituimin e legjislaturës së parë të Kuvendit të Kosovës. Por sektori i sigurisë vijonte të ishte fushë ekskluzivisht e rezervuar për praninë ndërkombëtare.

Përfshirja e institucioneve të Kosovës në sektorin e sigurisë ka filluar tek në vitin 2005, me inicimin e procesit të rishikimit të sektorit për siguri të brendshme (RSSB).<sup>1</sup> Por pavarësisht kësaj, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) si shefi misionit civil ndërkombëtar (UNMIK) ka ushtuar kompetencën ekzekutive për sektorin e sigurisë deri në shpalljen e

---

\* Nur Çeku është doktorant në fushën e drejtës publike në Fakultetin Juridik të Universitetit "Hasan Prishtina" në Prishtinë. Nga 2013 deri me 2015, ka ndjekur dhe përfunduar kursin e lartë ekzekutiv për të drejtën parlamentare në Universitetin e McGill-it në Kanada.

<sup>1</sup> Rishikimi i Sektorit për Siguri të Brendshme (RSSB) ka filluar në vitin 2005 nga Përfaqësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm z. Soren Jesen Petersen. Ky proces identifikoi përgjegjësitë institucionale të Kosovës, kërcënimet dhe strukturën e arkitekturës së sigurisë që duhej të kishte Kosova në të ardhmen. Këto rekomandime me disa ndryshime u përfshijnë në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të z. Marti Ahtisari.

pavarësisë së Kosovës me 17 shkurt 2008. Pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Kosovës u miratua legjislacioni përkatës i cili mundësoi kompletimin me disa kufizime të arkitekturës së re të sigurisë në Kosovë. U themeluan disa institucione të reja: Forca e Sigurisë (FSK), Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Këshilli i Sigurisë, ndërsa Shërbimi Policor e ndryshoi emrin në Policia e Kosovës, kurse Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) sipas marrëveshjes u shpërbëvit pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Kosova mori përgjegjësitë e saja institucionalë rreth sigurisë së brendshme, ndërkohe mandati i pranisë ushtarake ndërkombëtare vijon i angazhuar në aspektin e mbrojtës dhe garantimit të kufijve të Kosovës.

Shpallja e pavarësisë krijoi një mjedis në të cilin Kuvendi i Kosovës, mori përgjegjësitë e tij në fushën e sektorit të sigurisë. Sigurisht se për mënyrën e zhvillimit të sektorit të sigurisë në Kosovë dhe rrethanat specifike që u ndërtua ky sektor mund të flitet e shkruhet gjatë. Ndërtimit dhe strukturimit i këtij sektori gjatë tërë procesit i ka munguar pronësia vendore dhe dizajnimi i tij ishte tërësisht nga faktori ndërkombëtar. Kjo ka ngritur edhe dilemën e legjitimitetit të këtij procesi. Por për arsye të këtij punimi tema do të trajtohet rreth mbikëqyrjes parlamentare e cila po ashtu është zhvilluar sipas specifikave përmes se cilave ka kaluar edhe procesi i shtetndërtimit të Kosovës. Në fakt procesi i shtet ndërtimit të Kosovës ende po vijon dhe arkitektura e sigurisë nuk mund të quhet e kompletuar pa mandatin ushtarak të FSK që pritet e ndryshohet në të ardhmen. Ky punim analizon momentet kyçe të mbikëqyrjes parlamentarëse ushtruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës mbi këtë sektor strategjik në kuadër të pushtetit shtetëror (ekzekutiv).

## **1. SIGURIA TIPAR THELBËSOR I SHTETIT-MBIKËQYRJA PARLAMENTARE GARANCI PËR SUNDIMIT TË LIGJIT NË SEKTOR TË SIGURISË**

Meqenëse shteti përbën një etnitet të bazuar në territor të caktuar, popullsi dhe qeverisje efektive, atëherë siguria është një kusht i domosdoshëm për funksionimin e këtij etniteti. Prandaj, edhe procesi i krijimit të shteteve është formësuar nga konfliktet ndërkombëtare e sidomos nga tiparet e saj që lidhen me sigurinë.<sup>2</sup> Në këtë aspekt, me qëllim të garantimit të sigurisë dhe rendit juridik, shtetet krijojnë institucione përgjegjëse të cilat e përbëjnë sektorin e sigurisë. Ky sektor përbëhet nga institucione të organizuara në shoqëri, që posedojnë monopolin e ligjshëm të përdorimit të forcës. Institucionet e

---

<sup>2</sup> Alan Collins, Studime bashkëkohore të sigurisë, Oxford Press University, 2010, fq. 28

sigurisë shihen si garanci për zbatimin e ligjshmërisë në shtet dhe ofrimin e sigurisëpërtë gjithë qytetaret e vendit.<sup>3</sup> Mirëpo, përkundër kësaj, edhe pse mandati i këtyre institucioneve për qëllim primar ka sigurinë e qytetareve, prapëseprapë është e domosdoshme që këto t'i nënshtrohen kontrollit civil i cili shërben si balancues në mes të monopolit të forcës dhe mbrojtjes së të drejtave fundamentale të njeriut. Lidhur me këtë, ndarja e pushtetit në tri degë të qeverisjes, e njohur si ndarje vertikale e pushtetit, konsiderohet si mekanizëm (instrument) institucional për të ekuilibruar (barazpeshuar) pushtetin dhe për të pamundësuar keqpërdorimin e tij.<sup>4</sup> Kontrolli i përhershëm civil dhe përfaqësues mbi veprimtarinë e institucioneve të sigurisëshndërrohet në mjet të fuqishëm të ekuilibrit në mes të institucioneve të sigurisë dhe përfaqësimit legjitim politik.<sup>5</sup>

Kontrolli civil ushtrohet nga tri degët kryesore të shtetit, nga shoqëria civile dhe nga mediat. Kontrolli i drejtpërdrejtë ushtrohet nga Qeveria apo organet ekzekutive, të cilat e planifikojnë buxhetin, i hartojnë politikat e sigurisë kombëtare dhe qeverisin me sektorin e sigurisë. Parlamenti e ushtron mbikëqyrjen parlamentare, pasi e miraton legjislacionin që e rregullon funksionimin e sektorit të sigurisë dhe buxhetin dhe e mbikëqyr qeverisjen e tij. Ndërsa organet gjyqësore e mbikëqyrin fushën e sigurisë, pasi, sipas kompetencës, i zhvillojnë procedurat për personelin që shërbejnë në këto institucione sipas rastit në procedurë civile apo penale. Ndërsa shoqëria civile dhe mediat e kanë një rol të rëndësishëm, duke e informuar publikun me veprimtarinë e sektorit të sigurisë.

Kompetencat e parlamentit në fushën e sigurisëpërcaktohenme Kushtetutë dhe specifikohen tutje me legjislacion dhe me aktet tjera. Shumica e kushtetutave i përmbajnë prerogativat që ka Parlamenti për fushën e sigurisë, por që dallojnë nga një kushtetutë në tjetrën.<sup>6</sup> Mbikëqyrja është një shprehje gjithëpërfshirëse, që ngërthen shqyrtimin e kujdesshëm *ex ante*, monitorimin

---

<sup>3</sup>Rreth konceptit të sigurisë dhe dimensioneve të saj, me fokus të siguria njerëzore shih Bahri Beqiri & Nur Çeku, *Hyrje në Politikën e Sigurisë*, Kapitulli i parë, fq. 15 – 50, Prishtinë, 2016.

<sup>4</sup>Joseph Jerome, *The Structure of the Judicial System*, London, College Journal, 2003, fq. 4

<sup>5</sup>Enver Hasani, *Komentari i Kushtetutës së Kosovës*, Prishtinë, 2013, fq. 641.

<sup>6</sup>Shih Kushtetuta e SHBA-ve, në nenin e parë për degën legjislative përmban kompetencat që Kongresi Amerikan ka në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Kongresi ka kompetencë “të shpallë luftë, të lëshojë letrat e reprezaljeve dhe të nxjerrë rregulla për trajtimin e rasteve të kapjes së objekteve të kundërshtarit në tokë apo det”. Kongresi ka kompetencë të ngrejë dhe ta mbajë ushtrinë, t'i miratojë mjetet financiare, përcaktimin e rregullave për drejtimin dhe kontrollin e forcave ushtarake tokësore dhe detare dhe për thirrjen në veprim të Milicisë. Po ashtu shih Kushtetuta e Francës në nenin 35 përcakton se “shpallja e luftës bëhet me autorizim të Parlamentit”.

e vazhdueshëm dhe shqyrtimin *ex post*, si dhe vlerësimin dhe hetimin.<sup>7</sup>Në praktike në të shumtën e rasteve mbikëqyrja njësohet me kontrollin që në fakt janë institute të ndryshme nga njeri -tjetri, sepse me kontroll nënkuptohen kompetencat për t'i drejtuar politikat dhe aktivitetet e organizatës e deri tek detyrimi për ndryshim vendimesh. Kontrolli zakonisht ndërlihet me degën ekzekutive. Ndërsa mbikëqyrja parlamentare në fushën e sigurisë varet nga kompetencat e Parlamentit në lidhje me qeverinë dhe sektorin e sigurisë, dhe kjo kompetencë duhet të paraqesë mundësi për të ndikuar në zgjedhjet dhe qëndrimin e Qeverisë në përputhje me vullnetin e qytetarëve, të shprehur në Parlament.

Mbikëqyrja parlamentare në fushën e sigurisë përfshin *interalia* detyrimin e përfaqësuesve të ekzekutivit apo të punonjësve të shërbimeve të sigurisë, qofshin të zgjedhur apo të emëruar, për të dhënë llogari para Parlamentit në lidhje me ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të tyre. Qëllimin themelor i mbikëqyrjes parlamentare në fushës e sigurisë është minimizimi i shpërdorimit të pushtetit nga institucionet, agjencitë dhe shërbimet e sigurisë dhe të mundësojnë efikasitetin e këtyre institucioneve për përmbushjen e mandatit ligjor.

Sipas një studimii cili ka trajtuar mbikëqyrjen parlamentare rezulton se nga 158 parlamente të botës, 51 prej tyre ushtrojnë mbikëqyrje të sektorit të sigurisë.<sup>8</sup> Parlamentet e kanë një gamë të gjerë të përgjegjësive e mekanizmash, që dallojnë nga njëri vend në tjetrin lidhur me kontrollin e sektorit të sigurisë: ai diskuton dhe miraton ligje të fushës së sigurisë dhe mbrojtës, vendos për çështjet buxhetore dhe i kontrollon shpenzimet, kërkon informacione nga institucionet e sigurisë, ratifikon marrëveshjet ndërkombëtare, merr vendim për dërgimin e forcave jashtë vendit, rolin e organit mbikëqyrës për shërbimet inteligjente, mbikëqyrjen e përgjimeve, deklarimin dhe heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme. Në procesin e mbikëqyrjes parlamentare në fushën e sigurisë përdoren instrumentet ligjore të zakonshme të kontroll parlamentare siç janë pyetjet parlamentare, dëgjimet publike, seancat dëgjimore, interpelancat dhe hetimet parlamentare. Për të arritur mbikëqyrje efektive komisionet parlamentare bashkëpunojnë edhe me organet tjera mbikëqyrëse, siç janë institucionet supreme të auditimit, inspektoratet apo zyra e Avokatit të Popullit.

---

<sup>7</sup>HansBorn dhe AidenWills, Mbikëqyrja e shërbimeve të inteligjencës - Pako e instrumenteve, Gjenevë, 2012. fq. 6.

<sup>8</sup>Studim nga Universiteti i Kalifornisë dhe Universiteti i Gjorgjtaunit, cituar sipas LodeVanoost, ish-zëvendëskryetar i Dhomës sëPërfaqësuesve të Belgjikës, në ligjëratën për qeverisjen e sektorit të sigurisë, Prishtinë, 20 prill 2010.

## 2. PRAKTIKA E MUNGUAR PARLAMENTARE NË FUSHËN E SIGURISË NË KOSOVË (1999-2005)

Korniza Kushtetuese e Kosovës e cila u miratua më 15 maj 2001, me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9 mundësoi fillimin e procesit të themelimit të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisë të Kosovës (IPVQ). Sipas këtij akti bazik juridik, Kuvendi i Kosovës ishte institucioni më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës i Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë. Gjatë legjislaturës së parë (2001-2004), Kuvendi i Kosovës ishte plotësisht i zhveshur nga çdo kompetencë për të ushtruar mbikëqyrje parlamentare ndaj sektorit të sigurisë në Kosovë. PSSP-ja, bashkë me praninë ndërkombëtare e kishin tërë përgjegjësinë në të gjitha çështjet e mbrojtjes, sigurisë, rendit publik, emergjencave publike, mbikëqyrjen kufitare, rregullimin e armëmbajtës<sup>9</sup> dhe e ushtronin kontrollin dhe pushtetin e plotë mbi Trupat e Mbrojtës së Kosovës (TMK)<sup>10</sup> dhe Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK).<sup>11</sup>

Në mandatin e legjislaturës së parë, Kuvendi i Kosovës (2001-2004) nuk kishte fare komision parlamentar funksional për sektorin e sigurisë. Kuvendi kishte themeluar një komisionin që quhej Komisioni për gatishmëri emergjente me rol mbikëqyrës mbi departamentin qeveritar për menaxhimin e emergjencave dhe strukturat lokale të emergjencave. Edhe në legjislaturën e dytë Kuvendi i Kosovës (2004-2007), vazhdonte të kishte kompetencë të kufizuar në mbikëqyrjen e sektorit të sigurisë. Komisioni për gatishmëri emergjente nuk kishte ndonjë rol të theksuar, por ky komision e krijoi perspektivën e zhvillimit të kapaciteteve mbikëqyrëse të Kuvendit të Kosovës në fushën e sigurisë në legjislaturat e ardhshme.

---

<sup>9</sup>Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, Kreu 8.

<sup>10</sup>TMK u themelua si pjesë e procesit të demilitarizimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, u themelua si një trupe e uniformuar për reagime në raste emergjente në pajtime me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/8, dhe me 'Deklaratën e Primeve'.

<sup>11</sup>SHPK u krijua nga Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE), e cila ishte Shtylla e Tretë e misionit të UNMIK-ut. SHPK-ja u konsolidua si një shërbim profesional, multietnik, pa barrierën e së kaluarës dhe kjo ndikoi që të ketë një mbështetje të madhe në opinionin.

### **3. FILLET E MBIKËQYRJESPARLAMENTARE TË SEKTORIT TË SIGURISË(2005 - 2008)**

Gjashtë vite pas vendosjes së administratës ndërkombëtare në Kosovë, përfshirja vendore në sektorin të sigurisë, vazhdonte të ishte e kufizuar. Menaxhimi dhe kontrolli civil i sektorit të sigurisë mbeteshin “zone e ndaluar” për vendorët. Zhvillimi institucional i sektorit të sigurisë ishte kompleks, duke pasur parasysh sfidat politike dhe problemet rreth statusit të Kosovës. Në disa fusha, si në arsim, shëndetësi, tregti, industri, transport, planifikim hapësinor, administratë lokale ishin bartur disa kompetenca. Por përgjegjësitë ekzekutive në fushën e sigurisë vazhdonin të ushtroheshin nga Shtylla e Parë e UNMIK-ut dhe KFOR-it. Në kuadër të Zyrës së Kryeministrit u themelua zyra për siguri publike,<sup>12</sup> e cila u konsiderua si një zyrë ndërlidhëse ndërmjet UNMIK-ut dhe IPVQ-ve për shkëmbim të informacionit për çështje të sigurisë.

Trazirat e marsit në vitin 2004, dëshmuuan mungesën e kapaciteteve të IPVQ-ve në menaxhimin e krizave dhe pas kësaj bashkësia ndërkombëtare filloi të marrë në konsideratë bartjen e disa kompetencave edhe në fushën e sigurisë tek autoritet kosovare. Paaftësia e IPVQ-ve në menaxhimin e rasteve të krizave në cilat cenohet drejtpërdrejt siguria e qytetarëve ishte theksuar në mënyre indirekte edhe në raportin e ish të dërguarit të bashkësisë ndërkombëtare për Kosovën ambasadorit KaiAide, lidhur me brengën e qytetarëve të Kosovës për sigurinë e tyre.<sup>13</sup>

Përfshirja e institucioneve të Kosovës në sektorin e sigurisë filloi në vitin 2005, me inicimin e procesit të rishikimit të sektorit të brendshëm të sigurisë (RSBS), i cili rezultoi me krijimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë. Me shtimin e kapaciteteve administrative dhe operacionale, kompetencat ekskluzive, që atëbotë i kishte policia e UNMIK,dalëngadalë filluan të kalojnë tek ato vendore. Pas bartjes së përgjegjësisive policore te autoritetet e Kosovës, përgjegjësia për

---

<sup>12</sup>Zyra për Siguri Publike është krijuar me Urdhëresën Administrative nr. 2004/16 për implementimin e Rregullores nr. 2001/ 19 për degën ekzekutive për vetëqeverisje, 30 qershor 2004.

<sup>13</sup>Në mesin e të gjitha përvojave tona, do të veçoja posaçërisht dhjetë ditët e kaluara duke udhëtuar gjithandej Kosovës, për të takuar sa më shumë njerëz që ka qenë e mundur në qytete, fshatra e vendbanime të panumërta. Ky udhëtim na ka treguar atë që nuk mundeshin takimet në Prishtinë: mënyrën se si jetojnë njerëzit në Kosovë, vështirësitë me të cilat përballen dhe shpresat e frikat që i kanë për të ardhmen e tyre, shih Raportin e Kai Aides për Kosovën. Prishtinë 2005,[www.unmikonline.com](http://www.unmikonline.com).

funksionimin e Shërbimit Policor të Kosovës, e cila i nënshtrohej autorizimit të PSSP-se u transferua tek Ministria e Punëve të Brendshme.

Ne fillet e konsolidimit institucional të policisë, kontrollit demokratik ndaj SHPK-se ishte i paqartë për shkak se Kuvendi të Kosovës i mungonin kompetencat për ushtrimin e mbikëqyrjes parlamentare. Për ta përmbushur këtë detyrë, Kuvendi i Kosovës në seancën plenare, të mbajtur më 14 gusht 2006, pasi e shqyrtoi raportin dhe propozimin e komisionit për gatishmëri dhe emergjencë të Kuvendit të Kosovës mori vendim që ky komision të riemërohet në komision për siguri.<sup>14</sup> Kuvendi i përcaktoi kushtet e punës dhe fushëveprimin këtij komisioni që përfshintë mbikëqyrjen parlamentare të sigurisë së brendshme, mbikëqyrjen e policisë, mbikëqyrja e buxhetit, sigurinë për minoritetet, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe dhënia e rekomandimeve për Kuvendin.<sup>15</sup>

Me themelimin e komisionit për siguri, Kuvendi i Kosovës filloi t'i ndërtonte kapacitetet mbikëqyrëse edhe në fushën e sigurisë. Komisioni organizoi disa seanca dëgjimore me institucionet e atëhershme të sigurisë dhe u mor me shqyrtimin e disa ligjeve që i përkitnin kësaj fushe. Në kuadër të këtij procesi u organizuan edhe seanca dëgjimore me stafin drejtues të TMK-së, edhe pse në këtë fazë kjo organizatë vazhdonte të ishte nën mbikëqyrjen e PSSP-së dhe KFOR-it, e kjo u konsiderua si tejkalim i kompetencave IPVQ-ve. Ky komision<sup>16</sup> ishte aktiv në ushtrimin e mbikëqyrjes parlamentare, dhe krijoi kontaktin dhe raportimin e nevojshëm me të gjitha institucionet e sigurisë, duke organizuar seanca dëgjimore qeverinë e Kosovës.

---

<sup>14</sup>Vendimi i Kuvendit të Kosovës nr.02-2463-01/06

<sup>15</sup>Para se të riemërohej dhe shndërrohej në Komision për Siguri, anëtarët e këtij komisioni e kishin kryer një fazë trajnimi prej gjashtë muajsh për ta krijuar një ekspertizë të nevojshme për punën e ardhme të komisionit, duke vizituar edhe disa komisione homologe në vendet fqinja.

<sup>16</sup>Puna e Komisionit ishte evidentuar në raportin e *Human Rights Watch*, nr. 2, mbi të dhënat e përgjithshme mbi të drejtën penale në Kosovë, 2008, fq.12, ku mes tjerash theksohej se, “Në shtator të 2006, Kuvendi i Kosovës e krijoi Komitetin Parlamentar për Siguri, me qëllim që ta ushtrojë kontrollin demokratik mbi SHPK-në, ministritë qeveritare dhe autoritetet tjera kombëtare përgjegjëse për sigurinë e Kosovës. Përveç se mund t'i marrë dëshmitarët në pyetje, Komiteti mund të drejtojë pyetje rreth institucioneve përkatëse të Kosovës për të nxitur aksione në shërbim të informacioneve. Ky komitet ishte veçanërisht aktiv në vijim të protestave të “Vetëvendosjes” në shkurt të 2007, në të cilat dy protestues u vranë nga plumbat plastike të gjuajtur nga policia e UNMIK. Komiteti bëri thirrje dhe pyeti disa nga policët me përvojë të SHPK-së dhe nëpunësit e Qeverisë të Kosovës. Hetimet e tyre i matën sekuencat e ngjarjeve, por nuk mund të nxirrnin në shesh se kujt i binte përgjegjësia. Por, nuk u ngrit akuzë për njësitin e policisë rumune.

Gjatë kësaj periudhe po zhvilloheshin negociatatndërkombëtare për statusin final të Kosovës dhe procesi i RBSS-së.<sup>17</sup> Rekomandimet e dala nga RBSS-ja do të përfshihen në masën të madhe në propozimin gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit të Kosovës, të propozuar nga ish-presidenti finlandez, MartiAhtisari. Edhe kjo periudhë nuk kishte ndonjë ndryshim rrënjësor sa u përket kompetencave të IPVQ-së në sektorin e sigurisë, e as praktikë parlamentare të konsoliduar në këtë fushë. Por, e rëndësishme ishte se filloi faza e bartjes së disa përgjegjësive në fushën e sigurisë nga ndërkombëtarët te vendoret me themelimin e resorëvepërdrejtësi dhe punëve te brendshme nëkuadër të ekzekutivit te Kosovës e cila po bënte progres drejt pavarësisë.

#### **4. MBIKËQYRJA PARLAMENTARE E SEKTORIT TË SIGURISË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS PAS SHPALLJES SË PAVARËSISË 2008 E TUTJE**

Shpallja e Kosovës, shtet i pavarur dhe sovran (2008) dhe miratimi i Kushtetutës se saj, mundësoi kompletimin e sektorit vendor te sigurisë. Kapitulli i XI i Kushtetutës parasheh se institucionet kushtetuese te sektorit te sigurisë ne Kosove janë: Forca e Sigurisë, Këshilli i sigurisë, Agjencia Kosovare për Inteligjencë, Policia e Kosovës dhe Autoriteti Civil i Aviacionit.<sup>18</sup> Kushtetuta po ashtu vendose edhe parimet dhe standardet e avancuara tëndërtimit dhe funksionimit tëkëtij sektori me fokus të siguria dhe barazia e qytetarëve.Mbrojtja e të drejtave të qytetarëve nga institucionet e sigurisë dhe veprimet e këtyre institucioneve nëmënyretransparentë dhe në pajtim me standardet e mbrojtjes se lirive dhe te drejtave të njeriut është njeri nga kushtet parimore te zhvillimit te punës se tyre.<sup>19</sup>

Baza kushtetuese dhe ligjore që e rregullon sektorin e sigurisë parasheh një mori kompetencash të Kuvendit në fushën e sigurisë, siç janë:shqyrtimi dhe miratimii legjislacionit; thirrjen e ekzekutivit dhe personelit të institucioneve të sigurisë në seanca dëgjimore; shqyrtimin e buxhetit; çështjet e prokurimit;

---

<sup>17</sup>Në nëntor të vitit 2005, KaiAide u emërua si përfaqësues special i OKB-së për rishikimin e përgjithshëm të gjendjes në Kosovë, i cili e lansoi raportin për vlerësimin e standardeve dhe rekomandoi se ka ardhur koha të lëvizet në drejtim të definimit të statusit politik të Kosovës. RBSS - Rishikimi i brendshëm i sektorit të sigurisë në Kosovë, i iniciuar nga Qeveria e Kosovës dhe UNMIK-u, në vitin 2005, me qëllim të vizionit të sigurisë se brendshme në Kosovë.

<sup>18</sup>Për shkak te natyrës se punimit, mandati dhe kompetenca e këtyreinstitucioneve në tekstin e punimit përmendenshkurtimeisht.

<sup>19</sup>Shih Arsim Bajrami, Sistemi Kushtetutës i Republikës se Kosovës, Prishtinë, 2012. fq.360.



miratimin e politikave të sigurisë,<sup>20</sup> miratimin e dërgimit të FSK-së jashtë vendit dhe dhënien e pëlqimit për vijimin e gjendjes së jashtëzakonshme. Kontrolli civil dhe demokratik garantohej mbi institucionet e sigurisë.<sup>21</sup> Duke u mbështetur në këtë parim, ligjet bazike që e rregullojnë funksionimin e institucioneve të sigurisë në Kosovë parashohin procedura për ushtrimin e kontrollit civil mbi sektorin e sigurisë .

Me kushtetutë u themelua institucioni i Këshillit të Sigurisë së Kosovës me rol këshillues në të gjitha çështjet që lidhen me sigurinë e Kosovës dhe kontributin e tij për stabilitetin rajonal.<sup>22</sup> Mbikëqyrja parlamentare ndaj këtij institucioni po ashtu është obligim ligjor dhe kryesuesi i këshillit duhet ta dorëzojë raportin vjetor të aktiviteteve për diskutim dhe miratim në komision përkatës të Kuvendit, jo më vonë se muaji mars për të vijit. Sipas këtij ligji, komisioni parlamentar mund të organizojë seanca për çështje lidhur me punën e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, të cilat Kuvendi dëshiron t'i parashtrijë.<sup>23</sup>

Forca e Sigurisë u krijua si instrument i sigurisë për të kryer detyra që nuk janë në natyrën e policisë me mandat të kufizuar dhe të armatosura lehtë, mandati i së cilës do të rishikohet pas periudhës pesëvjeçare. Legjislacioni për FSK-në përmban dispozita të qarta lidhur me ushtrimin e kontrollit civil për këtë forcë. Sipas ligjit për FSK-në, Kuvendi i Kosovës ka kompetencë për të “ushtruar kontroll demokratik parlamentar mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës”<sup>24</sup>, duke paraparë edhe themelimin e komisionit parlamentar përgjegjës për mbikëqyrjen e kësaj force.

Sipas këtij ligji, ky komision ka kompetencë t'i analizojë të gjitha strategjitë, ligjet dhe dokumentet mbi politikat e dorëzuara nga MFSK-ja, nëpërmjet Qeverisë, në pajtim me këtë ligj, dhe i përgatit ato për debat në Kuvend. Komisioni ka kompetenca që ta shqyrtojë buxhetin për FSK-në para dorëzimit në Kuvend për miratim. Në ligj është një dispozitë shumë e rëndësishme lidhur me mbikëqyrjen e procedurës së pajisjes së FSK-së, e cila e mandaton komisionin për t'i shqyrtuar edhe projektet për pajisje me vlerë më të lartë se 1 000 000 (një milion) euro, të propozuar nga MFSK-ja,

---

<sup>20</sup>Në mesin e mesin e politikave të sigurisë që miratohen nga Kuvendi, është Strategjia se Kosovës për Siguri, komptence e cila buron nga Ligji nr. 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë, Gaz. zyrt. nr. 26/ 2,qershor 2008, neni 2 parag.1.

<sup>21</sup>Kushtetuta e Kosovës, neni 125.4

<sup>22</sup>Shih Ligji nr. 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë, Gaz. zyrt. nr. 26/ 2,qershor 2008

<sup>23</sup>Ligji nr. 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë, neni 9,parag. 2.

<sup>24</sup>Ligji nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, Gaz. zyrt. Nr.27/3,qershor 2008, neni 4.

si ato që financohen nga Qeveria, ashtu edhe ato që financohen nga donatorët. Zinxhiri drejtues dhe komandues i FSK-së obligohet, në bazë të dispozitave ligjore, të cilat e rregullojnë përgjegjësinë për raportim para Komisionit Mbikëqyrës Parlamentar të raportojë për çështjet që ndërlihen me FSK.<sup>25</sup>

Institucion tjetër i sektorit të sigurisë që u themelua në Kosovë pas pavarësisë është Agjencia e Kosovës për Inteligjencë. Qëllimi i themelimit të këtij institucioni ishte nevoja për të pasur informacion në kohë dhe të saktë në çështje të inteligjencës, kundërinteligjencë, kërcënime nga brenda dhe jashtë, terrorizmin ndërkombëtar apo vendor, prodhimin dhe trafikimin e narkotikëve, krimin e organizuar, krimin ekonomik, sabotimin dhe të gjitha çështjet tjera të inteligjencës të lidhura me sigurinë e Kosovës është esenciale për popullatë Kosovës.<sup>26</sup> Kushtetuta parasheh se kjo Agjenci i nënshtrohet mbikëqyrjes se Kuvendit sipas mënyrës se përcaktimit me dispozita të ligjit lexspecialis

Kuvendi i Kosovës e ka mandatin për të vepruar edhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Dispozitat kushtetuese që e rregullojnë këtë fushë i japin mandat Kuvendit që në rast të shpalljes së dekretit të Presidentit për gjendjen e jashtëzakonshme, Kuvendi brenda dyzet e tetë orësh duhet ta japë pëlqimin për këtë me 2/3 e votave të deputetëve të pranishëm që votojnë dhe në rast se nuk jepet pëlqimi, dekreti i Presidentit nuk ka efekt. Afati kohor sa mund të zgjasë gjendja e jashtëzakonshme është jo më shumë se 60 ditë. Nëse paraqitet nevoja, Kuvendi mund ta miratojë një afat shtesë prej 30 ditësh, por gjendja e jashtëzakonshme nuk mund ta kalojë periudhën më të gjatë se 90 ditë

## **5. KOMISIONET PARLAMENTARE -MEKANIZMAT LIGJOR PËR USHTRIMIN E KONTROLLIT**

Ushtrimi i mbikëqyrjes parlamentare ndaj sektorit të sigurisë, në masën më të madhe ushtrohet nëpërmjet komisioneve përkatëse parlamentare. Këto komisione, në shumicën e parlamenteve janë të përhershme, duke krijuar kështu vazhdimësi të punës dhe bartjes së përvojës së anëtareve të

---

<sup>25</sup>Ligji nr. 03/L-045 për Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Gaz. zyrt. nr. 26/2,qershor 2008.

<sup>26</sup>Ligji nr. 03/L-063 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Gaz. zyrt. nr. 30/15,qershor 2008.

Parlamentit në legjislaturat e tyre. Komisionet për mbrojtje dhe siguri janë organe të specializuara të Parlamentit që i japin këshilla dhe i bëjnë rekomandime seancës plenare për ligje ose vendime që lidhen me mbrojtjen kombëtare dhe sigurinë e qytetarëve.<sup>27</sup>Përmes këtij autoriteti ligjor ato luajnë rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen parlamentare të sektorit të sigurisë përmes hetimit, këshillimit dhe hedhjes dritë në qoshet errëta..<sup>28</sup> Kuvendi i Kosovës, pas shpalljes se pavarësisë themeloi dy komisione parlamentare përgjegjëse për institucionet e sigurisë dhe inteligjencës që janë: komisioni për punë të brendshme, siguri dhe mbikëqyrje të FSK-së dhe komisioni parlamentar për mbikëqyrjen e AKI-së. Në bazë të legjislacionit në fuqi këto komisione kanë fushëveprim të ndarë ku njeri ushtron mbikëqyrjen parlamentare ndaj institucioneve të sigurisë (FSK, Policia, Këshilli i Sigurisë, MPB, MFSK dhe agjencive ekzekutive në kuadër të këtyre institucioneve) dhe komisioni tjetër që në mënyre ekskluzive mbikëqyrë ligjshmërinë e aktivitete të AKI.Procedurat e punës dhe fushëveprimi i komisioneve rregullohen me Rregulloren e Punës së Kuvendit.

Një prej detyrave me të theksuara të Komisionit për siguri dhe mbikëqyrje të FSK, ka qenë mbikëqyrja e procesit të shpërbërjes së TMK-se, gjatë legjislaturës së III të Kuvendit (2008-2010). Ky komision kishte mandat t'i kërkojë Qeverisë së Kosovës dhe pranisë ushtarake ndërkombëtare që të informojnë rreth procesit të shpërbërjes së TMK-së.<sup>29</sup>Si rezultat i procesit të shpërbërjes një numër i konsiderueshëm e pjesëtareve të TMK-se kishin kundërshtuar legjitimitetin e procesit pasi nuk ishin përfshirë në institucionin e FSK-së. Komisioni e ka mbikëqyrur këtë proces vazhdimisht, duke e trajtuar në mbledhjet e veta, organizuar seanca dëgjimore me palët e

---

<sup>27</sup>Në përgjithësi, roli i komisioneve parlamentare përmbledhet në këto fusha: shqyrtimin dhe miratimin e legjislacionit, miratimin e buxhetit, angazhimin për traktatet ndërkombëtare që duhet t'i ratifikojë Parlamenti, emërimet në postet e larta, organizimin e seancave dëgjimore para komisionit, thirrjen e personelit të segmenteve të sigurisë për të dëshmuar në raste të caktuara, marrjen në pyetje të ministrave dhe anëtarëve të tjerë të Ekzekutivit, kërkimin për ekspertizë të dokumenteve, shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave ndaj personelit, kryerjen e vizitave dhe të inspektimeve në bazat e ushtrisë dhe në instalime të tjera në fushën e sigurisë dhe trupave të dislokuar në misione jashtë vendit, shihDCAF Backrounder, 01/ 2006, Komisionet për mbrojtje dhe siguri, fq. 1

<sup>28</sup> J.R. Odgers, Clerk of the Austirlian Senate 1970, Cituar sipas FrederickStapenhurs në ligjëratën për rolin mbikëqyrës të Parlamentit në Universitetin e McGillit, Kanadë,18 prill 2013.

<sup>29</sup>Ligji nr. 03/L -083për shpërbërjen e Trupave Mbrojtëse, Gaz. zyrt.Nr. 31/15 qershor 2008, neni 11 par. 2.

përfshira në këtë proces dhe kishte bërë rekomandime për zgjidhjen e situatës.<sup>30</sup>

Përderisa gjatë afër 10 vjetëve të funksionimit të TMK-së, mbikëqyrja e saj kishte qenë kompetencë e rezervuar për UNMIK-un dhe KFOR-in, tani në procesin e shpërbërjes së saj, bashkësia ndërkombëtare kishte propozuar që këtë proces ta mbikëqyrte Kuvendi i Kosovës. Kjo për faktin se procesi ishte i vështirë, kompleks dhe bashkësia ndërkombëtare, kështu synim që procesi të kishte legjitimitet, i pranueshëm me lehtë i menaxhuar. Komisioni e kanë në mandatin e vet të shqyrtojnë dhe miratojnë legjislacionin për këto institucione, ta ushtrojnë kontrollin parlamentar siç parashihet me legjislacionin në fuqi dhe të bëjnë vizita nëse këtë e vlerësojnë të domosdoshme në zyrat, komandat apo njësitë e këtyre institucioneve.

Komisioni kanë bërë shqyrtimin dhe rekomandimet për disa projektligje të fushës së sigurisë, rekomandime për situatën e sigurisë dhe raporte të tjera nga fushëveprimi i tyre. Në mesin e këtyre kompetencave rol primar ka mbikëqyrja e zbatimit të ligjeve.<sup>31</sup> Ushtimi efektiv i funksionit mbikëqyrës të komisionit në legjislaturën e katërt ishte pasqyruar edhe në Raportin e Progresit për Kosovën për vitin 2014.<sup>32</sup> Përveç kësaj, Komisioni kishte ndërmarr edhe veprime tjera korrektuese që drejtpërdrejt ndërlidheshin me zbatimin e legjislacionit nga ana e Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së FSK. Një ndërhyrje e tillë e komisionit rezultoi në ndryshimin e disa pikave të Memorandimit të Mirëkuptim mes dy ministrive që në vlerësim të komisionit ishte përzierje kompetencash. Por ky trend i ushtimit të kontrollit

---

<sup>30</sup>Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 25.2.2009 kishte konstatuar se procesi i shpërbërjes së TMK-së po rezulton me sfida, prandaj kërkohet angazhimi i të gjithë faktorëve relevantë, me qëllim të përmbylljes së këtij procesi me sukses. Duhet të merren masa të menjëhershme, në mënyrë që ky proces të mos eskalojë në ndonjë formë të padëshiruar. Komisioni kishte bërë disa rekomandime, me të cilat kërkohet që Qeveria e Kosovës dhe mekanizmat tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë, të përfshirë në këtë proces, duhet të hartojnë një strategji dalëse, e cila duhet ta përfshijë rishikimin e lëshimeve eventuale, dhe pjesëtarët që i plotësojnë kriteret dhe kanë mbetur jashtë FSK-së të thirren për trajnim. Dokument i komisionit nr. 03/ 26 shkurt 2009.

<sup>31</sup>Gjatë procesit të mbikëqyrjes komisioni ka mbikëqyruar zbatimin e Ligjeve si në vijim: Ligjit për Ripranim, Ligjit për Inspektoratin Policor, Ligjit për Policinë.

<sup>32</sup>ShihRaporti i Progresit për Kosovën, 2014, Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë, fq.12 ku theksohet se, “Ka pasur progres të moderuar në punën e Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Komisioni ka shtuar numrin e takimeve dhe anëtarët e tij ishin të përgatitur mirë. Ministrat u ftuan më shpesh në seanca publike dhe iu përgjigjën shqetësimeve të parlamentarëve. Komisioni gjithashtu ka përgatitur një raport të monitorimit për zbatimin e Ligjit për Policinë e Kosovës dhe mbi shpenzimet nga ana e policisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme“.

efektiv në periudhën pasuese pësoi rëniedhe kjo për shkak të rrethanave të punës së Kuvendit dhe kjo u pasqyrua në Raportin e Progresit për Kosovën në vitin 2016.<sup>33</sup> Është me rëndësi të theksohet fakti se ky komision përveçkompetencës për mbikëqyrjen në fushën e sigurisëështë edhe komision legjislativ i cili ka mandat shqyrtimin dhe analizimin e legjislacionit.

Për dallim nga kjo komisionipërmbikëqyrjen e AKI-se ka vetëm mandat mbikëqyrës dhe jo legjislativ. Ky komision është i veçantë nga komisionet tjera parlamentare të Kuvendit të Kosovës për dy arsye: sepse ka mandat të beje hetime parlamentare dhe kryesuesi i Komisionit duhet të zgjidhet nga radhët e deputeteve të opozitës. Këto padyshim se paraqesin standarde të avancuara demokratike në qeverisjen e inteligjencës. Është e njohur fakti se mbikëqyrja parlamentare e këtij segmenti mbetet një sfidë e përhershme, jo vetëm në Kosovë, por kudo. Gjithsesi, bota e inteligjencës është një kuti e zezë që duhet trajtuar në një mënyrë të caktuar për të parë brenda saj.<sup>34</sup> Pas sulmit terrorist të 11 shtatorit 2001, këto shërbime janë në procesin e përshtatshmërisë ndaj kërcënimeve të reja të sigurisë. Rreziku më i madh nuk është më pushtimi nga jashtë, por krimi i organizuar, terrorizimi, konfliktet e brendshme, trafikimi i iqenieve njerëzore që kanë ndikuar që shërbimet e inteligjencës t'i dinamizojnë aktivitetet e tyre. Ky realitet ka pasur konsekuencat e sepse ka vështirësuar procesin e mbikëqyrjes së ligjshmërisë së punës së këtyre shërbimeve.

Mandati i komisionit ndaj mbikëqyrjes të AKI, është si vijon: shqyrtimi i raportet të drejtorit të AKI-së në lidhje me operacionet dhe shpenzimet financiare, shqyrtimi i raporteve të inspektorit të përgjithshëm, të ofrojë një mendim për propozimin e detajuar të buxhetit për AKI-në dhe të kryejë hetime në lidhje me punën e AKI-së. Dispozitat ligjore kanë përcaktuar qartë

---

<sup>33</sup>Shih Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2016, tek Mbikëqyrja civile e forcave të sigurisë në fq. 8 dhe 9 theksohet se: “ Për shkak të ngërcit politik dhe bojkoteve në parlament, ka pasur progres të kufizuar në punën e komisionit parlamentar për punë të brendshme, siguri dhe mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe të komisionit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë. Komisioni parlamentar ka organizuar seanca dëgjimore për ligjet që kanë të bëjnë me policinë dhe regjistrin civil por nuk ka ushtruar mbikëqyrje të shpenzimeve, duke përfshirë shpenzimet e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Lidhja e ngushtë në mes të parlamentarëve të komisioneve përkatëse dhe udhëheqësisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës ka penguar mbikëqyrjen e pavarur. Procesi i verifikimit ka vazhduar të përmirësohet por ky proces më tepër kryhet nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë sesa nga një organ i pavarur. [https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/20161109\\_kosovo\\_report\\_2016\\_alb.pdf](https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/20161109_kosovo_report_2016_alb.pdf)

<sup>34</sup>BertVanDelden, Kryetar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Shërbimeve të Inteligjencës dhe Sigurisë të Holandës, në parathënie tek: Mbikëqyrja e Shërbimeve të Inteligjencës, Pako e Instrumenteve, DCAF dhe Ministria e Jashtme e Holandës, Gjenevë, 2012

edhe procedurat për hetimet parlamentare, nëse Komisioni ka bazë të besojë se AKI-ja i kryen detyrat e veta në mënyrë të paligjshme. Komisioni ka kompetencë t'i shqyrtojë raportet e kryeministrit në lidhje me çështjet brenda kompetencave, të cilat përfshijnë veprime të ndërmarra për të korrigjuar çfarëdo problemesh në AKI, të bëra të ditura nëpërmjet inspektimit, auditimit apo hetimit.

Ligji e përcakton qartë se Komisioni mund ta urdhërojë drejtorin e AKI-së të paraqitet para komisionit, në mënyrë që drejtori të japë raport gojor në lidhje me aktivitetet e AKI-së. Sipas kompetencës ligjore nuk mund të themelohet komision hetimor i posaçëm për AKI, sepse ky komision ka mandatin edhe të një komisioni hetimor. Komisionet tjera parlamentare nuk mund të kryejnë hetime parlamentare. Për të ushtruar hetime parlamentare për një çështje të caktuar, Kuvendi duhet të themelojë komision të posaçëm hetimor sipas ligjit për hetim parlamentar.<sup>35</sup> Por edhe pse komisioni ka kompetenca të gjera të ushtrimit të mbikëqyrjes parlamentare ndaj AKI-së, mbikëqyrja ndaj këtij institucioni na është tejet sipërfaqësore dhe fragmentare. Një moment pozitiv që mund të theksohet nga puna e komisionit është procesi i mbikëqyrjes së Ligjit për klasifikimin e informacionit dhe verifikimin e sigurisë gjatë legjislaturës së V-të Kuvendit.<sup>36</sup>

Por përveç komisionit për punë të brendshme, siguri dhe mbikëqyrjen e FSK-së dhe komisionit për mbikëqyrjen e AKI-së, rol të caktuar mbikëqyrës ndaj sektorit të sigurisë kanë edhe disa komisione tjera parlamentare. Kjo kompetence realizohet nga komisionet e përhershme si: komisioni për legjislacion, komision për buxhet dhe financa, komisioni për integritet evropian, komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve.<sup>37</sup> Por, rol në fushën e sigurisë kanë edhe komisioni për punë të jashtme, pasi shumë procese në fushën e sigurisë në rrafshin ndërkombëtar dhe atë të traktateve dhe marrëveshje ndërkombëtare janë në fushëveprim të komisionit për punë të jashtme. Komisioni për mbikëqyrjen e financave publike, i cili shqyrton raportet e Zyrës së Auditorit dhe pasqyrat financiare të të gjitha institucioneve buxhetore, përfshirë edhe ato të sigurisë, dhe përgatit raportin për shqyrtim në mbledhje plenare të Kuvendit.

---

<sup>35</sup>Shih Ligjin Nr. 03/L-176 për Hetim Parlamentar, Gaz.zyrt. nr.74/20 korrik 2010

<sup>36</sup>Komisioni gjatë këtij procesi kishte gjetur se shumë institucione nuk zbatojnë dispozitat e këtij ligji rreth klasifikimit të informacionit të klasifikuar dhe procedurat rreth pajisjeve me leje të sigurisë.

<sup>37</sup>Rregullorja e Kuvendit të Kosovës, neni 57.parag. 1. në [www.kosova.assembly.org](http://www.kosova.assembly.org).

## 6. SFIDAT DHE PERSPEKTIVA E MBIKËQYRJES PARLAMENTARE

Kosova e ka përmbushur një standard të lartë demokratik, pasi bashkë me ndërtimin e sektorit të sigurisë e ka instaluar edhe kontrollin civil dhe mbikëqyrjen parlamentare të këtij sektori. Por përkundër faktit se ekziston baza ligjore dhe Kuvendi i themeloi komisionet funksionale për fushën e sigurisë dhe inteligjencës, megjithatë ende ka sfida dhe konsolidimi i saj i mirëfilltë mbetet objektiv për të ardhmen. Lista e sfidave mund të jete e gjatë por ne vijim paraqesim disa me kryesorët:

- Debatet parlamentare rreth çështjeve të sigurisë më shumë u zhvilluan në komisionet funksionale, e shumë pak në mbledhjet plenare të Kuvendit;
- Instrumentet e kontrollit parlamentar, me përjashtim të pyetjeve parlamentare, u përdorën shumë rrallë;
- Mbikëqyrja parlamentare nuk arriti të kishte shumë ndonjë rol domethënës dhe karakterizuar nga zhvillimi fragmentar i saj;
- Komisionet nuk i kanë shqyrtuar asnjëherë raportet e kryeministrit lidhur me punën e Këshillit të Sigurisë;<sup>38</sup>
- Nuk është bërë asnjëherë kërkesë për t'i shqyrtuar kontratat mbi një milion euro të pajisjeve të FSK-së;
- Nuk janë thirrur në seancë dëgjimore përgjegjësit e institucioneve të sigurisë për t'i diskutuar të gjeturat e raportit të auditimit dhe moszbatimin e rekomandimeve paraprake dhe rreth menaxhimit të buxhetit;
- Kuvendi ende nuk ka hartuar procedurat për ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve apo informacioneve të klasifikuara sipas ligjit përkatës;<sup>39</sup>
- Ne asnjëlegjislaturë deputet e komisionevepërgjegjëse nuk kaluan ne procedurat e verifikimit të sigurisë si obligim ligjor për pajisjen e tyre me lejen e sigurisë, e cila do t'u mundësonte qasje në informacione të

---

<sup>38</sup>Ligji Nr. 03/L-050 për Themelimin e Këshillit të Sigurisë, Gaz. zyrt., nr. 26/ 2, neni. 9.1, qershor 2008, thotë: Kryesuesi e dorëzon raportin vjetor të aktiviteteve për diskutim dhe miratim nga komisioni përkatës i Kuvendit, jo më vonë se muaji mars për vitin e kaluar. Komisioni mund të kërkojë raporte rreth aktiviteteve specifike të Këshillit të Sigurisë së Kosovës kurdo që konstatohet e nevojshme.

<sup>39</sup>Shih Ligji nr. 03/L-178 për klasifikimin e informacionit dhe verifikimin e sigurisë, Gaz. zyrt., nr. 76/ 10, qershor 2010.

klasifikuara në raste të caktuara, dhe kjo do ta rriste cilësinë e mbikëqyrjes parlamentare, ndaj ligjshmërisë së punës së AKI-së.

- Bashkëpunimi mes komisioneve parlamentare dhe me institucionet tjera, sidomos me Avokatin e Popullit, Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm, Inspektoratin Policor dhe të FSK-së, apo gjykatat, ka munguar apo ka qenë fragmentar dhe kjo e paraqet një aspekt tjetër negativ të ushtrimit të mbikëqyrjes parlamentare.

Këto sfida, mbetet të adresohen në të ardhmen nga Kuvendi dhe komisionet. Sigurisht se një dimensionim pozitiv pritet të ketë nga masat zbatuese legjislative dhe teknike rreth zbatimit të Marrëveshjes për Stabilizim-Asocimit mes BE-së dhe Kosovës.<sup>40</sup> Në kuadër të MSA, titullit VII, ku listohen liria drejtësia dhe siguria, janë një varg çështjesh ku Kosova duhet të avancoi si forcimi i pavarësisë së gjyqësorit, luftimi i terrorizmit, lëvizja e lirë, mbrojtja e të dhënave personale, menaxhimi i kufijve dhe migracioni i ligjshëm. Angazhimi i komisioneve në mbikëqyrjen e zbatimit të këtyre masave do të fuqizoi mbikëqyrjen parlamentare ndaj sektorit tësigurisë në Kosovë. Po ashtu edhe zbatimi i detyrimeve që dalin nga Raporti për vendin(ish Raporti i Progresit) konsiderohet si një “udhërrëfyes” rreth angazhimeve në fushat e caktuara tëmbikëqyrjes parlamentare dhe fuqizimit të saj.

## 7. REKOMANDIME

Nga trajtimi i këtij punimi kemi ardhur në disa rekomandime si në vijm:

- Angazhimi i komisioneve duhet tëdinamimizohet sidomos në mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës së institucioneve të sigurisë;
- Bashkëpunimi i munguar mes komisioneve parlamentare duhet të fuqizohet përmes aktiviteteve mbikëqyrëse të përbashkëta;
- Komisionet parlamentare përgjegjëse funksionale për siguri dhe AKI, duhet të përgatisin raporte rreth veprimtarisë së institucioneve qëmbikëqyrin dhe të diskutohen nga Kuvendi në seancë plenare, së paku një herë në vit;

---

<sup>40</sup>Marrëveshja e Stabilizim Asociimit është marrëveshja e parë kontraktuale mes Kosovës dhe BE-së dhe ajo përcakton mekanizmat dhe afatet zyrtare për zbatimin e të gjitha reformave që do ta përafrojnë Kosovën me BE-në në të gjitha fushat e politikavepërfshirë edhe ato që prekin rendin e brendshëm juridik. MSA mbulon të gjitha sferat e qeverisjes.



- Ligji për klasifikimin e informacionit dhe verifikimit të sigurisë duhet të plotësohet dhe ndryshohet dhe Departamenti i Verifikimit duhet të kalojë si institucion jashtë AKI-se;
- Anëtarët e komisioneve parlamentare mbikëqyrëse duhet të pajisen me lejen e sigurisë sepse kjo do të rrisë cilësinë e mbikëqyrjes parlamentare;
- Bashkëpunimi me institucionet e pavarura sidomos me Auditorin e Përgjithshëm dhe Avokatin e Popullit vendoset në linjë të përhershme;
- Komisionet duhet të përqendruar sidomos në mbikëqyrjen e detyrimeve që kanë institucionet rreth zbatimit të detyrimeve nga MSA dhe Raporti për vendin.

**Nur Çeku\***

## **ASPECTS OF PARLIAMENTARY OVERSIGHT OF THE SECURITY SECTOR IN KOSOVO**

### **SUMMARY**

The parliamentary oversight of the security sector in Kosovo has gone through a sui generis process of development and consolidation. Up until Kosovo's declaration of independence, the security sector was in the sole competency of the international civilian and military community, where Kosovo's parliament had no access. A new momentum was created after the declaration of independence, where the Kosovar authorities took institutional ownership. The creation of the Constitution and proper legislation led to the creation of parliamentary committees, whose role was to oversee all sectors, including the security sector.

Kosovo's security sector was developed with specific instructions from the international community. However, Kosovo's institutions have passed necessary legislation that guarantee the functionality and the democratic governance of the security sector. The parliament and its committees have a key role in this aspect. It is clear that Kosovo has transitioned to a democracy, because besides building the security sector, it has also installed civil control and it's a proper functioning of parliamentary oversight. However, there are still challenges ahead. The implementation of necessary reforms stemming from the Stabilization and Association Agreement, as well as the European Commission's Country Report, will contribute to furthering and bettering the parliamentary oversight in Kosovo.

---

\* Nur Çeku is a PhD Candidate in Public Law at the Law Faculty of "Hasan Prishtina" University in Prishtina. From 2013 to 2015, he attended and completed the high-ranking executive course on parliamentary law at McGill University in Canada.

**Msc.Ardrit Gashi\***

## **ROLI I PARIMEVE TË UNIDROIT SI NJË NDIHMESE NË INTERPRETIMIN E CISG**

### **1. SHQYRTIME HYRËSE**

#### **A. Konventa për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave (*Convention on International Sales of Goods - CISG*)**

Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Kontratat për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave (Convention on International Sales of Goods – CISG-u) paraqet një ndër aktet juridike ndërkombëtare me të njësuaranë të drejtëkontraktuale për shitjet ndërkombëtare të mallrave.

Kjo Konventë është përgatitur dhe miratuar nga Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare (UNCITRAL), në konferencën diplomatike të këtij komisioni të mbajtur me datë 11 prill 1980. Në fakt, përgatitjet e kësaj konventekishin filluarqysh në vitin 1930 në Institutin Ndërkombëtar për Unifikimin e së Drejtës Private (UNIDROIT) në Romë. Mirëpo, për shkak të Luftës së Dytë Botërore kishte pasur një ndërprerjeje të punës në përgatitjen e një akti apo konvente të tillë. Në vitin 1964, ky projekt u paraqit në konferencën diplomatike në Hagë, e cila miratoi dy konventa, një për shitjen ndërkombëtare të mallrave dhe tjetrën për hartimin e kontratave për shitjen ndërkombëtare të mallrave.<sup>1</sup> Mirëpo, për shkak të kontradiktave dhe divergjencave që reflektonin kryesisht traditat ligjore dhe realitetet ekonomike të Evropës Perëndimore Kontinentale, menjëherë pas miratimit të këtyre dy konventave, pati kritika të gjera në lidhje me këto konventa dhe dispozitat e tyre. Si pasojë, në vitin 1968 një nga detyrat e para të ndërmarra nga UNICITRAL-i ishte t'u kërkonte Shteteve nëse ato donin të vazhdonin të mbështesnin këto konventa dhe arsyetimin për qëndrimet e tyre. Në dritën e përgjigjeve të marra, UNICITRAL-i vendosi të studionte të dy konventat për të përcaktuar cilat

---

\* Kandidat për Doktoratë në Fakultetin Juridik, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

<sup>1</sup> United Nations Commission on International Trade Law (UNCITRAL), *Explanatory Note on the United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods*, United Nations Publication 2010, pg. 33.

<http://www.uncitral.org/pdf/english/texts/sales/cisg/V1056997-CISG-e-book.pdf>

modifikime mund t'i bënte në mënyrë që ato të jenë më të pranueshëm nga vendet me sisteme ligjore, sociale dhe ekonomike të ndryshme. Rezultati i këtij studimi ishte përfundimisht miratimi i Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi Kontratat për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave me 11 prill 1980, dhe e cila përmbledh lëndën e të dy ish-konventave të mëparshme.<sup>2</sup> Për njëmbëdhjetë shtetet e para (Argjentina, Kina, Egjipti, Franca, Hungaria, Italia, Lesoto, Siria, Shtetet e Bashkuara, Jugosllavia dhe Zambia) kjo Konventë hyri në fuqi më 1 janar 1988, të cilat në një farë mënyre përfaqësonin çdo rajon gjeografik, çdo fazë zhvillimi ekonomik dhe çdo sistem kryesor ligjor, social dhe ekonomik. Aktualisht këtë Konventë e kanë ratifikuar, aderuar apo në ndonjë mënyrë tjetër e kanë pranuar 80 shtete (duke përfshirë së fundi edhe aderimin e Japonisë në vitin 2008 dhe Brazilit në vitin 2013), ky fakt nënkupton se kjo konventë tërheq edhe përqindjen me të lartëtëpjesëmarrjes së vendeve në fushën tregtare.<sup>3</sup> Pra, kjo Konventë konsiston në një të drejtë ndërkombëtare tregtare (biznesore) e cila rezulton nga shume tradita juridike.<sup>4</sup>

Siç shihet nga preambula, qëllime kësaj Konvente është krijimi një regjim modern apo rregull të ri ekonomik dhe juridik ndërkombëtar, i cili do të rregulloj tregtinë ndërkombëtare të mallrave në baze të barazisë dhe përfitimit reciprok, dhe i cili do të kontribuonte në heqjen e barrierave ligjore në tregtinë ndërkombëtare dhe nxiste zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare.<sup>5</sup> Edhe pse për nga karakteri juridik, ky akt juridik ka cilësinë e konventës, kjo nuk do të thotë se detyrimisht palët duhet ta aplikojnë. Palët mund të përjashtojnë zbatimin e kësaj Konvente, ose në disa raste të shmangin osendryshojnë efektin e çdonjërit prej dispozitave të saj,<sup>6</sup> kjo natyrisht është

---

<sup>2</sup> United Nations Commission on International Trade Law (UNCITRAL), *Explanatory Note on the United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods*, United Nations Publication 2010, pg. 33.

<http://www.uncitral.org/pdf/english/texts/sales/cisg/V1056997-CISG-e-book.pdf>

<sup>3</sup> Dennis, M., *The Guiding Role of the CISG and the Unidroit Principles in Harmonising International Contract Law*, pg.25, International Trade/ADR in the South Pacific, February 2013, (Last seen: February 2015).

<http://www.victoria.ac.nz/law/nzacl/PDFS/SPECIAL%20ISSUES/HORS%20SERIE%20VOL%20XVII/04%20Dennis.pdf>

<sup>4</sup> Smaka, R., *E drejta biznesore ndërkombëtare*, fq. 361, Universiteti Iliria, Prishtinë 2006.

<sup>5</sup> Preamble of United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods – CISG (Last seen: February 2015)

<http://www.uncitral.org/pdf/english/texts/sales/cisg/V1056997-CISG-e-book.pdf>

<sup>6</sup> See, Article 6 and Article 12 of CISG.

në pajtim edhe me parimin fundamental të së drejtës kontraktuese, me atë të ‘lirisë së kontraktimit’.<sup>7</sup>

### **B.Parimet e UNIDROIT për Kontratat Komerciale Ndërkombëtare - (*International Institute for the Unification of Private Law - UNIDROIT*)**

Instituti Ndërkombëtar për Unifikimin e të Drejtës Private (International Institute for the Unification of Private Law – UNIDROIT), paraqet një organizatë të pavarur ndërkombëtare me seli në Romë, qëllimi të cilës është të studiojë nevojat dhe metodat për modernizimin, harmonizimin dhe bashkëpunimin në fushën private, veçanërisht në të drejtën komerciale ndërmjet shteteve dhe të krijojë një sistem unik të së drejtës për të drejtën komerciale. Kjo organizatë aktualisht ka 63 shtete anëtare të cilat dhe iu përkasin të pesë kontinenteve të ndryshme dhe të cilat në një mënyre përfaqësojnë edhe sisteme të ndryshme politike, juridike dhe ekonomike.<sup>8</sup> Në vitin 1994, kjo organizatë pas një pune të gjatë, për herë të parë kishte publikuar Parimet e Kontratave Komerciale Ndërkombëtare<sup>9</sup>, ndërsa të ribotuara dhe plotësuara në vitin 2004<sup>10</sup> dhe 2010<sup>11</sup>. Duhet të theksohet se Parimet e UNIDROIT nuk paraqesin një të drejtë të detyrueshme (ius cogens) për shtetet dhe palët subjekte të kontratave komerciale ndërkombëtare, mirëpo, megjithatë ato paraqesin një të “drejtë të butë” e cila ofron zgjidhje të vlefshme konkrete dhe një hap të rëndësishëm drejt harmonizimit dhe unifikimit të së drejtës kontraktuese.<sup>12</sup> Roli i këtyre parimeve shihet në mënyrë të qartë nëse i referohemi vetë këtyre parimeve. Në preambulën e këtyre parimeve përcaktohet se këto parime vendosin katër rregulla themelore për kontratat komerciale ndërkombëtare, e të cilat parashohin se: Parimet e UNIDROIT do të aplikohen nëse palët janë pajtuar që kontrata tyre të qeveriset nga këto parime; parimet e UNIDROIT mund të aplikohen nëse palët janë pajtuar që kontrata e tyre të qeveriset nga rregullat e përgjithshme të së drejtës siç është *lex mercatoria* apo të ngjashme; parimet e UNIDROIT

<sup>7</sup> Ferriell, J., *Understanding Contracats*, pg.52, Capital University Law School, Second Edition, LexisNexis, 2009.

<sup>8</sup> UNIDROIT - History and Overview (<http://www.unidroit.org/about-unidroit/overview>), (shikuar: shkurt 2015).

<sup>9</sup> UNIDROIT Principles of International Commercial Contracts, Rome 1994.

<http://www.unidroit.org/instruments/commercial-contracts/unidroit-principles-1994>

<sup>10</sup> UNIDROIT Principles of International Commercial Contracts, Rome 2004.

<http://www.unidroit.org/instruments/commercial-contracts/unidroit-principles-2004>

<sup>11</sup> UNIDROIT Principles of International Commercial Contracts, Rome 2010.

<http://www.unidroit.org/instruments/commercial-contracts/unidroit-principles-2010>

<sup>12</sup> Zeller, B., *The UNIDROIT Principles of Contract Law; is there room for their inclusion into domestic contracts*, Journal of Law and Commerce, pg.115, [Vol. 26:115], 2006-2007.

mund të aplikohen nëse palët nuk kanë përcaktuar se cila e drejtë duhet të aplikohet; parimet e UNIDROIT mund të shërbejnë si mjet për interpretimin dhe plotësimin e të drejtës së brendshme të vendeve të ndryshme, mjet për interpretimin e instrumenteve të tjera unifikuese të së drejtës kontraktuese, dhe po ashtu si model për trupat apo organet ndërkombëtare në nxjerrjen e akteve juridike për këtë fushë.<sup>13</sup> Po ashtu, vlen të përmendet fakti se këto Parime, edhe pse i referohen kontratave komerciale ndërkombëtare sipas emërimit që mbajnë, megjithatë këto parime mund të vlejné edhe për kontratat e thjeshta brendshme (jo ndërkombëtare), nëse palët private pajtohen me këtë.<sup>14</sup> Mbi këtë bazë, këto parime padyshim mund të paraqesin edhe një lloj të veçantë burimi të së drejtës kontraktuese,<sup>15</sup> dhe po ashtu mjet për interpretimin dhe plotësimin e të drejtës së brendshme kontraktuese.<sup>16</sup>

Një fakt shumë më rëndësi i cili i karakterizon Parimet e UNIDROIT është se çdo nen i këtyre parimeve është i përcjellur me komentin dhe interpretimin përkatës për atë nen. Pa dyshim komentimi i këtyre neneve duke filluar nga vetë nocioni i kontratës i ndihmon në masë të madhe subjekteve kontraktuese eventuale, sistemit juridik dhe organeve ligjvënëse, si dhe harmonizimit nëtëresi të së drejtës për shitjet ndërkombëtare.<sup>17</sup>

Nga ana tjetër, duke pasur parasysh karakterin e këtyre parimeve si e drejt e “butë” (jo e detyrueshme) e cila palëve u len hapësirë të gjerë diskrecionale për kontraktimin e saj, vije në pah edhe situata e ‘kombinimit’ të këtyre parimeve me të ndonjë të ‘drejtë’ tjetër të cilën e zgjedhin palët.<sup>18</sup> Ndërsa ky

---

<sup>13</sup> Preamble (Purpose of the Principals) of UNIDROIT Principles of International Commercial Contracts, pg.1, Rome 2010. <http://www.unidroit.org/instruments/commercial-contracts/unidroit-principles-2010>

<sup>14</sup> UNIDROIT Principles, pg. 2. <http://www.unidroit.org/instruments/commercial-contracts/unidroit-principles-2010>

<sup>15</sup> Ferriell, J., *Understanding Contracts*, pg.52, Capital University Law School, Second Edition, LexisNexis, 2009.

<sup>16</sup> Dessemontet F., *Use of the UNIDROIT Principles to Interpret and Supplement Domestic Law*, University of Lausanne, 2002, Bulletin de la Cour internationale d’arbitrage de la CCI, pg. 11.

<http://www.unil.ch/files/live/sites/cedidac/files/shared/Articles/Supplement%20Bull.%20CCI.pdf> (last seen: February 2015)

<sup>17</sup> Bonell, J.M., *The UNIDROIT Principles of International Commercial Contracts and the Harmonisation of International Sales Law*, pg.341, (2002) 36 R.J.T. 2002, (last seen: February 2015).

<https://ssl.editionsthemis.com/uploaded/revue/article/rjtvol36num2/bonell.pdf>

<sup>18</sup> Brödermann, E., *The Impact of the UNIDROIT Principles on International Contract and Arbitration Practice – the Experience of a German Lawyer*, pg.593, UNIDROIT Publication 2011 (last seen: February 2015)

'kombinim' parasëgjithash mund tëvërehet në situatat kur palët në rast të ndonjëmosmarrëveshje në mes tyre, si mjet ndihmese për interpretimet e çështjeve specifike të përdorin Parimet e UNIDROIT.<sup>19</sup>

## 2. FUSHA E ZBATIMIT TË CISG

Kjo Konventë zbatohet për kontratat e shitjes së mallrave ndërmjet palëve për të cilat vendet e biznesit janë në shtete të ndryshme<sup>20</sup>, me kushtin që ato shtete janë anëtare të kësaj konvente, ose kur rregullat e së drejtës ndërkombëtare private shpjen në zbatimin e ligjit të shtetit i cili është anëtarë i kësaj konvente (shtetit kontraktues). As kombësia e palëve, as karakteri civil ose tregtar i palëve ose i kontratës nuk merret në konsideratë në përcaktimin e zbatimit të kësaj Konvente.<sup>21</sup>Pra, sfera e aplikimit të CISG është përcaktuar nga kriteri gjeografik (neni 1 ne lidhje me nenin 10) dhe kriteri substancial (neni 1(1), neni 3-5), ndërsa karakteri kalimtar i saj është përcaktuar me nenin 100.<sup>22</sup>

Ndërsa përcaktohet se, kjo Konventë nuk zbatohet për shitjet: a) të mallrave të blera për përdorim personal, familjar apo shtëpiak, përveç kur shitësi në çdo kohë para ose gjatë lidhjes së kontratës, nuk e dinte dhe as nuk duhet të ketë ditur se mallrat ishin blerë për njërën nga këto përdorime; b) me ankand; c) në ekzekutim ose në të kundërt nga autoriteti i ligjit; d) e kapitaleve, aksioneve, letrave me vlerë të investimeve, instrumenteve të negociueshme ose para; e) e anijeve, mjeteve lundruese, mjeteve lundruese me jastëk ajri, avionëve; f) e energjisë elektrike. Po ashtu, kjo Konventë nuk zbatohet për kontratat në të cilat pjesa mbizotëruese e detyrimeve të palës e cila furnizon me mallra, konsiston në furnizim të punës apo të shërbimeve të tjera.<sup>23</sup> Zbatimi i rregullave të kësaj Konvente për shitjet ndërkombëtare të mallrave është i një rëndësie të veçantë edhe për të drejtën ndërkombëtare private (pjesa ekonomike) për shkak të rolit të unifikues.<sup>24</sup>

---

<http://www.unidroit.org/english/publications/review/articles/2011-3/589-612-broedermann.pdf>

<sup>19</sup> Article 14 of Applicable Rules of Law, International Trade Centre UNCTAD/WTO International commercial sale of perishable goods: model contract and users' guide Geneva: ITC, 1999.

<sup>20</sup> Honnold, J., *Uniform Law for International Sales under the 1980 United Nations Convention*, pg. 30, Kluwer Law International, 3rd Edition, 1999.

<sup>21</sup> Article 1 of CISG.

<sup>22</sup> Schlecht, P., *Commentary on the UN Convention on the International Sale of Goods (CISG)*, pg. 14, Oxford 1998.

<sup>23</sup> Article 2, 3 (2) CISG.

<sup>24</sup> Buro, D., & MuirVat, H., *E drejta ndërkombëtare private – Pjesa e Posaçme*, fq. 351, Vëllimi 2, Paris 2007.

### 3. ROLI I PARIMEVE TË UNIDROIT SI MJET PËR INTERPRETIMIN E CISG

Ështëfakt i pranuar ndërkombëtarisht se që të dy këto dokumente, pra Parimet e UNIDROIT për kontratat komerciale ndërkombëtare dhe CISG-u përbëjnë dy bazamentet kryesore të pikënisjes së komunitetit ndërkombëtar për harmonizimin dhe modernizimin e të drejtës kontraktuese ndërkombëtare.<sup>25</sup> Madje, Parimet e UNIDROIT shpeshherë konsiderohen si ‘pjesa e përgjithshme’ e obligimeve kontraktuese<sup>26</sup> dhe të drejtës kontraktuese në tërësi.

Deri në nxjerrjen e Parimeve të UNIDROIT dhe për shkak të mungesës së njëte drejthe të tillë, tradicionalisht, e drejta ndërkombëtare kontraktuese uniforme ishte interpretuar dhe plotësuar mbi bazë parimeve dhe kriterëve të së drejtës së brendshme të aplikuar sipas rregullave të së drejtës ndërkombëtare private.<sup>27</sup> Ndërsa, kur është fjala për CISG-un, është paraparë që për interpretimin e saj, për shkak të karakterit ndërkombëtar vëmendje duhet t’i kushtohet standardeve të zbatuara dhe respektuara në mirëbesim në tregtinë ndërkombëtare dhe parimeve të përgjithshme. Ndërsa, vetëm në mungesë të këtyre parimeve të përgjithshme mbi të cilat bazohet kjo konventë, do të mund vije në shprehje zbatimi i ndonjë ‘e drejtë’ tjetër sipas rregullave të së drejtës ndërkombëtare private.<sup>28</sup>

Kur analizohet neni 7 i CISG, atëherë rrjedh se për interpretimin e CISG duhet të zbatohet një e drejt apo rregull i cili duhet t’i plotësoj tri elemente thelbësore, e që janë – karakteri i përgjithshëm apo parim i përgjithshëm ndërkombëtar; i pranuar dhe aplikuar nga të gjithë; dhe respektimi i parimit të mirëbesimit.<sup>29</sup> Duke e pasur parasysh këtë, lind pyetja se, kush do të mund ta luante këtë rol më mire se rregullat dhe parimet e UNIDROIT, sqarimet dhe komentimet e përfshira në këtë dokument, të cilat jo vetëm që mund të ndihmojnë në interpretimin e CISG, por këto dokumente mund edhe të

<sup>25</sup> Dennis, M., *The Guiding Role of the CISG and the Unidroit Principles in Harmonising International Contract Law*, pg.19, International Trade/ADR in the South Pacific, February 2013, (last seen: February 2015).

<http://www.victoria.ac.nz/law/nzacl/PDFS/SPECIAL%20ISSUES/HORS%20SERIE%20VOL%20XVII/04%20Dennis.pdf>

<sup>26</sup> Kronke, H., *The UN Sales Convention, the Unidroit Contract Principles and the Way Beyond*, Journal Of Law And Commerce [Vol. 25:451], pg. 456, University of Heidelberg, <http://www.uncitral.org/pdf/english/CISG25/Kronke.pdf>

<sup>27</sup> Rule no. 5 of UNIDROIT Principles, pg. 5. <http://www.unidroit.org/instruments/commercial-contracts/unidroit-principles-2010>

<sup>28</sup> Article 7 CISG.

<sup>29</sup> Schlecht, P., *Commentary on the UN Convention on the International Sale of Goods (CISG)*, pg. 61, Oxford 1998.



ndërplotësojnë njëra tjetrën.<sup>30</sup> Përkundër qëllimit të njëjtë të këtyre dy akteve juridike dhe ngjajshmerisë në shumë aspekte dhe dispozita, mund të nxjerren edhe disa dallime kryesore në mes tyre. Këto dallime konsistojnë në lidhje me sferën e aplikimit, për shkak se CISG kërkon qëpalët të kenëvendet e biznesit dhe shtetete ndryshme, ndërsa Parimet e UNIDROIT jo. Pastaj dallimet në lidhje me natyrën e këtyre akteve, derisa CISG ka karakter juridik të Konventës, Parimet e UNIDROIT jo, si dhe dallimet në kohë në mes këtyre dy dokumenteve.<sup>31</sup>

Nga ana tjetër, pa anashkaluar faktin se CISG përbën një hap kyç në unifikimin e drejtës kontraktuese, është më se evident edhe fakti apo problemi i ‘unifikimit’ të mjeteve të interpretimit, sepse edhe CISG-u përkundërsuksesit të treguar në shumë sfera, i ka edhe mungesat e veta, dhesikurse edhe aktet tjera, kanevojë për interpretim dhe plotësim të zbrazëtirave, sepse në rast se përdorët si mjet i interpretimit drejtat e brendshme e vendeve të ndryshme, atëherë do të zbehet roli unifikues i vet CISG-ut. Kështu që, me qëllim të evitimit të rrezikut të interpretimeve divergjente sipas të drejtave të ndryshme të vendeve, në një tekst të njëjtte, atëherë duhet që instrumentet për interpretim të jenë tëkarakterit unifikues.<sup>32</sup>

#### 4. DISA RASTET TË ZBRAZËTIRAVE TË CISG - INTERPRETIMI DHE PLOTËSIMI

CISG-u përbushë qëllimin e vet, nëse interpretohet në mënyrë konsistente në të gjitha sistemet ligjore, në njërën anë, dhe anën tjetër, nëse nuk i referohetvetëm ndonjë sistemi juridik në veçanti.<sup>33</sup> Megjithatë, mosmarrëveshjet mund të lindin në lidhje me kuptimin dhe zbatimin e saj. Nëse kjo ndodh, të gjitha palët duke përfshirë gjykatat e brendshme dhe

<sup>30</sup> Bonell, J.M., *The CISG and the Unidroit principals of International Commercial Contracts: Two Complementary Instruments*, pg. 101, International Law Review of Wuhan University 2008 – 2009,

<http://cisgw3.law.pace.edu/cisg/biblio/bonell1.pdf>

<sup>31</sup> Carvalhal S. L., *Gap-Filling in the CISG: May the Unidroit Principles Supplement the Gaps in the Convention?*, Nordic Journal of Commercial Law 2006 no 1, pg. 8-9. [http://www.njcl.fi/1\\_2006/article2.pdf](http://www.njcl.fi/1_2006/article2.pdf)

<sup>32</sup> Ferrari, F., *Gap-Filling and Interpretation of the CISG: Overview of International Case Law*, pg. 63, *Vindobona Journal of International Commercial Law & Arbitration* (2003). <http://www.cisg.law.pace.edu/cisg/biblio/ferrari11.html#a1> last seen: February 2015).

<sup>33</sup> Michaels, R., *The UNIDROIT Principles as Global Background Law*, Uniform Law Review (2014), Duke University, pg. 23. [http://scholarship.law.duke.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=6058&context=faculty\\_scholarship](http://scholarship.law.duke.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=6058&context=faculty_scholarship)

gjykatat e arbitrazhit, duhet të zgjidhin mosmarrëveshjet duke marr parasysh nenin 7 të CISG, pra karakterin ndërkombëtare të rregullave qënxisin uniformitetin në zbatimin e saj dhe respektimin e mirëbesimit në tregtinë ndërkombëtare. Veçanërisht, nëse një element në lidhje me një çështje të caktuar të rregulluar nga kjo Konventë nuk zgjidhet shprehimisht në të, atëherëçështja duhet të zgjidhet në pajtim me parimet e përgjithshme mbi të cilat bazohet Konventa. Vetëm në mungesë të këtyre parimeve çështja duhet të zgjidhet në pajtim me ligjin e zbatueshëm në bazë të rregullave të së drejtës private ndërkombëtare.<sup>34</sup>

Me qellim të shtjellimit sa më të hollësishëm të zbrazëtirave të CISG, disa autorë kanë bërë ndarjen e këtyre zbrazëtirave në dy ‘lloje’: ato të natyrës së jashtme (“*external gaps*”) dhe ato të natyrës së brendshme (“*internal gaps*”).<sup>35</sup>Zbrazëtitrat të natyrës së jashtme konsiderohen ato çështje të cilat bien jashtë domenit të CISG që do të thotë për çështjet të cilat nuk i rregullon apo për kontratat të cilat fillimisht nuk i përkasin marrëdhënies së shitblerjes por të cilat më vonë mund të fitojnë këtë cilësi ose e kundërta.<sup>36</sup>Po ashtu, si të tilla konsiderohen edhe çështjet të cilat CISG nuk parasheh apo është e qetë në ato çështje (siç është rasti i zgjidhjes së të drejtës nga palët), si dhe zbrazëtitrat të cilat dalin jashtë fushëveprimit të CISG dhe të cilat nuk mund të interpretohen sipas kritereve të nenit 7 të saj.<sup>37</sup>Ndërsa, zbrazëtitrat e natyrës së brendshme janë ato çështje për të cilat CISG aplikohet apo i parasheh por të cilat nuk i zgjidh shprehimisht. Këto zbrazëtira kanë nevojë të plotësohen meparimet e përgjithshme ndërkombëtare, të pranuar nga kjo Konventë, dhe

---

<sup>34</sup> UNCITRAL, *Explanatory Note on the United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods*, United Nations Publication 2010, pg. 36, <http://www.uncitral.org/pdf/english/texts/sales/cisg/V1056997-CISG-e-book.pdf> (last seen: February 2015).

<sup>35</sup> Zeller, B., *The Methodology for Interpretation and Application of the UN Convention on Contracts for the International Sale of Goods*, Pace Law School Institute of International Commercial Law, Chapter 5, May 2003.

<http://www.cisg.law.pace.edu/cisg/biblio/4corners.html>; Also: Buga, I., *Taking the International Approach to the CISG: The Gap-Filling Role of the UNIDROIT Principles and the Principles of European Contract Law*, pg. 9, Utrecht University 2010.

<http://dspace.library.uu.nl/bitstream/handle/1874/238503/Buga+Taking+the+international+a+pproach+to+the+cisg+2010.pdf?sequence=1>.

<sup>36</sup> Article 3,4,5 of CISG.

<sup>37</sup> Buga, I., *Taking the International Approach to the CISG: The Gap-Filling Role of the UNIDROIT Principles and the Principles of European Contract Law*, pg. 9, Utrecht University 2010.

<http://dspace.library.uu.nl/bitstream/handle/1874/238503/Buga+Taking+the+international+a+pproach+to+the+cisg+2010.pdf?sequence=1>.

parimi i mirëbesimit.<sup>38</sup> Mbi këtë bazë, është me rëndësi të referohemi tek disa situata konkret të cilat i parashih CISG, të cilat kanë nevojë për interpretim, dhe për interpretimin e të cilave do mund të aplikoheshin Parimet e UNIDROIT së bashku me komentet dhe rregullat për përdorimin tyre.

#### 4.1 Çështja lidhur me ‘parimin e mirëbesimit’ në CISG

Parmi i mirëbesimit si parim fundamental në marrëdhëniet e detyrimeve të çdo vendi, ka tërhequr vëmendje të veçantetëstuduesvetë kësaj fushe gjatë procesit të interpretimit të CISG. Kjo për faktin se, CISG parimin e mirëbesimit e përmend vetëm në nenin 7, i cili bënë fjalë për interpretimin e Konventës, ndërsa jo edhe tek pjesa e të drejtave dhe detyrimeve të palëve gjatë përmbushjes së kontratës. Si i tillë ky fakt është konsideruar si rast unik i CISG, në krahasim me aktet e tjera të cilat rregullojnë marrëdhëniet kontraktuese, sa i përket relacionit me parimin e mirëbesimit. Dilemat ngritën në rrafshin se, a duhet të aplikohet ky parim edhe në pjesët e tjera të Konventës apo vetëm gjatë procesit të interpretimit të saj, apo me fjalë të tjera, a i përshkon ky parim të gjitha dispozitat e konventës apo vetëm atë të nenit 7, si mjet i interpretimit.

Për dallim nga CISG, Parimet e UNIDROIT përfshinë një rreth të gjerë të aplikimit të parimit të mirëbesimit. Sipas Parimeve të UNIDROIT, është paraparë që secila palë në tregtinë ndërkombëtare duhet të veprojë në pajtim me parimin e mirëbesimit dhe drejtëshmërisë, por jo vetëm kaq, ekzistojnë edhe dhjetëra dispozita të cilat kërkojnë direkt apo indirekt zbatimin e parimit të mirëbesimit dhe drejtëshmërisë.<sup>39</sup> Po ashtu, edhe legjislacionet e brendshme të vendeve të ndryshme imponojnë dhe kërkojnë një aplikim me të gjerë të parimit të mirëbesimit, sesa ai që parashih CISG në nenin 7.<sup>40</sup> Megjithatë, duke pasur parasysh qëllimin e CISG, më pastaj edhe Parimet e

<sup>38</sup> Zeller, B., *The Methodology for Interpretation and Application of the UN Convention on Contracts for the International Sale of Goods*, Pace Law School Institute of International Commercial Law, Chapter 5.1, May 2003.

<http://www.cisg.law.pace.edu/cisg/biblio/4corners.html>; (last seen: February 2015).

<sup>39</sup> Article 1.7 (1) of UNIDROIT Principles. There are a number of provisions in different chapters in UNIDROIT Principles which provided application of the principle of good faith and fair dealing, starting by article 1.7 (1); 1.8; 1.9(2); 2.1.4(2)(b), 2.1.15, 2.1.16, 2.1.18 and 2.1.20; 2.2.4(2), 2.2.5(2), 2.2.7; 2.2.10; 3.2.2, 3.2.5; 3.2.7; 4.1(2), 4.2(2), 4.6; 4.8; 5.1.2; 5.1.3; 5.2.5; 5.3.3; 5.3.4; 6.1.3, 6.1.5, 6.1.16(2); 6.1.17(1); 6.2.3(3)(4); 7.1.2, 7.1.6; 7.1.7; 7.2.2(b)(c); 7.4.8; 7.4.13; 9.1.3, 9.1.4; 9.1.10(1). This means that the ‘good faith and fair dealing’ are the fundamental principle of UNIDROIT Principles.

<sup>40</sup> Honnold, J., *Uniform Law for International Sales under the 1980 United Nations Convention*, pg. 99-100, Kluwer Law International, 3rd Edition, 1999.

UNIDROIT si ndihmese të interpretimit të CISG, si dhe legjislacionet e vendeve të ndryshme të cilat apriori proklamojnë këtë parim si fundamental, rrjedh se ky parim vazhdimisht, edhe pse jo në mënyrëshprehimore, qëndron i lidhur me aspekte të ndryshme të zbatimit të CISG. Me fjalë të tjera, gjykatat dhe tribunalet gjatë interpretimit dhe zbatimit të CISG, parimin e mirëbesimit gjithnjë duhet ta kenë në mendje. Është e qartë se ky parim tek disa dispozita mund të ketë efekt më rigoroz tek disa më pak apo fare siç është rasti tek dispozita e nenit 1të CISG (fusha e zbatimit)ku parimi i mirëbesimit nuk mund të vijë në zbatim.<sup>41</sup>Përndryshe, aplikimi i këtij parimi assesi nuk guxon të vihet në pikëpyetje

#### 4.2 Çështja lidhur me ‘vlefshmërinë e kontratës’ në CISG

Sa i përket çështjes së lidhjes të ‘kontratës’, nga dispozitat e CISG-ut shihet se është e rregulluar vetëm instituti i formimit të kontratës së shitjes dhe të drejtat e detyrimit e shitësit dhe blerësit që rrjedhin nga kjo kontratë dhe kjo Konventë. Ndërsa, “*kjo Konventë nuk ka të bëjë me: a) vlefshmërinë e kontratës apo të ndonjë dispozite të saj apo të çdo përdorimi;...*”<sup>42</sup>Derisa elementet e caktuara të dispozitës së nenit 4 të CISG mbeten të qarta, ajo që paraqet problem është çështja e ‘vlefshmërisë së kontratës’ për shkak se nuk parasheh kushtet kur kontrata është e pavlefshme, si rasti kur kontrata lidhet në mungesë të zotësisë juridike, shkeljeve ligjore, rendit publik, apo mungesës së kauzës.<sup>43</sup> Siç është cekur më lartë, kjo është konsideruar si zbrazëtirë e natyrës së jashtme, që do të thotë se e drejta e brendshme apo zgjedhja e ndonjë të drejte tjetër për aplikim krahas CISG-ut është nevojë e paevitueshme.<sup>44</sup> Është praktikë e ditur e legjislacioneve të te gjitha vendeve që krahas rregullimit të institutit të kontratës (lidhjes së kontratës, shuarjes së kontratës, etj.), të rregullojnë edhe vlefshmërinë e kontratës apo kushtet kur

<sup>41</sup> Zeller, B., *The Methodology for Interpretation and Application of the UN Convention on Contracts for the International Sale of Goods*, Pace Law School Institute of International Commercial Law, Chapter 4, 4 (f). May 2003.

<http://www.cisg.law.pace.edu/cisg/biblio/4corners.html>; (last seen:February2015). Also, Ferrari, F., *Gap-Filling and Interpretation of the CISG: Overview of International Case Law*, pg. 74-78, Vindobona Journal of International Commercial Law & Arbitration (2003). <http://www.cisg.law.pace.edu/cisg/biblio/ferrari11.html#a1> (last seen:February2015).

<sup>42</sup> See, Article 4 (a) of CISG.

<sup>43</sup> Schlecht, P., *Commentary on the UN Convention on the International Sale of Goods (CISG)*, pg. 43, Oxford 1998.

<sup>44</sup> Zeller, B., *The Methodology for Interpretation and Application of the UN Convention on Contracts for the International Sale of Goods*, Pace Law School Institute of International Commercial Law, Chapter 5, May 2003.

<http://www.cisg.law.pace.edu/cisg/biblio/4corners.html>;

kontrata do të ishte e pavlefshme (nule). Në këtë aspekt, Parimet e UNIDROIT jo vetëm që parashohin apo rregullojnë çështjen e ‘vlefshmërisë së kontratës’ apo kushteve nën të cilat ajo bëhet e pavlefshme (për shkak të mashtrimit, kërcënimit, pabarazinë e prestimeve dhe përmbajtjen e paligjshme), por këtyre dispozitave iu është dhënë edhe karakter detyrues (“*mandatory character of the provisions*”).<sup>45</sup> Më pastaj, në mënyrë specifike Parimet e UNIDROIT parashohin edhe dispozitat në lidhje me lajthimin në fakte dhe lajthimin në të drejtën,<sup>46</sup> duke e paraparë edhe situatat kur lajthimi është relevant për marrëdhënien kontraktuese dhe kur jo,<sup>47</sup> si dhe gabimet që mund të ndodhin në transmetimin e deklaratës apo komunikimet.<sup>48</sup> Mbi këtë bazë mund të thuhet se, palët në marrëdhëniet e tyre kontraktuese krahas CISG-ut, lirisht mund të caktojnë se, sa i përket kushteve nën të cilat kontrata mund të shpallet e pavlefshme, të aplikohen Parimet e UNIDROIT. Po ashtu palët kanë diskrecion që të zgjedhin edhe të drejtën e brendshme të shteteve apo ta caktojnë të drejtën sipas rregullave të së drejtës ndërkombëtare private.<sup>49</sup>

### 4.3 Çështja lidhur me përgjegjësinë e shitësit për produktet sipas CISG

Një çështje tjetër e cila është konsideruar si zbrazëtirë e CISG-ut, është edhe çështja e përgjegjësisë së shitësit për vdekjen ose dëmtimet personale ndaj personave të tjerë të shkaktuara nga mallrat. Problemi konsiston në atë se palët mund të merren vesh që për marrëdhënien e tyre kontraktuale të aplikohet CISG-upër shumë aspekte, por kur bëhet fjalë për dëmin nga mallrat, atëherë ato nuk mund të kërkojnë zgjidhje absolutisht tek CISG-u.<sup>50</sup> Kjo konventë shprehimisht parasheh se nuk zbatohet për përgjegjësinë e shitësit për vdekjen ose dëmtimet personale të shkaktuara nga mallrat ndaj çdo personi.<sup>51</sup> Kjo zbrazëtirë hynë në kategorinë e ashtuquajtur të zbrazëtirave të natyrës së jashtme. Kjo dispozitë, veçanërisht togfjalëshi ‘dëmet e shkaktuara nga mallrat’ njih disa kufizime. Kështu për shembull, nëse shitësi gjatë bartjes së mallrave apo produkteve me mjete transportuese,

<sup>45</sup> Article 3.1.4 of UNIDROIT Principles.

<sup>46</sup> Article 3.2.1 of UNIDROIT Principles.

<sup>47</sup> Article 3.2.2 of UNIDROIT Principles.

<sup>48</sup> Article 3.2.3 of UNIDROIT Principles.

<sup>49</sup> Ferrari, F., *Gap-Filling and Interpretation of the CISG: Overview of International Case Law*, pg. 79, *Vindobona Journal of International Commercial Law & Arbitration* (2003).  
<http://www.cisg.law.pace.edu/cisg/biblio/ferrari11.html#a1> (last seen: February 2015).

<sup>50</sup> Honnold, J., *Uniform Law for International Sales under the 1980 United Nations Convention*, pg. 71, Kluwer Law International, 3rd Edition, 1999.

<sup>51</sup> See, article 5 of CISG.

shkakton ndonjë dëm atëherë kjo shkelje për shkak të mos kujdesit të duhur nuk bie nën fushëveprimin e nenit 5 të CISG.<sup>52</sup> CISG-u përmban një kapitull që bënë fjalë për ‘dëmet’,<sup>53</sup> por, duhet të kemi parasysh se, dispozitat e këtij kapitulli i referohen dëmeve nga shkelja e kontratës për shitje të mallrave dhe jo nga humbjet e shkaktuara nga mallrat.<sup>54</sup> Me këtë përcaktim CISG synon të mos dal prej fushëveprimit dhe qëllimit të saj për rregullimin e shitjeve ndërkombëtare, sepse konsiderohet se dëmet nga mallrat, futën në kategorinë e kompensimeve që rrjedhin nga një kategori e veçantë e burimit të detyrimeve e që është ‘shkaktimi i dëmit’ dhe jo kontrata për shitje.<sup>55</sup> Po ashtu, nuk duhet të krijohet konfuzitet sa i përket detyrimevetë shitësit në lidhje me cilësinë e mallrave. Sipas CISG shitësi duhet të dorëzojë mallrat që kanë sasinë, cilësinë dhepërshkrimin e kërkuar nga kontrata dhe që gjenden ose janë paketuar në mënyrën e kërkuar nga kontrata. Një i varg i dispozitave rregullash të rëndësishme së veçantë në shitjet ndërkombëtare të mallrave përfshin detyrimin e shitësit për të dorëzuar mallra që janë të lira nga çdo pretendimose e drejtë e një pale të tretë, duke përfshirë të drejtat e bazuara në pronësinë industriale dhe pronësi tjetër intelektuale.<sup>56</sup> Megjithatë, fakti mbetet se për çështjen e përgjegjësisë së shitësit për vdekjen ose dëmtimet personale të shkaktuara nga mallrat ndaj personave të tjerë, duhet të aplikohet e drejta e brendshme,<sup>57</sup> ose e drejta tjetër për të cilën palët merren veshë ose e drejta e cila parashihet sipas rregullave të së drejtës ndërkombëtare private.<sup>58</sup>

Në këtë drejtim, e drejtëe karakterit ndërkombëtare dhe unifikuese e cila mund të vije në shprehje është rregullative e cila parashihet në Parimet e UNIDROIT për kontratat ndërkombëtare komerciale, e cila në mënyrë të

---

<sup>52</sup> Schlecht, P., *Commentary on the UN Convention on the International Sale of Goods (CISG)*, pg. 50, Oxford 1998.

<sup>53</sup> Article 74 CISG.

<sup>54</sup> Schlecht, P., *Commentary on the UN Convention on the International Sale of Goods (CISG)*, pg. 557, Oxford 1998.

<sup>55</sup> Honnold, J., *Uniform Law for International Sales under the 1980 United Nations Convention*, pg. 73, Kluwer Law International, 3rd Edition, 1999.

<sup>56</sup> UNCITRAL, *Explanatory Note on the United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods*, United Nations Publication 2010, pg. 38, <http://www.uncitral.org/pdf/english/texts/sales/cisg/V1056997-CISG-e-book.pdf> (last seen: February 2015).

<sup>57</sup> *Ibid* pg. 50.

<sup>58</sup> Ferrari, F., *Gap-Filling and Interpretation of the CISG: Overview of International Case Law*, pg. 79, *Vindobona Journal of International Commercial Law & Arbitration* (2003). <http://www.cisg.law.pace.edu/cisg/biblio/ferrari11.html#a1> (last seen: February 2015).

kënaqshme e përfshinë këtë problematikë.<sup>59</sup> Parimet e UNIDROIT në kapitull të veçantë bënë fjalë për përgjegjësinë në lidhje me riparimin, zëvendësimin dhe kujdesin për të gjitha të metat e tjera të mallit apo produktit që është objekt i përmbushjes së kontratës.<sup>60</sup> Sipas këtyre parimeve, 'riparimi' dhe 'zëvendësimi' i mallit janë dy elemente kryesore karakteristike të kësaj dispozitënë veçanti, të cilat mund të kërkojnë nga pala kontraktuese, por pa e përjashtuar edhe kujdesin për to, por edhe për të metat e tjera të mallit.<sup>61</sup> Rastin e shkaktimit të dëmit nga malli apo produkti me të metat cili ka qenë objekt i kontratës, Parime e UNIDROIT e adresojnë duke u referuar për aplikim të drejta e brendshme e palëve, e cila parasheh hulumtimin, konstatimin dhe vërtetimin e dëmit dhe lartësisë së tij.<sup>62</sup>

#### 4.4 Problematika në lidhje me interpretimin e nenit 8 të CISG

Sipas nenit 8 të CISG është përcaktuar që për qëllime të kësaj Konvente deklarimet e bëra ose veprimi tjetër i një pale duhet të interpretohen:

- sipas qëllimit të tij, kur pala tjetër e dinte ose nuk mund të mos kishte dijeni se kush ishte qëllimi;
- në qoftë se sipas qëllimit nuk është i zbatueshëm, deklarimet e bëra dhe veprimi tjetër i një pale duhet të interpretohen në përputhje me mirëkuptimin që një person i arsyeshëm i të njëjtit lloj si pala tjetër do të kishte në të njëjtat rrethana;
- në përcaktimin e qëllimit të një pale ose të mirëkuptimit që një person i arsyeshëm do të kishte, konsideratë e duhur duhet t'u jepet gjithë rrethanave përkatëse të çështjes duke përfshirë negociatat, çdo praktikë të cilën palët kanë vendosur ndërmjet tyre, përdorimet ose çdo veprim vijues të palëve.

Duke u bazuar në këtë dispozitë, interpretimi i deklarimeve ose veprimeve të bëra në marrëdhënien kontraktuese (negociatat dhe çdo praktikë të cilën palët kanë vendosur ndërmjet tyre) duhet të bëhet sipas 'qëllimit' të tyre, nëse nuk dihet qëllimi atëherë ato duhet të interpretohen sipas 'mirëkuptimit' që një person i arsyeshëm do të kishte. Siç shihet, si elemente bazë për interpretim

---

<sup>59</sup> Gotanda, Y. J., *Using the Unidroit Principles to Fill Gaps in the CISG*, pg.11, School of Law Working Paper Series, Villanova University School of Law, Paper No.88/2007. <http://digitalcommons.law.villanova.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1089&context=wps>

<sup>60</sup> Article 7.2.3 UNIDROIT Principles.

<sup>61</sup> Comment 2 for Article 7.2.3 of UNIDROIT Principles pg. 244.

<sup>62</sup> Comment 3 (Illustration 4) regarding article 10.1 of UNIDROIT Principles, pg. 346.

janë qëllimi dhe mirëkuptimi, të cilat në esencë paraqesin elemente ‘subjektive’ dhe normalisht krijojnë hapësire të gjerë kuptimi dhe interpretimi. Aq më tepër kur merret parasysh fakti se në kuadër të ‘deklarimeveose veprimeve’ të bëra në marrëdhënien kontraktuese sipas nenit 8 të CISG përfshihet edhe procesi i hartimit të kontratës, përmbushja dhe prishja e kontratës.<sup>63</sup> Problemi në lidhje me këtë dispozitë konsiston në atë se mungojnë elementet ‘objektive’ sipas të cilave do të mund të bëhej interpretimi i deklarimeveose veprimeve në marrëdhënien kontraktuese.

Padyshim në rast të tillë si pikë e parë për referimin e kësaj problematike duhet të shërbejnë Parimet e UNIDROIT, aq më tepër kur në CISG përmenden disa nocione abstrakte si për shembull ‘person i arsyeshëm’, qëllimi i palëve apo mirëkuptimi.<sup>64</sup> Në fakt edhe Parimet e UNIDROIT përmbajnë një përcaktim të ngjashëm<sup>65</sup> sikurse CISG sa i përket elementeve subjektive, mirëpo, dallimi është se menjëherë pas dispozitave në lidhje me elementet subjektive, janë paraqitur edhe disa rrethana relevante ‘objektive’ madje të përcjella me komente, në bazë të të cilave do të mund të interpretoheshin termët standarde me karakter subjektiv. Si të tilla janë paraparë: a) negociatat paraprake ndërmjet palëve kontraktuese; b) praktikat të cilat palët i kanë krijuar ndërmjet vete; c) sjellja pasuese e palëve me qëllim të përfundimit të kontratës; d) natyra dhe qëllimi i kontratës; e) kuptimet e përgjithshme të dhëna për termet dhe shprehjet në fushën e tregtisë relevante; f) zakonet.<sup>66</sup> Pa anashkaluar edhe rrethanat e tjera të cilat

---

<sup>63</sup> Buga, I., *Taking the International Approach to the CISG: The Gap-Filling Role of the UNIDROIT Principles and the Principles of European Contract Law*, pg. 10, Utrecht University 2010.

<http://dspace.library.uu.nl/bitstream/handle/1874/238503/Buga+Taking+the+international+approach+to+the+cisg+2010.pdf?sequence=1> . See also the decisions:

Oberster Gerichtshof [Austrian Supreme Court], 24 April 1997, 2 Ob 109/97m, *Processing Plant Case*, available at <http://cisgw3.law.pace.edu/cases/970424a3.html> .

OLG Frankfurt a. M. [Appellate Court Frankfurt], 30 August 2000, 9 U 13/00, *Yarn Case*, available at <http://cisgw3.law.pace.edu/cases/000830g1.html> .

OLG Koblenz [Appellate Court Koblenz], 31 January 1997, 2 U 31/96, *Acrylic Blankets Case*,

available at <http://cisgw3.law.pace.edu/cases/970131g1.html> .

<sup>64</sup>M. Perillo, J., *Editorial remarks on the manner in which the UNIDROIT Principles may be used to interpret or supplement CISG Article 8*, Pace Law School Institute of International Commercial Law, (a).

<http://www.cisg.law.pace.edu/cisg/principles/uni8.html>

<sup>65</sup>Article 4.1, 4.2 of UNIDROIT Principles.

<sup>66</sup>Article 4.3 of UNIDROIT Principles.



janë të përbujtura në nenet 4.4 – 4.8 të Parimeve të UNIDROIT<sup>67</sup> dhe të cilat i mungojnë CISG-ut.

#### 4.5 Problematika në lidhje me interpretimin e nenit 25 të CISG

Neni 25 i CISG bënë fjalë në lidhje me atë se çka konsiderohet ‘shkelje themelore apo fundamentale’ e një kontrate ndërkombëtare për shitjen e mallrave. Kjo dispozitë përcakton se, ‘një shkelje e kontratës e kryer nga njëra prej palëve është themelore, në qoftë se rezulton në dëm të palës tjetër kryesisht atë sa ta privojë atë nga çfarë ajo ka të drejtë të presë sipas kontratës, përveç kur pala në shkelje nuk e parashikoi dhe një person i arsyeshëm i të njëjtit lloj në të njëjtat rrethana nuk do ta kishte parashikuar një rezultat të tillë’.<sup>68</sup>

Nëse analizohet në tërësi CISG-u, pra nenet dhe dispozitat e saj, mund të nxirren disa raste specifike të shkeljeve themelore. Për shembull, nga ana e shitësit shkelje themelore përbëjnë, dështimi i dërgimit të mallit për shkak të pamundësisë objektive apo subjektive, vonesat e dërgimit të mallit në tërësi dhejo në pajtim me afatete përcaktuara, si dhe dështimi i dërgimit të mallit sipas specifikave të përcaktuara më kontratë (defektet). Ndërsa, nga ana e blerësit, vonesat në kryerjen e pagesave, dështimi të pranoj mallrat, si dhe obligimet sekondare si sigurimi i lejeve të duhura, certifikatave të përdorimit, markave tregtare dhe dokumente të tjera që lidhen me objektin e kontratës e që duhet t’i siguroj blerësi.<sup>69</sup>

Në mënyrë më specifike mund të thuhet se në kuadër të detyrimevetë përgjithshme të shitësit është edhe dorëzimi i çdo dokumenti që ka të bëjë me mallrat dhe transferimin e pronësisë mbi mallrat, siç kërkohet nga kontrata dhe CISG. Konventa përmban rregulla shtesë për tu zbatuar në mungesë të

---

<sup>67</sup>Article 4.4 of UNIDROIT Principles provide that the terms and expressions shall be interpreted in the light of the whole contract or statement in which they appear. Article 4.5 provide that contract terms shall interpreted so as to give effect and in function of contract. Article 4.6 provide the rule of ‘*contra proferentem rule*’ which mean that if contract terms supplied by one party are unclear, an interpretation against that party is preferred. Article 4.7 provide the interpretation in the case of linguistic discrepancies. Article 4.8 provide that if the parties to a contract have not agreed with respect to a term which is important for determination of their duties, a term which is appropriate in the circumstances shall be supplied.

<sup>68</sup>Article 25 of CISG.

<sup>69</sup> Schlecht, P., *Commentary on the UN Convention on the International Sale of Goods (CISG)*, pg. 182-185, Oxford 1998.

marrëveshjes kontraktuale, në lidhje me atë se kur, ku dhe si shitësi duhet të përmbushë këto detyrime. Një vargrrregullash të rëndësisë së veçantë në shitjet ndërkombëtare të mallrave, përfshijnë detyrimin e shitësit për të dorëzuar mallra që janë të lira nga çdo pretendim ose e drejtë e një pale të tretë, duke përfshirë të drejtat e bazuara në pronësinë industriale apo pronësi tjetër intelektuale. Ndërsa, detyrimet e blerësit në krahasim me detyrimet e shitësit janë më të përmbledhura dhe relativisht të thjeshta, ku përveç pagesës së çmimit dhe pranimit të furnizimit, janë përfshirë rregulla edhe disa rregulla shtesë për t'u zbatuar në mungesë të marrëveshjes kontraktuale, për mënyrën se si caktohet çmimi dhe ku dhe kur blerësi duhet të përmbushë detyrimin të paguajë çmimin.<sup>70</sup>

Megjithëkëtë, problemi në lidhje me nenin 25 të CISG është pjesa e dispozitës e cilapërmban standard abstrakt që *'një person i arsyeshëm i të njëjtit lloj në të njëjtat rrethana nuk do ta kishte parashikuar një rezultat të tillë'*.

Në lidhje me këtë, Parimet e UNIDROIT janë më të detajuara dhe përcaktojnë disa faktor të cilët e determinojnë shkeljen si fundamentale dhe mund të vijën në ndihmë CISG-ut.<sup>71</sup> Sipas nenit 7.3.1 (2) të Parimeve të UNIDROIT, parashihet se si rrethana të cilat determinojnë shkeljen themelore në performancën e kontraktuese, në veçanti janë kur: a) mospërmbushja substancialisht e privon palën e dëmtuar që marr apo të pranoj atë që është dashur t'a pranoj sipas kontratës, përveç nëse pala nuk ka parashikuar apo nuk ka mundur të parashikoj pasojat; b) përmbushja e kërkuar e cila nuk është bërë, ka qenë pjesë esenciale e kontratës; c) mospërmbushja është e qëllimshme apo nga pakujdesia; d) mospërmbushja i jep arsye palës së dëmtuar që të besoj se nuk mund të mbështet tek pala tjetër për performancën në të ardhmen; e) pala ndaj të cilës nuk është përmbushur kontrata, do të përjetoj dëm disproporcional nga prishja e kontratës.<sup>72</sup>

---

<sup>70</sup> UNCITRAL, *Explanatory Note on the United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods*, United Nations Publication 2010, pg. 38, <http://www.uncitral.org/pdf/english/texts/sales/cisg/V1056997-CISG-e-book.pdf> (last seen: February 2015).

<sup>71</sup> Bonell, J.M., *The CISG and the Unidroit principals of International Commercial Contracts: Two Complementary Instruments*, pg. 110, International Law Review of Wuhan University 2008 – 2009, <http://cisgw3.law.pace.edu/cisg/biblio/bonell1.pdf>

<sup>72</sup> Comment 3 for Article 7.3.1 (2) of UNIDROIT Principles, pg. 250-253.

## 5. RASTET E TJERA TË ZBRAZËTIRAVE TË CISG DHE PLOTËSIMI I TYRE

Shumë autor të cilët janë marrë me studimin e CISG dhe Parimet e UNIDROIT për kontratat komerciale ndërkombëtare, e disa prej tyre edhe pjesëmarrës në hartimin ekëtyre të fundit, kanë vërejtur edhe një varg hapësirash në kuadër të CISG të cilat kanë nevojë për plotësim dhe interpretim, qoftë duke i përdorur Parime të UNIDROIT apo qoftë duke e përdorur edhe ndonjë të drejtë tjetër. Kështu, sipas profesorit Bonell<sup>73</sup>, ndër të tjera, vlen të përmendet nëni 7.1.4 (2) i Parimeve të UNIDROIT që parasheh se e drejta për evitimin e mospërbushjes nuk mund të përjashtohet nga njoftimi për përfundim të kontratës, dhe i cili mund të përdoret në rastin e nenit 48 të CISG; apo rasti nga nëni 7.1.7 (4) i Parimeve të UNIDROIT që shprehimisht tregon se mjetet juridike për përfundimin e kontratës nuk mund të afektohen nga ngjarjet apo dukuritë të cilat kanë mundur ta pengojnë palën në përbushjen e kontratës, e i cili rregull mund të përdoret në rastin në lidhje me nënin 79 (5) të CISG-ut.<sup>74</sup>

Sipas një autori tjetër dispozitat e Parimeve të UNIDROIT në lidhje me dëmet janë krahasueshëm me të avancuara se ato të CISG. Edhe pse CISG në nënin 74 vendos katër baza kyçe për riparimin apo kompensimin e dëmit, kjo konventë nuk përmban ndonjë ‘udhëzim’ specifik për përlllogaritjen e tij, krahasuar me dispozitat e Parimeve të UNIDROIT, konkretisht nën 7.4.1, 7.4.2 dhe 7.4.4.<sup>75</sup>

Një çështje tjetër paraqet edhe rastii ‘llogaritjes së interesit’, i cili përmendet në CISG,<sup>76</sup> mirëpo, i cili nuk është i rregulluar dhe nuk specifikohet mënyra e llogaritjes së interesit. Përderisa, nëni 7.4.9 i Parimeve të UNIDROIT, parasheh kohën prej kur duhet të fillon llogaritja dhe po ashtu llogaritjen prej sa duhet të llogaritet.<sup>77</sup> Më pastaj, nën 6.1.7, 6.1.8 dhe 6.1.9 të Parimeve të

---

<sup>73</sup>Chairmen of the Working Group for drafting of UNIDROIT Principles and Professor at the Rome University.

<sup>74</sup> Bonell, J.M., *The CISG and the Unidroit principals of International Commercial Contracts: Two Complementary Instruments*, pg. 110, International Law Review of Wuhan University 2008 – 2009,

<http://cisgw3.law.pace.edu/cisg/biblio/bonell1.pdf>

<sup>75</sup>Gotanda, Y. J., *Using the Unidroit Principles to Fill Gaps in the CISG*, pg.8-10, School of Law Working Paper Series, Villanova University School of Law, Paper No.88/2007.

<http://digitalcommons.law.villanova.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1089&context=wps>

<sup>76</sup>Article 78 of CISG.

<sup>77</sup> Michaels, R., *The UNIDROIT Principles as Global Background Law*, Uniform Law Review (2014), Duke University, pg. 24.

UNIDROIT mund të japin përgjigje në disa çështje në lidhje me pagesat përmes çeqeve apo letrave tjera, të cilat nuk janë paraparë në mënyrë shprehimore në CISG. Ose nëse po, atëherë në çfarë kushte blerësi mund të bëjë pagesa përmes çekut apo instrumenteve të ngjashme, apo letër transferëve dhe në cilën valutë monetare duhet të bëhen ato. Një nga parimet e akceptuar nga CISG është parimi i ‘arsyeshmërisë’ sipas të cilit palët duhet të veprojnë në mënyrë të arsyeshme, më këtë rast kjo çështje qartë kërkon të nënvizohet rregulla e nenit 6.1.7 të Parimeve të UNIDROIT, sipas të cilës i detyruari mund të paguaj në çfarëdo forme e aplikueshme në kursin e rregullt të biznesit që përdorët në vendin e pagesës.<sup>78</sup>

## 6. PËRFUNDIM

Nga shqyrtimet e trajtuara e më lartë, rrjedh se CISG-u dhe Parimet e UNIDROIT paraqesin dy instrumente juridike themelore përshtitjeve ndërkombëtare të mallrave në veçanti, por edhe për të drejtën komerciale ndërkombëtare në përgjithësi. Këto dy dokumente nuk do të duhej të shikoheshin dhe analizoheshin në mënyrë alternative, por vetëm si dy dokumente komplementare të cilat e ndërplotësojnë njëra tjetrën, përkundër dilemave, mendimeve ndryshe dhe diskutimeve ndër autorë në lidhje më këtë.

Është më rëndësi të ceket se edhe në rastin e aplikimit të CISG dhe/apo Parimeve të UNIDROIT, vlenë parimi i autonomisë së palëve në përzgjedhjen apo kontraktimin e të drejtës së aplikueshme. Në kuadër të kësaj autonomie, së pari palët mund të përcaktojnë me marrëveshje që Parimet e UNIDROIT të përdorën si mjet për plotësimin e CISG-ut, së dyti, mund të përcaktojnë që Parimet e UNIDROIT të përdorën si e drejtë e pavarur (pavarësisht përkatësisë nacionale të personave apo bizneseve) në marrëdhënien kontraktuale, dhe së treti, të përdorën Parimet e UNIDROIT si

---

[http://scholarship.law.duke.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=6058&context=faculty\\_scholarship](http://scholarship.law.duke.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=6058&context=faculty_scholarship)

See also, Gotanda, Y. J., *Using the Unidroit Principles to Fill Gaps in the CISG*, pg.12-13, School of Law Working Paper Series, Villanova University School of Law, Paper No.88/2007.

<http://digitalcommons.law.villanova.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1089&context=wps>

<sup>78</sup>H. Kritzer, A., *General observations on use of the UNIDROIT Principles to help interpret the CISG*, Pace Law School Institute of International Commercial Law (Last updated June 30, 2009), (last seen: February 2015).

<http://www.cisg.law.pace.edu/cisg/text/matchup/general-observations.html>

mjet për zgjidhjen e ndonjë mosmarrëveshje eventuale e cila mund të dal në mes të palëve kontraktuese.

Po ashtu, si përfundim mund të thuhet se duke pasur parasysh nenin 7 të CISG-ut, në lidhje me kriteret për interpretimin e CISG-ut, të cekur më lartë, konstatohet se Parimet e UNIDROIT aktualisht më së miri kënaqin këto kriteret. Mirëpo, megjithëkëtë kjo nuk duhet të nënkupton se Parimet e UNIDROIT bartin edhe ekskluzivitetin kryesor të garantuar për interpretimin e CISG.

**Msc.Ardrit Gashi\***

## **THE ROLE OF UNIDROIT PRINCIPLES IN THE INTERPRETATION OF THE CISG**

The present paper entitled “Role of UNIDROIT Principles in the Interpretation of the CISG” initially refers to two basic instruments of the international trade law and international legal and contractual relations in the international sale of goods. Secondly, it refers to the role of the two different legal documents, which yet share the same purpose and complement each other. Dealing with some CISG provisions that leave a lot of room for interpretation, such as UNIDROIT Principles as a tool to help interpret the CISG provisions, is deemed necessary. And this is not all, as the role of UNIDROIT Principles is also to try and unify the contract law at both national and international levels.

The adoption of these two documents was not easy at all, because, as it will be seen hereinafter, their adoption was preceded by a long history and a strong commitment and a major goal on the part of the Member States to establish and unify the rules of international relations. On the other hand, as its title suggests, the present paper aims to identify and analyse in detail some CISG gaps and provisions that require interpretation, as well as the role of UNIDROIT Principles as auxiliary tools in bridging and interpreting those gaps.

---

\* PhD Candidate at University of Prishtina, Faculty of Law.

**Ma. Sc. Albanë Gashi\***

## **Procesi i ekzekutimit të buxhetit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Kosovë**

### **HYRJE**

Organizatave buxhetore menaxhojnë me paratë publike të cilat përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike. Çdo organizatë buxhetore është përgjegjëse për shpenzim të buxhetit në mënyrë efektive dhe efikase sipas përgjegjësisë të caktuar dhe brenda kufijve të përcaktuar nga autoritetet kompetente. Buxheti, pa marrë parasysh nëse kemi të bëjmë me një organizatë publike apo jo-publike, paraqet një mjet bazik dhe shumë të fuqishëm në menaxhment si dhe shërben si mjet për planifikim dhe kontroll të resurseve financiare drejt arritjes së objektivave të caktuara.

Duke marrë parasysh faktin se çdo organizatë buxhetore duhet të operojë brenda limiteve buxhetore, sfidë e tyre përherë mbetet menaxhimi i duhur i ekzekutimit të buxhetit që nënkupton shpenzimin e mjeteve financiare ashtu siç janë alokuar dhe që i kontribuojnë përmbushjes së prioriteteve të përcaktuara. Për më tepër, në mënyrë që sistemi për menaxhimin e financave publike të jetë plotësisht efektiv, ndër të tjera kërkohet edhe minimizimi i kostove financiare gjatë menaxhimit buxhetor, e që kjo nënkupton edhe implementimin adekuat të buxhetit.

Ekzekutimi i buxhetit është procesi nëpërmjet të cilit burimet financiare drejtohen dhe kontrollohen drejt arritjes së qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara. Përkatësisht, ekzekutimi i buxhetit është procesi i zbatimit, monitorimit dhe raportimit të buxhetit dhe si i tillë paraqet një fazë të pandarë të ciklit menaxherial nga e cila fitohen informatat e nevojshme për përgatitjen e programeve për periudhën në vazhdim, prandaj rëndësia e implemetimit adekuat të buxhetit del të jetë tejet e rëndësishme.

Duke u mbështetur në dispozitat e kornizës ligjore në fuqi dhe burimet e tjera relevante të kësaj fushe, ky punim ka për qëllim të paraqes dhe analizoj procesin e ekzekutimit të buxhetit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Kosovës. Ekzekutimi i buxhetit si proces në këtë ministri ashtu si në të gjitha organizatat të cilat

pranojnë fonde nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës është mirë i rregulluar dhe përfshin pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe administrative të vendit. Ekzekutimi i buxhetit fillon me ndarjen buxhetore, duke vazhduar më tej me alokimin, inicimin e shpenzimeve, zotimin, prokurimin, kontraktimin, pagesën e faturës dhe në fund lëshimin e fondeve nga llogaria bankare e Fondit të Konsoliduar të Kosovës dhe i cili duhet të shoqërohet vazhdimisht me monitorimin, raportimin dhe kontrollin e tij. Duke marrë parasysh faktin se devijimi i shpenzimeve nga buxheti i miratuar mund të ketë ndikime serioze ekonomike dhe sociale, atëherë kjo e shton edhe më tepër rëndësinë e ekzekutimit adekuat të buxhetit në orientimin e burimeve financiare drejt arritjes së qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara.

## **1. FUSHËVEPRIMI I PËRGJEGJËSIVE, OBJEKTIVAT DHE ORGANIZIMI I BRENDSHËM I MBPZH**

Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (më tej: MBPZhR) është organ i lartë i administratës së vendit e cila ofron shërbime publike për sektorin e bujqësisë dhe ushtron përgjegjësi të saj të përcaktuara me Rregulloren nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, pëkatësisht në anekset e saj. MBPZhR ka përgjegjësi të krijoj politikat dhe zbatoj ligjet për zhvillimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të sektorit të bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural siç janë krijimi dhe zbatimi i ligjit për (i) ujitjen e tokave (ii) shfrytëzimin e qëndrueshëm të tokës, mbrojtjen dhe rregullimin e saj (iii) caktimin e standardeve për prodhimtari dhe mbrojtjen e bimëve, bujqësisë organike dhe promovimin e prodhimit bujqësor (iv) si dhe u ofron këshilla fermerëve në fushën e prodhimit, përpunimit dhe marketingut.<sup>1</sup>

Siç është përcaktuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) 2015-2017, MBPZhR në periudhë afatmesme ka planifikuar të realizojë objektivat si më poshtë:

1. Rritja e zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë dhe sigurimi i nivelit të duhur i të ardhurave të prodhuesve bujqësor si dhe prodhimi i qëndrueshëm i ushqimit cilësor dhe mbrojtja e mjedisit;
2. Rritja e aftësisë konkurruese në bujqësi, sektorin e ushqimit dhe pylltarisë, promovimi i zhvillimit dhe mundësisë të punësimit si dhe përmirësimi i kualitetit të jetesës në zonat rurale;

---

<sup>1</sup>Rregullorja nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, shtojca 14, botuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, datë 22.03.2011.



3. Përmirësimi i zhvillimit të qëndrueshëm të pyjeve dhe të gjitha funksioneve të tyre ekologjike, ekonomike dhe sociale duke përfshirë ruajtjen e biodiversitetit, si dhe
  4. Menaxhimi dhe zhvillimi cilësor i sektorit të bujqësisë përfshirë zhvillimin e politikave, vendosjen e kornizës legislative dhe normative.<sup>2</sup>
- Struktura organizative e MBPZHR është përcaktuar me Rregulloren (QRK) nr.37/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe është si në vijim:

- Kabineti i Ministrit - i cili përbëhet nga ministri, zv. ministri, këshilltarët politikë dhe personelin mbështetës përgjegjës për udhëheqjen politike të MBPZHR-së dhe bashkëpunimin me institucionet tjera Qeveritare.
- Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm – konsiston nga sekretari i përgjithshëm dhe personeli mbështetës përgjegjës për udhëheqjen e MBPZHR në baza ditore.
- Departamentet - kryejnë aktivitetet e tyre të caktuara në mbështetjet e zhvillimit të politikave, zbatimit të programeve dhe funksioneve kontrolluese që janë të domosdoshme për zbatimin e përgjegjësisë të MBPZHR.
- Divizionet të cilat operojnë në kuadër të Departamenteve.<sup>3</sup>

MBPZHR nën ombrellën e saj ka dy Agjencione: Agjencioni Pyjor i Kosovës dhe Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë.<sup>4</sup> Agjencioni Pyjor i Kosovës bën implementimin e programeve dhe politikave për menaxhimin dhe administrimin e pyjeve. Ndërsa, Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë është përgjegjëse për zbatimin e politikave bujqësore dhe politikave të zhvillimit rural të cilat hartohen nga Autoriteti Menaxhues në MBPZHR si dhe ushtron një sërë funksionesh për administrimin e fondeve për pagesa direkte dhe masat e zhvillimit rural.<sup>5</sup> Figura nr. 1 e prezantuar më poshtë paraqet organogramin që tregon strukturën organizative të MBPZHR-së si dhe lidhjen midis departamenteve të ndryshme brenda organizatës dhe renditjen e tyre. Figura 1. Organogrami i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.<sup>6</sup>


<sup>2</sup>Ministria e Financave, *Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2015-2017*, fq. 56.

<sup>3</sup>Rregullorja (qrk) nr.37/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.12, Prishtinë, 2014, neni 3.

<sup>4</sup>*Ibid.*, neni 50.

<sup>5</sup>Ligjin Nr. 04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28, Prishtinë 2012, neni 11.

<sup>6</sup>Shih: Rregullore (QRK) nr.37/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.



Nga figura nr.1 shihet se ky organogramë paraqet Agjencionin për Zhvillimin e Bujqësisë si të pavaruar në menaxhimin e procesit të subvencionimit, edhe pse ekzekutimi i pagesave ende realizohet nga zyra qendrore e financave në MBPZHR. Ky agjencion është ende në procesin e zhvillimit të strukturës së tij organizative, dhe se pavarësia e tij, sipas praktikave ndërkombëtare, është e nevojshme të ndodh sa më shpejt që të jetë e mundur pasi që do të luaj një rol të rëndësishme për zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

## 2. FAZAT E SHPENZIMIT TË BUXHETIT NË MBPZHR

Një ndër hapat e ciklit buxhetor pa dyshim se është edhe ekzekutimi/ implementimi i buxhetit. Ekzekutimi i buxhetit është faza në të cilën resurset përdoren për të realizuar politikën e përfshira në buxhet, prandaj një proces i mirë i buxhetit duhet të (i) siguroj që buxheti të implementohet sipas kornizës ligjore (ii) përshtat shpenzimin e buxhetit me ndryshimet në ambientin ekonomik (iii) mundësoj zgjidhjen e problemeve të cilat hasen gjatë fazës së implementimit të programeve (iv) siguroj të mira dhe shërbime dhe menaxhimin e tyre në mënyrë të përshtatshme (v) parandalimin e rreziqeve nga mashtrimi, abuzimi dhe keqpërdorimi i mundshëm.<sup>7</sup>

Ekzekutimi i buxhetit bëhet në atë mënyrë që të arrihen objektivat e përcaktuara. Mënyra e shpenzimit të parave publike në MBPZHR përcaktohet me Rregulloren Financiare nr. 01/2013 për shpenzimin e parave publike e cila është hartuar në bazë të Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë (më tej: LMFPP) dhe e cila zbatohet njëjtë për të gjitha organizatat buxhetore të cilat pranojnë fonde nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Sipas LMFPP, përgjegjësinë për ekzekutimin e buxhetit të Kosovës e mban Departamenti i Thesarit, mirëpo gjatë këtij procesi merr pjesë secila organizatë buxhetore në shpenzimin e buxhetit të tyre në bashkëpunim dhe koordinim me Thesarin.


Ekzistojnë disa elemente të cilat përbëjnë hapat deri te shpenzimi i një shume të caktuar parash për një qëllim të caktuar të cilët duhet të ndiqen dhe që e përbëjnë një proces në vete të ekzekutimit të buxhetit. Këto elemente paraqiten në figurën nr.2 të prezantuar më poshtë si dhe elaborohen më tutje në pjesën në vazhdim. Kjo pjesë e punimit është bazuar në Manualin e

---

<sup>7</sup>Shah, A.: *Budgeting and Budgetary Institutions*, World Bank, Washington DC 2007, fq. 279.

Thesarit, Vëllimi II i cili është përgatitur nën autoritetin e LMFPF dhe i cili përmban në vete një grumbull udhëzimesh dhe rregullash financiare për shpenzimin e parave publike. Manuali është përgatitur në vitin 2007, prandaj janë marrë parasysh ndryshimet e deritanishme në rregulloret përkatëse.<sup>8</sup>

Figura 2. Fazat e shpenzimit të buxhetit:



Ekzekutimi i buxhetit në MBPZhR ashtu si në secilën organizatë buxhetore fillon pasi të jetë aprovuar buxheti nga Kuvendi, e cila paraqet iniciimin e procesit të ekzekutimit të buxhetit. Për të lehtësuar dhe mbështetur procesin e ekzekutimit të buxhetit përdoret një sistem i specializuar për Kosovën, i ashtuquajtur Sistemi Informativ për Menaxhimin Financiar të Kosovës (SIMFK), në të cilin regjistrohen dhe kontrollohen të gjitha transaksionet financiare, në atë mënyrë që ndalon shpenzimin e buxhetit nëse nuk ka fonde të mjaftueshme të parapara. SIMFK mundëson lidhjen e të gjitha njërive shpenzuese në një bazë të të dhënave, dhe si i tillë paraqet mjetin kryesor të raportimit të financave të qeverisë. SIMFK menaxhohet nga Thesari dhe

<sup>8</sup> Shih: *Manuali i Thesarit, Vëllimi II*, (përgatitur nga: Alan Pearson, Richard Roberts, Kozeta Smith, Driton Dalipi), Prishtinë, qershor 2007, fq. 26.

ofron disa module siç janë moduli i kontrollit, moduli i aprovimeve, moduli i shpenzimeve, libri i përgjithshëm i llogarive, moduli i blerjeve, moduli i të hyrave, moduli i pasurive, dhe moduli i barazimeve.<sup>9</sup>

## 2.1. Ndarja Buxhetore

Procesi i shpenzimeve fillon me ndarjet buxhetore. Sipas LMFP “Ndarje buxhetore do të thotë shuma maksimale e përcaktuar në një Ligj për Ndarjet Buxhetore e cila mund të vihet në dispozicion për shpenzim nga një organizate buxhetore gjatë vitit fiskal për shpenzim në një program të caktuar ose kategori tjetër shpenzimi ose për bartje nga një organizatë buxhetore të një autoritet publik ose ndërmarrje publike në formë të grantit.”<sup>10</sup> Ndarjet buxhetore paraqiten në total për secilën organizatë buxhetore dhe programet në kuadër të saj, si dhe detajizohen më tutje sipas kategorive ekonomike që janë (i) Pagat dhe Mëditjet (ii) Mallrat dhe Shërbimet (iii) Shpenzimet Komunale (iv) Shpenzimet Kapitale dhe (v) Subvencionet dhe Transferet. Ndarjet buxhetore bëhen në bazë të parasë së gatshme dhe lëshohen nga llogaria bankare e Fondit të konsoliduar të Kosovës i cili mbahet dhe kontrollohet nga Thesari në Bankën Qendrore të Kosovës.

Organizatat buxhetore kanë në dispozicion fondet për shpenzim deri në mesnatën e 31 dhjetorit që paraqet afatin kur ndarjet buxhetore skadojnë dhe në rast të mosshpenzimit në tërësi të buxhetit në dispozicion humbet e dreja e shfrytëzimit të tyre.<sup>11</sup>

## 2.2. Alokimi i mjeteve financiare

Pasi të jenë regjistruar ndarjet buxhetore pason faza e alokimit të mjeteve financiare. Sipas dispozitave të Rregullës financiare për shpenzimin e parave publike “Alokimi është procesi i vënies në dispozicion të fondeve për tu shpenzuar sipas ndarjeve buxhetore të përfshira në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës”.<sup>12</sup> Alokimi i fondeve paraqet dritën jeshile për MBPZhR si dhe organizatat buxhetore për fillimin e ekzekutimit të buxhetit të tyre, zhvillimin e aktiviteteve të përditshme përmes qasjes në paranë

<sup>9</sup>Rregulla Financiare Nr.01/2013 MF për Shpenzimin e Parave Publike, neni 9.

<sup>10</sup>Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.27, Prishtinë, 2008, neni 1 .

<sup>11</sup>Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 27.

<sup>12</sup>Rregulla Financiare Nr.01/2013 MF për Shpenzimin e Parave Publike, neni 10.

publike. Alokimi bëhet zakonisht për periudha tremujore, në bazë të planit të detajuar të rrjedhës së parasë ku paraqitet se sa do të shpenzohet në çdo muaj dhe sipas kategorive ekonomike, të përgatitur nga organizata buxhetore. Sipas LMFPF organizatat buxhetore obligohen që këtë plan ta dorëzojnë brenda 30 ditëve nga fillimi i vitit fiskal tek Departamenti i Thesarit, i cili krahason planin e parasë me disponibilitetin e fondeve, dhe bën menaxhimin e alokimeve si dhe sigurohet që shpenzimet të ndodhin ashtu siç janë planifikuar.

Sa i përket Projekteve Investuese Publike (PIP), organizatat buxhetore në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës (nr.04/L-042)<sup>13</sup> obligohen që të përgatisin dhe të dorëzojnë planin për secilin projekt kapital në veçanti, dhe duhet të kenë kujdes gjatë hartimit të planit dhe shpenzimeve në këtë kategori ekonomike pasi që kërkon më shumë kohë dhe vëmendje pasi bëhet fjalë për projekte të cilat kërkojnë shuma më të mëdha parash dhe ndjekje të hapave të caktuar. Kjo edhe nga fakti se rrallë herë planet rrjedhin ashtu siç mendohen në fillim, pasi që janë propozime që përgatiten paraprakisht për zhvillimin e aktiviteteve në të ardhmen për arritjen e qëllimeve të caktuara, prandaj organizatat buxhetore shpesh mund të gjenden para një situatë ku shohin nevojën për ndryshime në planin e rrjedhës së parasë. Në këtë rast përmes monitorimit të procesit të shpenzimit identifikohen ndryshimet e nevojshme dhe organizata paraqet kërkesën tek Departamenti i Thesarit për akomodimin e këtyre ndryshimeve në planin e rrjedhës së parasë. Po ashtu në rast se ka ndryshime si rezultat i vendimeve qeveritare, qoftë reduktime apo alokim të fondeve shtesë, organizata buxhetore njoftohet me kohë për çdo eventualitet nga Departamenti i Thesarit.

### 2.3. Inicimi i shpenzimit

Siç u tha edhe më sipër, alokimi i fondeve nënkupton fillimin e procesit të shpenzimeve. Me pranimin e alokimeve, organizata buxhetore mund të filloj me përpilimin e kërkesës për blerje për përgatitjen e urdhërit për zotim, çdo herë duke u siguruar se ekzistojnë fonde të mjaftueshme në dispozicion për mbulimin e shpenzimit dhe se shpenzimi po bëhet në përputhje me planin e ekzekutimit të buxhetit. Përgjegjësinë për aprovimin e kërkesës për zotim e ka Zyrtari Autorizues i cili duhet të sigurohet se të gjitha detajet e nevojshme në formularin e kërkesës janë të sakta, i cili e dorëzon atë tek Zyrtari Kryesor

---

<sup>13</sup> Shih: *Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (nr.04/L-042)*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 18, Prishtinë 2011, neni 8.

Financiar. Në MBPZhR rolin e Zyrtarit Autorizues e ushtron Sekretari i Përgjithshëm.

Në momentin që fillon shpenzimi, duhet të identifikohet nëse kërkohet procesi i prokurimit apo jo për realizimin e atij shpenzimi. Pikërisht në bazë të asaj nëse kërkohet procedura e prokurimit apo jo dallohen edhe shpenzimet të cilat pritet të realizohen. Pra shpenzimet i ndajmë në dy kategori apo lloje:

- a. Shpenzime që nuk kërkojnë procedura të prokurimit, dhe
- b. Shpenzime që kërkojnë procedura të prokurimit.
- c.

Shpenzimet të cilat nuk kërkojnë procedurat e prokurimit publik janë pagat, shpenzimet e paguara me para të imëta, komunalitë, subvencionet dhe transferet, avancat për udhëtime dhe transaksionet ndërdepartamentale.<sup>14</sup>

SIMFK ofron modulën e aprovimeve apo shpenzimeve për të operuar me shpenzimet të cilat nuk kërkojnë procedura të prokurimit. Këto lloje të shpenzimeve inicohen me përgatitjen e urdhrin për zotim dhe pagesë (UZP), i cili nënshkruhet nga zyrtari autorizues dhe regjistrohet në sistem nga zyrtari zotues. Për dallim nga moduli i blerjes, në modulën e aprovimeve dhe shpenzimeve obligimi ndodh me rastin e regjistrimit të zotimit. Shpenzimet të cilat kërkojnë procedurat e prokurimit publik janë shpenzimet nga kategoria mallra dhe shërbime dhe investimet kapitale. Për regjistrimin dhe llogaritjen e shpenzimeve që kërkojnë procedura të prokurimit shërben moduli i blerjes.

#### 2.4. Zotimi i fondeve

Secila organizatë buxhetore ka obligimet e saj të cilat janë të vazhdueshme siç është rryma elektrike, shpenzimet për telefon të cilat nuk kontraktohen, mirëpo ka edhe shpenzime të tilla të cilat duhet t'i realizoj sipas marrëveshjes apo kontratës. Në momentin që një organizatë buxhetore lidh kontratë për një shërbim apo mall të caktuar, ajo automatikisht hyn në obligime. Në këtë rast, sipas LMFPP (neni 37) kërkohet që fondet të zotohen për të përmbushur këto obligime përgjatë vitit fiskal. Zotimi është "... njohje kontabël në SIMFK e një obligimi të mundshëm në të ardhmen për të bërë një shpenzim të parave publike".<sup>15</sup> Përgjegjës për zotimin e fondeve është

<sup>14</sup>*Rregulla Financiare Nr.01/2013 MF për Shpenzimin e Parave Publike*, neni 21.

<sup>15</sup>*Ibid.*, neni 12.

zyrtari zotues i cili pas aprovimit të kërkesës për blerje i proceson zotimet në SIMFK.

Organizata buxhetore duhet të ketë kujdes që zotimet t'i realizoj vetëm nga fondet e alokuara, që do të thotë se duhet të ekzistoj një lidhje e ngushtë midis zotimit dhe planifikimit të buxhetit, në mënyrë që fondet e alokuara t'i mbulojnë të gjitha shpenzimet e planifikuara, respektivisht obligimet e organizatës. Zotimi i fondeve në SIMFK i mundëson organizatës që të mos grumbulloj obligime, duke shpenzuar kështu në përputhje me fondet në dispozicion. Në raste përjashtuese, kur bëhet fjalë për prokurimin publik, zotimet mund të barten për vitet në vazhdim. Kjo ndodh për ndonjë projekt shumëvjeçar për të cilin zotimi për vitet e ardhshme bëhet nëse planifikohet që të ndahen fonde për këtë qëllim, dhe duhet të kihet kujdes që organizata të mos hyj në obligim kontraktor për vitin e ardhshëm para se të jetë aprovuar buxheti i vitit vijues.

Po ashtu ekziston mundësia që zotimi të ndryshohet nëse për ndonjë arsye organizata buxhetore nuk ka mundur të realizoj projektin në para të gatshme para përfundimit të vitit. Ndërsa kur flitet për projektet kapitale, çdo ndryshim i ndodhur siç është p.sh. vonesat në realizim në vitin aktual, duhet të pasqyrohet në Programin e Investimeve Publike. Afati i fundit për regjistrimin e zotimeve në SIMFK në varësi nga lloji i tyre është 7 nëntor deri më 26 dhjetor i vitit aktual.<sup>16</sup>

## 2.5. Prokurimi

Më sipër është cekur se SIMFK përbëhet nga disa module të cilat mundësojnë ekzekutimin e buxhetit në varësi të llojit të shpenzimit. Ndër të tjera module është edhe moduli i blerjes në të cilin regjistrohen dhe llogariten shpenzimet që kërkojnë procedura prokurimi, siç janë shpenzimet nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime dhe investimet kapitale, respektivisht regjistrohet zotimi i cili ndodh kur të procesohet kërkesa për blerje si dhe obligimi që ndodh kur të procesohet urdhërblejra nga ana e organizatës buxhetore.

Kërkesa për blerje përgatitet nga departamentet në bazë të nevojave të tyre dhe regjistrohet në SIMFK nga zyrtari zotues në rast se ka fonde të alokuara, ndërsa urdhërblejra krijohet nga zyrtari i prokurimit pasi të jenë zgjedhur tenderët dhe është lidh kontrata me furnitorin e caktuar. Urdhërblejra regjistrohet në sistem me të gjitha të dhënat e furnitorit. Në këtë mënyrë

---

<sup>16</sup>*Ibid.* neni 6.



sistemi urdhërblenjen do ta regjistroj automatikisht si obligim. Ligji i Prokurimit e obligon zyrtarin e prokurimit të nënshkruaj kontratat dhe të përgatis urdhërblenjet. Procedurat e prokurimit caktohen me Ligjin për Prokurimin Publik.

## **2.6. Kontraktimi**

Organizata buxhetore për t'u furnizuar me mallra dhe shërbime, lidh marrëveshje me furnitorin i cili kryen këto shërbime, përkatësisht nënshkruhet kontrata midis dy palëve. Në momentin që nënshkruhet kontrata, organizata buxhetore hyn në obligim për të bërë pagesën në të ardhmen. Obligimi regjistrohet në SIMFK si i tillë në momentin kur të procesohet urdhërblejra në sistem nga zyrtari i prokurimit. Si rregull me krijimin e obligimit, zotimi shlyhet dhe në momentin kur të realizohet dhe regjistrohet shpenzimi, shlyhet obligimi. Sistemi është i formatit të atillë që kërkon të përshkruhen të gjitha detajet e përcaktuara në kontratë.

## **2.7. Pagesa e faturës**

Pas lidhjes së marrëveshjes ligjore, organizata buxhetore në datën në të cilën përcaktohet me kontratë pranon mallin apo shërbimin për të filluar me ndonjë projekt të paraparë. Procedurat për pranimin e mallit dhe procedimin e pageses janë si më poshtë (figura nr.3) dhe vlejnjë njëjtë pa marrë parasysh llojin e shpenzimeve.<sup>17</sup>

---

<sup>17</sup>*Ibid.*, neni 22.

Figura 3. Procedurat e përgjithshme për procedimin e pagesave



Siç mund të vërehet nga figura nr.3, duhet ndjekur disa procedura për pranimin e mallit dhe procedimin e pagesës, si në vijim:

- Pasi të jetë bërë kërkesa për blerje dhe urdhërblerja pranohen mallrat nga zyrtari i prokurimit. Për të gjitha mallrat dhe shërbimet me vlerë mbi 1000 Euro duhet të përgatitet raporti për pranimit e mallit që dëshmon se mallrat dhe shërbimet janë pranuar sipas kontratës, dhe duhet të nënshkruhet nga zyrtari autorizues, në rastin e MBPZhR nga Sekretari i Përgjithshëm.
- Fatura origjinale e cila pranohet nga zyrtari i prokurimit ose ai i logjistikës së bashku me raportin e pranimit dhe kontratën i dërgohen Divisionit për Buxhet dhe Financa (DBF), i cili pasi që sigurohet se të gjitha procedurat e deritanishme kanë shkuar në rregull i përcjell dokumentet përkatëse për certifikim tek zyrtari certifikues.
- Zyrtari certifikues pasi ka pranuar dokumentacionin, rishikon atë për t'u siguruar se është respektuar kontrata, janë ndjekur procedurat siç duhet dhe janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore. Nëse çdo gjë është në rregull, certifikon pagesën për ekzekutim, në të kundërtën njofton menjëherë Zyrtarin Kryesor Financiar i cili vendos për hapat e mëtejshëm. Të dhënat regjistrohen në SIMFK, kurse një kopje fizike e dokumenteve i dërgohet Thesarit për procesim të pagesës përfshirë

faturën origjinale, kontratën kopje të vërtetuar për origjinalitetin e saj, kërkesën e blerjes (në rast të shpenzimeve pa prokurim UZP, urdhërblerjen/raportin e pranimit). Një kopje e dokumentacionit të kompletuar duhet ta mbaj DBF për njëperiudhë prej 7 vjetësh.

### **2.7.1. Kontrolli i brendshëm i dokumentacionit dhe raportimi i obligimeve të papaguara**

Përgjegjës për kontrollin e brendshëm të dokumentacionit që qarkullon, para se ai të përcillet tek zyrtari certifikues, është Divisioni për Buxhet dhe Financa. Ky kontrollim përfshin:

- Sigurimin se fatura nuk është paguar më parë;
- Sigurimin e raportit të pranimit të mallit;
- Protokollimin dhe evidentimin e faturës në librin e faturave;
- Sigurimin se furnitori është regjistruar në SIMFK;
- Përgatitjen e të dhënave për pagesë në formularin e UZP (për blerjet që nuk kërkojnë prokurim), ose përgatitjen e urdhrut për pagesë për pagesat që kërkojnë procedurat e prokurimit;
- Përgatitjen e formularit për transfer bankar për pagesat e furnitorëve me llogaribankare jashtë Kosovës;
- Përcjelljen e dokumentacionit të kompletuar te Zyrtari Certifikues.<sup>18</sup>

Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës për plotësimin e obligimeve financiare, përkatësisht pagesën me kohë të të gjitha faturave të cilat i pranon organizata, ku sipas rregullores afati për pagesën e të gjitha faturave të cilat i pranon organizata buxhetore është jo më vonë se 30 ditë pas pranimit të saj, vetëm nëse përcaktohet ndryshe me kontratë. Nëse deri në fund të vitit fiskal nuk plotësohen obligimet, atëherë organizata buxhetore duhet:

- a) T'i raportojë këto obligime të papaguara në Departamentin e Thesarit dhe Buxhetit në MF përmes raporteve mujore;
- b) T'i raportojë këto obligime në raportet e tyre financiare; dhe
- c) Menjëherë ta regjistrojë një zotim dhe obligim në SIMFK nga buxheti i vitit vijues, për shlyerjen e këtyre obligimeve.<sup>19</sup>

Duhet pasur parasysh se obligimet e papaguara janë prioritet mbi shpenzimet tjera të planifikuara, prandaj gjithmonë duhet të punohet në atë drejtim që të krijohet hapësirë për plotësimin e tyre.

---

<sup>18</sup>Rregulla Financiare Nr.01/2013 MF për Shpenzimin e Parave Publike, neni 24

<sup>19</sup>Ibid.

## 2.8. Lëshimi i fondeve nga llogaria

Pasi Departamenti i Thesarit të bëj procedimin e pagesës, fondet për realizimin e pagesës lëshohen nga llogaria e Buxhetit të Konsoliduar. Të gjitha pagesat nga llogaria bankare e Fondit të Konsoliduar të Kosovës bëhen pëmes transferit ndërbankar, përveç në raste përjashtuese. Me lëshimin e fondeve nga llogaria bankare përmbyllet procesi i shpenzimit të buxhetit. Nëse njësitë shpenzuese kanë arritur që shpenzimin e buxhetit të tyre ta realizojnë sipas procedurave të parapara, duke respektuar afatet kohore të përcaktuara dhe kanë arritur të përgatisin dokumentacionin në mënyrë cilësore atëherë efektiviteti i realizimit të buxhetit të tyre do të rritej.<sup>20</sup>

## 3. RISHIKIMI

Synim i secilës organizatë buxhetore është shpenzimi sa më efikas i buxhetit të tyre vjetor, që nënkupton arritjen e objektivave dhe qëllimeve të përcaktuara brenda limiteve buxhetore. Menaxhimi efektiv i buxhetit konsiston në monitorimin dhe raportimin e tij në baza të rregullta. Për menaxhimin sa më të mirë të shpenzimit të buxhetit organizatave buxhetore u jepet mundësia e rishikimit të buxhetit të tyre përgjatë vitit fiskal. Në këtë mënyrë secili menaxher i programit informohet mbi progresin e ekzekutimit të buxhetit të tyre, të cilat janë bazë e mirë për të vendosur për ecurinë e shpenzimeve për periudhën e mbetur.

Ministria e Financave, përmes udhëzimeve që i nxjerr, u mundëson si organizatave buxhetore tjera ashtu edhe MBPZhR-së rishikimin gjashtëmuor, në mënyrë që ato të mund të vlerësojnë ecurinë e shpenzimeve deri në atë pikë të vitit. Në këtë rast MBPZhR vlerëson aktivitetet dhe shpenzimet e realizuara, si dhe të tjerat të cilat planifikon t'i shpenzojnë deri në mbylljen e vitit fiskal.

Rishikimi gjashtëmuor mundëson:

- Vlerësimin e shpenzimeve të organizatës buxhetore të deritanishme, si dhe shpenzimeve për pjesë mbetur të vitit;
- Rezultatet/të arrituarat e programeve deri në atë pikë të vitit, dhe të arrituarat e vlerësuara përpjesën e mbetur të vitit;
- Prioritetet e reja apo të ndryshuara që duhet të adresohen deri në fund të vitit;

---

<sup>20</sup>Brajshori, B.: *Menaxhimi i shpenzimeve publike dhe i proceseve buxhetore*, Prishtinë, 2010. fq. 223.

- Hapat e mëtejshëm për t'u ndërmarrë, duke përfshirë edhe transferet e fondeve apo ridestininimin e tyre, me qëllim tëshfrytëzimitnë mënyrë sa më efektive dhe efikase të fondeve të mbetura të vitit.<sup>21</sup>

Pasi që MBPZhR ashtu si ministritë tjera të linjës të kenë vlerësuar nevojat e tyre, Ministria e Financave e bën konsolidimin e rishikimeve buxhetore dhe e prezanton atë tek Kabineti Qeveritar. Të gjitha këto ndryshime duhet të përshtaten me planet shpenzuese të MBPZhR të vitit aktual dhe në atë vijues. Rishikimi është gjithnjë i nevojshëm dhe paraqet një mënyrë shumë të dobishme për të mbështetur organizatën buxhetore që të përmbush qëllimet e saj siç i ka planifikuar dhe të reflektoj në gjetjen e mënyrave dhe metodave për vazhdimësinë e shpenzimit të mjeteve të mbetura në mënyrën më të mirë të mundshme. Për më tepër, rishikimi i buxhetit mundëson transferimin e mjeteve financiare ndërmjet programeve konform bazës ligjore. Me këtë rast sipasLMFPP, neni 30, organizatave buxhetore u mundësohet transferimi/ rialokimi i fondeve të tyre brenda vitit financiar në varësi të nevojave të tyre. Kjo mund të vërehet edhe nga tabela nr.1.

Tabela 1: Rialokimet e shpenzimeve brenda vitit: rregullat e transferit

	Trasferi/Rialokimi	Aprovimi
A	0% - 5%	Organizata buxhetore
B	5% - 15%	Ministria e Financave
C	15% - 25%	MF me aprovim nga Qeveria
D	> 25%	Parlamenti

Transferimet e mëposhtme përcaktohen me LMFPP:

- Organizata buxhetore lejohet të transferoj deri në 5%të njërës prej ndarjeve të saja buxhetore në një ndarje tjerët gjatë çfarëdo viti fiskal, pa marrjen e miratimit paraprak nga ana e Ministrit të Ministrisë së Financave.
- Për transferetderi në 15%të shoqëruara me një arsyeshmëri të fortë, kërkohet miratimi nga Ministri i Financave.

<sup>21</sup>Ministria e Ekonomisë dhe Financave, *Udhëzues për procesin dhe planifikimin e buxhetit të Kosovës*, dhjetor 2008, fq. 85.

- Për transferin e shumave më të mëdha se 15% por më pak se 25%, kërkohet miratimi me shkrim nga Qeveria para se të autorizohet nga Ministri.
- Për shumat e barabarta ose më të mëdha se 25% nevojitet miratimi me shkrim nga Kuvendi para se të autorizohet nga Ministri i Ministrisë së Financave.<sup>22</sup>

#### 4. KONTROLLI I SHPENZIMIT TË BUXHETIT

Kontrolli i shpenzimit të buxhetit ka për qëllim sigurimin se të gjitha transaksionet financiare/buxhetore inicoohen me kohë, regjistrohen si dhe raportohen me kohë, e po ashtu edhe të gjitha procedurat ndiqen sipas ligjeve në fuqi dhe rregulloreve, me qëllim të pengimit të padrejtësive dhe keqpërdorimeve gjatë shpenzimit të buxhetit. Organizata buxhetore me kontrollin synon të arrij objektivat e përcaktara përmes shpenzimit efikas të buxhetit në dispozicion. Sipas autorit B. Brajshori ‘‘Kontrolli i buxhetit mbështetet në ndërtimin e një infrastrukture adekuate ligjore, në ndërtimin e resurseve njerëzore, teknike dhe institucionale, si dhe në nevojën e ngritjes së vetëdijes së vetë shpenzuesve buxhetorë për një administrim ligjor të financave publike.’’<sup>23</sup>

Kontrolli i shpenzimeve publike në Kosovë bazohet në LMFPF-në dhe ligjet tjera relevante dhe përveç organizatave buxhetore të cilat kryejnë kontrollin e tyre të brendshme të shpenzimit të buxhetit, përgjegjësia mbi kontrollin e procesit të shpenzimit bie edhe tek disa institucione të cilat ushtrojnë funksionin e tyre në këtë fushë ndaras nga njëra tjetra. Insitucionet kryesore për kontrollin e shpenzimeve publike janë: (i) Ministria e Financave e cila në kuadër të saj ka të themeluar Departamentin e Auditimit të Brendshëm, (ii) Zyra Kombëtare e Auditimit dhe (iii) Parlamenti i Kosovës i cili është kompetent për kontrollin e aktiviteteve të Qeverisë. Parlamenti informohet në baza të rregullta nga Qeveria përmes raportimit mbi realizimin e buxhetit dhe arritjen e objektivave.<sup>24</sup>

Sistemin e kontrollit të brendshëm të financave publike në Kosovë e përbëjnë katër elemente të cilat luajnë rol kyç në këtë proces dhe janë si më poshtë:

- Menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm i mbështetur nga SIMFK;

<sup>22</sup>Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 30.

<sup>23</sup>Brajshori, B., *Menaxhimi i shpenzimeve publike dhe i proceseve buxhetore*, fq.224.

<sup>24</sup>*Ibid*, fq. 130.

- Njësia Qendrore Harmonizuese për Menaxhimin e Kontrollit Financiar që operon në kuadër të Ministriës së Financave;
- Njësia e Auditimit të Brendshëm, të cilën duhet ta ketë të themeluar çdo organizatë buxhetore brenda saj;
- Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm që është themeluar në kuadër të MF.<sup>25</sup>

Përveç kësaj, kontrolli i shpenzimeve publike bëhet edhe nga Zyra Kombëtare e Auditimit që operon si e pavarur. Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë së Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, të organizatave buxhetore dhe institucioneve tjera për vitin përkatës fiskal dhe i raporton drejtëpërdrejt Kuvendit.<sup>26</sup> Këto raporte gjithashtu vihen në dispozicion për publikun në web faqen e Zyrës Kombëtare të Auditimit.<sup>27</sup>

MBPZHR e implementon buxhetin vjetor në pajtim me politikën për shpenzimin e buxhetit dhe me parimet e kontrollit të brendshëm efektiv dhe efikas. Për një shpenzim të mirëfilltë të buxhetit aplikohet kontrolli ex-ante i buxhetit nga vetë organizata buxhetore dhe më pastaj nga Thesari si zbatues final i kontrollit ex-ante. Thesari është përgjegjës për zhvillimin e kornizës së politikave të Kontrollit të brendshëm financiar dhe implementimin e rregullave financiare për ekzekutimin e buxhetit në mënyrë efektive dhe efektive duke pasur parasysh parimet e transparencës dhe llogaridhënies.<sup>28</sup>

LMFPP dhe procedurat për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e obligojnë Zyrtarin Kryesor Administrativ (Sekretarin e Përgjithshëm në MBPZHR) të siguroj menaxhimin efektiv, efikas dhe ekonomik të resurseve të organizatës buxhetore, drejt përmbushjes së qëllimeve strategjike të organizatës buxhetore. Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) menaxhon ministrinë dhe është përgjegjës për suksesin e saj, kurse i përgjigjet ministrit i cili e monitoron punën e tij.

Zyrtari kryesor administrativ ka përgjegjësi të deleguar të funksioneve dhe është përgjegjës për:

---

<sup>25</sup>*Ibid*, fq. 225.

<sup>26</sup>Shih: *Ligji nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.17, Prishtinë, 2016, neni 6.

<sup>27</sup><http://www.zka-rks.org/>

<sup>28</sup>*Manuali i Thesarit, Vëllimi II , Rregulla financiare e Thesarit– Numër 01 Kontrolli i brendshëm i financave publike*, qershor, 2007, fq. 5.

- Implementimin e një strukture të kontrollit të brendshëm financiar në OB, që mundëson veprimtari efikase dhe efektive për:
  - a) Shfrytëzimin dhe menaxhimin e duhur të parave publike,
  - b) Pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat financiare,
  - c) Pajtueshmëri me udhëzimet për planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit
  - d) Shfrytëzimin e parave publike në përputhje me planet buxhetore.<sup>29</sup>
- Zhvillimin e kornizës së llogaridhënies dhe transparencës që nënkupton raportimin mbi performancën e brendshme të MBPZhR dhe raportimin financiar.
- Sigurimin e njësisë së auditimit të brendshëm. Njësia për Auditimin e Brendshëm (NJAB) bën identifikim e riskut të mundshëm gjatë performimit të aktiviteteve të MBPZhR-së dhe organeve qendrore të saj dhe bën vlerësimin e nivelit të efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm. NJAB është organ i pavarur që operon sipas Ligjit përkatës dhe synon që të siguroj që mekanizmi menaxherial dhe i kontrollit të brendshëm në MBPZhR është në përputhje me ligjet dhe rregullat përkatëse.
- NJAB përcjell zbatimin e rekomandimeve nga brenda dhe rekomandimet nga Zyra Kombëtare e Auditimit si dhe e përcjell informatën tek ministri.<sup>30</sup>

## **5. MONITORIMI DHE RAPORTIMI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT**

Për të mbajtur ekzekutimin e buxhetit nën nivelin e duhur të kontrollit, nevojitet të aplikohen dhe të adaptohen sisteme për monitorimin dhe raportimin e rrjedhës së shpenzimit të buxhetit. Si organizatat e tjera, ashtu edhe MBPZhR, monitorimin dhe raportimin e ekzekutimit të buxhetit të saj e bën përmes SIMFK. Monitorimi i rregullt i ekzekutimit të buxhetit është shumë i dobishëm nga fakti se mundëson analizimin e punës dhe krijimin e një pasqyre mbi progresin e menaxhimit të buxhetit dhe realizimit të projekteve kapitale në mënyrë të vazhdueshme. Mirëpo vlera e monitorimit rritet nëse rezultatet që sigurohen nga ky proces raportohen në baza të rregullta për t'i informuar autoritetet dhe personat që ndërlidhen me ekzekutimin e buxhetit.

---

<sup>29</sup>*Ibid.*, fq.12.

<sup>30</sup>*Ibid.*



Monitorimi dhe raportimi i rregullt i shpenzimit të buxhetit janë mjete të rëndësishme për menaxhimin, kontrollin dhe informimin mbi progresin e mënyrës së ekzekutimit të buxhetit. SIMFK mundëson prodhimin e disa llojeve të raporteve financiare të cilat përdoren për monitorim dhe mbështesin kërkesat për raportim. Përveç raportimit për nevoja të brendshme MBPZhR obligohet me ligj të raportoj në Ministrinë e Financave mbi ekzekutimin e buxhetit. MBPZhR duhet të hartoj disa raporte mbi ekzekutimin e buxhetit siç janë raportet mujore financiare, raportet tremujore financiare, raportit i rishikimit të buxhetit, raportet financiare nëntëmujore dhe raportin vjetor financiar.

MBPZhR është përgjegjëse që të përgatis këto raporte në kohë dhe t'i dorëzoj në Ministrinë e Financave, përveç raporteve mujore të cilat përgatiten për nevoja të brendshme të organizatës. Raportet tremujore duhet të pasqyrojnë të hyrat dhe shpenzimet e organizatës si dhe investimet dhe detyrimet e papaguara.<sup>31</sup> Përveç në baza tremujore MBPZhR obligohet të përgatis raportin nëntëmujor financiar mbi progresin e shpenzimeve dhe t'a dorëzoj në Ministrinë e Financave. Ky raport duhet të përmbaj ndër të tjera (i) pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme (ii) raportin e ekzekutimit të buxhetit (iii) shënime rreth pasqyrave financiare (iv) raportimin e pasurive fikse dhe pasurive tjera dhe (v) raportimin e detyrimeve rrjedhëse dhe borxhet afatgjata si dhe deklaratën e ZKF dhe ZKA për saktësinë dhe drejtësinë e raportimit.<sup>32</sup> Poashtu LMFP obligon MBPZhR si dhe gjithë organizatat tjera buxhetore që 30 (tridhjetë)ditë pas përfundimit të çdo viti fiskal të dorëzoj në Ministrinë e Financave deklaratën e paaudituar financiare për vitin përkatës fiskal si dhe një konfirmim me shkrim nga ZKA dhe ZKF se deklarata në fjalë është përgatitur në mënyrë të saktë dhe të drejtë.<sup>33</sup>

MBPZhR për nevoja interne ka përgatitur një udhëzim administrativ të brendshëm për financa dhe kontabilitet që zbaton monitorimin dhe raportimin efikas dhe e cila është konsistente me kornizën legjislative, ashtu edhe me karakteristikat unike të organizatës buxhetore. Sipas këtij udhëzimi,<sup>34</sup> Divizioni për buxhet dhe financa duhet të bëj monitorimin dhe

---

<sup>31</sup>Rregulla financiare nr. 06/2011 për raportimin nëntëmujor të organizatave buxhetore, neni 3

<sup>32</sup>Ibid., neni 6

<sup>33</sup>Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 44.4.

<sup>34</sup>Shih: Manual për financa dhe kontabilitet, Udhëzim i brendshëm i MBPZhR (i pabotuar), Prishtinë, 2014. Ky udhëzues i brendshëm është përgatitur nga ekspertët e huaj dhe është aprovuar me nënshkrimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë.

raportimin e rregullt(në baza mujore) të realizimit të buxhetit në bashkëpunim me menaxherët e programeve në mënyrë që të shmanget akumulimi i borxhit, obligimet e papaguara dhe detyrimet. Ky udhëzim ka për qëllim lehtësimin e procesit të ekzaminimit të ekzekutimit të buxhetit që nënkupton krahasimin e shpenzimeve ndaj buxhetit të aprovuar apo të rishikuar sipas nën-programeve dhe kategorive ekonomike.

## 6. PËRFUNDIMI

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural është organ i lartë i administratës së vendit në nivel qendror e cila ofron shërbime publike për sektorin e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural. Kjo ministri ushtron përgjegjësitë e saj mbështetur nëaktet ligjore në fuqi për zhvillimin dhe menaxhimin e aktiviteteve të këtij sektori. MBPZhR ka për qëllim të krijoj dhe të zbatoj politikat dhe programet të cilat kanë ndikim në zhvillimin e balancuar ekonomik, në mjedisin shoqëror dhe kulturor dhe në mirëqenien e zonave rurale, e njëkohësisht me këtë kontribuohet edhe në përshpejtimin e integritimit të vendit në BE.

MBPZhR e ka strukturën e vet organizative të përbërë nga Kabineti i Ministrisë, Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm, Departamentet dhe Divizionet. Në kuadër të MBPZhR operojnë dy agjenci: Agjencioni Pyjor i Kosovës si dhe Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë, të cilat kanë rol ekzekutiv.

Ekzekutimi i buxhetit si proces në MBPZhR ashtu si në të gjitha organizatat të cilat pranojnë fonde nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës është mirë i rregulluar dhe përfshin pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe administrative të vendit. Ligji organik i buxhetit cili rregullon menaxhimin e financave publike në Kosovë është Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë në bazë të të cilit hartohen rregulloret që rregullojnë menaxhimin financiar. Vetë buxheti është i përfshirë në një ligj vjetor të buxhetit.

Ekzekutimi i buxhetit në MBPZhR fillon me ndarjen buxhetore vazhdon me alokimin, inicimin shpenzimeve, zotimin, prokurimin, kontraktimin, pastaj pagesën e faturës dhe në fund lëshimin e fondeve nga llogaria bankare e Fondit të Konsoliduar të Kosovës. Këto hapa duhet të ndiqen në mënyrë strikte dhe tejkalimi i cilito nga këto hapa paraqet shkeljetje nga procesi i shpenzimit të buxhetit. Për më tepër, ekzekutimi i buxhetit duhet

tëjetëishoqëruar vazhdimisht me monitorimin, kontrollimin, shqyrtimn dhe vlerësimin, raportimin, llogaridhënien publike dhe auditimin e tij.

Buxhetet implementohen rrallë ashtu siç janë miratuar për shkak të ndryshimeve në ambientin ekonomik, prandaj po aq e rëndësishme për qëllime menaxhimi është edhe vendosja e një sistemi të monitorimit, raportimit dhe kontrollit i cili e mbështet ekzekutimin e buxhetit. Kontrolli i shpenzimit të buxhetit bëhet me qëllim të sigurimit se transaksionet financiare menaxhohen në mënyrën e duhur, se të gjitha procedurat ndiqen sipas kornizës ligjore dhe se fondet publike nuk përdoren për qëllime të paautorizuara. Kontrolli i shpenzimeve në MBPZhR bazohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe ligjet tjera relevante. Përveç kontrollit nga vetë organizatat buxhetore, kontrolli i shpenzimeve të MBPZhR si edhe në të gjitha organizatave tjera buxhetore kryhet edhe nga institucionet e jashtme siç janë: Ministria e Financave, Zyra Kombëtare e Auditimit dhe Kuvendi i Kosovës i cili është kompetent për kontrollin e aktiviteteve të Qeverisë. Menaxhimin financiar dhe kontrollin e shpenzimeve e mbështet Sistemi Informativ për Menaxhimin Financiar të Kosovës. Ky sistem mundëson monitorimin dhe raportimin e rregullt të ekzekutimit të buxhetit të cilat paraqesin mjete të rëndësishme për menaxhimin, kontrollin dhe informimin mbi ekzekutimin e buxhetit.

Duke marrë parasysh se dallimet e mëdha në mes të buxhetit të miratuar dhe atij të zbatuar nënkuptojnë objektiva të humbura të buxhetit dhe se në këtë ndikojnë shumë edhe ndryshimet në ambientin e jashtëm dhe rrethanat që mund të dalin gjatë vitit buxhetor, të gjitha organizatat buxhetore kanë nevojë për fleksibilitet për t'u marrë me këto situata. Në këtë drejtim, për hir të efektivitetit, të gjitha organizatat buxhetore përfshirë edhe MBPZhR në bazë të kornizës ligjore mundësohen që përmes rishikimit gjashtëmujor tëndërmarrin hapat e nevojshëm për orientimin e buxhetit deri në mbyllje të vitit fiskaldrejt përmbushjes së objektivave të përcaktuara.

Mund të konstatojmë se sigurimi se buxheti implementohet në mënyrë të drejtë dhe efektive është një aspekt i rëndësishëm i përgjegjësisë së qeverisë ndaj shoqërisë. Në këtë kuptim, buxheti paraqet një mjet themelor dhe shumë të fuqishëm në menaxhimin e shpenzimeve publike. Duke marrë parasysh mjetet e kufizuara buxhetore në një anë si dhe nevojat e shumta në anën tjetër, është e pashmangshme nevoja për menaxhimin e duhur të ekzekutimit të buxhetit. Ekzekutimi i buxhetit në të vërtetë është më kompleks. Edhe buxheti më së miri i formuluar bëhet i padobishëm, nëse në një masë të madhe shpërfillet gjatë ekzekutimit. Ndryshimet edhe më vogëla nga buxheti

i miratuar mund të kenë ndikime serioze ekonomike dhe sociale, prandaj qëllimi i ekzekutimit të buxhetit është zbatimi i buxhetit si i formuluar dhe i autorizuar me sa më pak devijime që të jetë e mundur si rrjedhojë e ndryshimeve të rrethanave, duke u siguruar se buxheti po zbatohet sipas parimeve të duhura, dhe që kontribuon në arritjen e objektivave ekonomike dhe sociale të qeverisë. Ndërsa suksesi i ekzekutimit të buxhetit varet nga planifikimi dhe formulimi i duhur i buxhetit, realizimi i duhur i hapave të ekzekutimit të tij si dhe monitorimi, raportimi, vlerësimi dhe kontrolli vazhdueshëm. MBPZhR duhet të sigurohet që ekzekutimi i buxhetit po realizohet në mënyrë strikte që do të mundësonte përmbushjen e objektivave të Ministrisë dhe evitimin e akumulimit të obligimeve të papaguara dhe deficitit buxhetor si dhe të shmanget suficiti i paplanifikuar nga mosrealizimi i buxhetit.

**M. Sc. Albanë Gashi\***

## **BUDGET EXECUTION PROCESS IN THE MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT IN KOSOVO**

### **SUMMARY**

The Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development is state administration body at the central level, which provides public services for the agriculture, forestry and rural development sector. This ministry performs its responsibilities based on the legal acts in force for the development and management of activities of this sector. MAFRD aims at establishing and implementing policies and programs that have an impact on balanced economic development, social and cultural environment and the welfare of rural areas, and at the same time contributing to the acceleration of the country's EU integration.

MAFRD has its own organizational structure established consisting of the Cabinet of the Minister, the Office of the Secretary General as well as Departments and Divisions. There are two agencies operating within MAFRD that are Kosovo Forest Agency and Agriculture Development Agency and have an executive role.

Budget execution as a process in MAFRD same as in all budget organizations receiving funds from the Kosovo Consolidated Budget is well regulated and includes compliance with the legal and administrative requirements of the country. The organic budget law which regulates public finance management in Kosovo is the Law on Public Financial Management and Accountability from which derive regulations governing financial management. The budget itself is included in an annual budget law.

Budget execution in MAFRD begins with the budget allocation, continues with the allocation, initiation of expenditures, commitment, procurement, contracting, then payment of the invoice and lastly the release of funds from the bank account of Kosovo Consolidated Fund. These steps should be strictly followed and overcoming of any of them leads to a disconnection from the budget spending process. Moreover, budget execution should be

continuously accompanied with monitoring, controlling, reviewing and evaluating, reporting, public accountability and auditing.

Budgets are rarely implemented as they were initially enacted due to changes in the economic environment, so equally important for management purposes is the establishment of a monitoring, reporting and control system that supports budget execution. Budget spending control is done to ensure that financial transactions are properly managed, that all procedures are followed in accordance with the legal framework and that public funds are not used for unauthorized purposes. Spending control at MAFRD is based on the Law on Public Financial Management and Accountability and other relevant laws. In addition to spending control performed by budget organizations themselves, control of spending in MAFRD as well as other budget organizations is also carried out by external institutions such as the Ministry of Finance, National Audit Office and Kosovo Assembly which is competent to control government activities. Financial management and expenditure control is supported by the Kosovo Financial Management Information System. This system enables regular budget execution monitoring and reporting as important tools for managing, controlling and informing on budget execution.

Considering that major differences between the approved and implemented budget imply missed budget objectives and that this is considerably affected by the changes in the external environment and the circumstances that may arise during the fiscal year, all budget organizations need flexibility to deal with these situations. In this regard, for the sake of effectiveness, based on the legal framework all budget organizations including MAFRD are enabled via six months budget review to take necessary steps for orienting their budgets towards meeting the defined objectives until the end of the fiscal year.

We can come to a conclusion that ensuring that budget is implemented fairly and effectively is an important aspect of government's responsibility to society. In this regard, the budget represents a fundamental and very powerful tool in managing public spending. Given the limited budgetary resources on one hand and unlimited needs on the other hand, it is inevitable the need for proper budget execution management. Execution of the budget is actually more complex so that the best formulated budget becomes useless if it is to a large extent neglected during execution. Even minor deviations from the approved budget can have serious economic and social impact, so the purpose of budget execution is to implement the budget as formulated

and approved with as few deviations as possible due to changes in circumstances, making sure that the budget is being implemented according to the required principles and that contributes to the achievement of government's economic and social objectives. Meanwhile, the success of budget execution depends on proper budget planning and formulation, proper realization of the execution steps and continuous monitoring, reporting, evaluation and control. MAFRD should ensure that the execution of the budget is being implemented strictly which would enable the fulfillment of the Ministry's objectives and would avoid the accumulation of arrears and budget deficit as well as unplanned surplus from underspending of the budget.

